



GLOBAL INITIATIVE

AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME

TË SHFRYTËZUAR NË SY TË TË GJITHËVE

Vlerësim i shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve dhe i reagimeve për mbrojtjen e tyre në Ballkanin Perëndimor



TË SHFRYTËZUAR NË SY TË TË GJITHËVE

*Vlerësim i shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve
dhe i reagimeve për mbrojtjen e tyre në Ballkanin*

Perëndimor

Maj 2021

MIRËNJOHJE

Ky raport është rezultat i punës së Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore ("SEE-Obs") të Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar. SEE-Obs-ja është platformë që bashkon dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Qëllimi i platformës është t'i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, analizojë dhe vendosë në hartë prirjet kriminale dhe ndikimin që ato kanë në prurjet e paligjshme financiare, qeverisje, zhvillim, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe shtetin ligjor, dhe ta përkrahë shoqërinë civile në monitorimin e dinamikave kombëtare dhe prirjeve rajonale e ndërkombëtare të krimin të organizuar.

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen për kontributet e konsiderueshme të dhëna nga ekspertët në këtë studim, sidomos nga ekspertët që kanë përgatitur vlerësimet për vendet, ekspertët e çështjeve të komunitetit romë dhe këshilltarët tanë të teknologjisë. Përfitojmë nga rasti për të falënderuar Ana Majkon (Shqipëri), Amir Basiçin (Amir Basić) dhe Amela Efendiçin (Amela Efendić) (Bosnjë dhe Hercegovinë), Liridon Latifin dhe Shkodran Ramadanin (Kosovë), Vanja Rakoçeviçin (Vanja Rakočević) (Mal i Zi), Stojne Atanasovska Dimishkovskën (Stojne Atanasovska Dimishkovska) (Maqedoni e Veriut), Marija Anxhelkoviçin (Marija Andjelković) (Serbi), Mirsada Bajramoviçin (Mirsada Bajramović), Alketa Laskun dhe Sahiba-Siba Sërnën (Sahiba-Siba Srna) (komunitetet rome në mbarë Ballkanin Perëndimor) dhe Tomislav Ramëljakun (Tomislav Ramljak) e Lucija Velmekën (Lucija Velmelka) (ekspertë teknologjije). Gjithashtu u jemi shumë mirënjohës Teuta Zymerit dhe Marija Todorovskës (Marija Todorovska) për mbështetjen e tyre.

Ky raport u hartua nga Livia Vagneri (Livia Wagner), Kristina Amërhauseri (Kristina Amerhauser), Rugero Skaturo (Ruggero Scaturro) dhe Thi Hoangu (Thi Hoang). Do të donim të falënderonim kolegët tanë për mbështetjen e tyre, sidomos Valter Kempin (Walter Kemp) për drejtimin e procesit të shqyrtimit, Lucia Bërdin (Lucia Bird) për kontributin e saj në analizën juridike dhe Anesa Agoviçin (Anesa Agović), Sasha Gjorgjeviçin (Saša Đorđević), Fatjona Mejdinin dhe Aleksandër Sërbinovskin (Aleksandar Srbinovski) për komentet e tyre në lidhje me shtetet. Gjithashtu, u jemi mirënjohës anëtarëve të tjerë të ekipit të SEE-Obs-së për mbështetjen e tyre: Ugljesha (Ugi) Zvekiçit (Uglješa (Ugi) Zvekić), Fabian Zhillës, Od Malmit (Odd Malme) dhe Tërpe Stojanovskit (Trpe Stojanovski).

Ky botim u bë i mundur falë përkrahjes financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konfliktin, Stabilitetin dhe Sigurinë. Lënda e botimit është përgjegjësi vetëm e GI-TOC-së dhe nuk pasqyron patjetër pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.

© 2021 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk lejohet të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose mënyrë pa autorizimin me shkrim të Iniciativës Globale.

Kopertina: © Bahrudin Bandic
Dizajni: Ink Design
Ilustrimet: Paulina Rosol-Barrass

Jeni të lutur të dërgoni pyetjet tuaja në adresën:
The Global Initiative Against Transnational Organized Crime
Avenue de France 23
Geneva, CH-1202
Switzerland

www.globalinitiative.net

PASQYRA E LËNDËS

Akronimet dhe shkurtesat	4
Fjalorthi i termave kyçe	4
Përmbledhje ekzekutive	6
Dukuria globale e shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve	10
Faktorët e rrezikut	12
Pasojat.....	13
Roli i teknologjive të rrjeteve digjitale	14
Historiku dhe konteksti i Ballkanit Perëndimor	16
Shfrytëzimi seksual tregtar i fëmijëve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor	20
Udhëtimet dhe turizmi.....	22
Martesa e fëmijëve	25
SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia	28
Profili i fëmijëve në rrezik.....	31
Cenueshmëria e romëve.....	32
Profili i autorëve të krimit.....	35
Ndikimi i pandemisë "Kovid-19"	36
Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve dhe reagimet	38
Kudri ligjor	40
Qasjet kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.....	42
Mekanizmat e mbështetjes të shoqërisë civile	50
Sektori privat.....	53
Përfundime	58
Rekomandime të posaçme për rajonin	62
Rekomandime specifike për shtetet	72
Matrica e rekomandimeve	84
Shënime	88

Akronimet dhe shkurtesat

MASF	Material i abuzimit seksual të fëmijës
SHSTF	Shfrytëzimi seksual tregtar i fëmijëve
ECPAT	Fund prostitucionit dhe trafikimit të fëmijëve
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
OSHI	Ofrues i shërbimit të internetit
NCMEC	Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar
SHSF-UT	Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në udhëtime dhe turizëm
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar
UNWTO	Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara

Fjalorth i termave kyçe

Konventa e Budapestit (Konventa e Këshillit të Evropës "Për krimin kibernetik")	Instrument që shërben si udhëzues për çdo shtet që harton legjislacion kombëtar gjithëpërfshirës kundër krimin në fushën e kibernetikës dhe si kuadër për bashkëpunimin ndërkombëtar midis shteteve palë.
Martesë e fëmijëve	Term që shënon martesën e një vajze ose djali përpara moshës 18 vjeçare dhe u referohet edhe martesave formale, edhe bashkimeve joformale, ku fëmijët nën 18 vjeç jetojnë me një partner njëloj sikur të ishin të martuar.
SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia / Shfrytëzimi seksual në internet i fëmijëve	I referohet abuzimit seksual të një personi nën 18 vjeç dhe prodhimit të imazheve të këtij abuzimi dhe shpërndarjes së këtyre mesazheve në internet. Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet është dukuri që evoluon vazhdimisht dhe formësohet nga zhvillimet në teknologji.
Pornografi me fëmijë	Çdo përmbajtje ku paraqitet shfrytëzimi seksual në të cilin përfshihet një fëmijë. Në përshkrimet pamore bëjnë pjesë: fotografitë, videot, imazhet digjitale dhe ato të përfutuara me anë të kompjuterit dhe që nuk mund të dallohen nga ato të një të mituri real. ¹
Prostitucion me fëmijë	Shfrytëzim seksual i një të mituri ose personi nën moshën ligjore të dhënies së pëlqimit. Në pjesën më të madhe të juridiksioneve, shfrytëzimi seksual tregtar ose për qëllime fitimi (i cili përdoret me termin "prostitucion me fëmijë") është i paligjshëm në kuadër të ndalimit të përgjithshëm të prostitucionit.

Fëmijë në lëvizje

Fëmijë që lëvizin në mënyrë vullnetare ose jo brenda ose midis vendeve, me ose pa prindërit ose kujdestarët e tyre kryesorë, lëvizja e të cilëve mund t'i ekspozojë ndaj rrezikut (ose t'i vërë në rrezik më të madh) të shfrytëzimit ekonomik ose seksual, abuzimit, mospërfilljes dhe dhunës.

Krim kibernetik

Krim për kryerjen e të cilit përdoret një kompjuter dhe një rrjet informatik. Kompjuteri mund të përdoret për kryerjen e një krimi ose mund të jetë vetë objektiv. Krimi kibernetik mund të kërcënojë sigurinë dhe shëndetin financiar të një personi, kompanie ose një shteti.

Siguria kibernetike

Mbrojtje e sistemeve të lidhura me internetin, si hardueri, softuerët dhe të dhënat, nga kërcënimet kibernetike. Kjo praktikë përdoret nga individë dhe sipërmarrje për t'u mbrojtur kundër qasjes së paautorizuar në qendrat e të dhënave dhe në sisteme të tjera të kompjuterizuara.

Rrjet i errët

Rrjeti i errët është përmbajtja e rrjetit mbarëbotëror të internetit, e cila ekziston në ndërlidhje të errëta: rrjete të mbivendosura që janë të lidhura me internetin, por kërkojnë softuerë specifikë, konfigurime të veçanta ose autorizim të posaçëm për t'u përdorur.

Komunikim i enkriptuar/Enkriptim

Procesi i kodimit të informacionit me qëllim që të pengohet kushdo, përveç marrësit të synuar, që ta shohë atë informacion. Informacioni i enkriptuar nuk mund të lexohet nga askush që nuk ka qasje në një çelës të posaçëm i cili përdoret për të dekriptuar (dekoduar) informacionin, duke e bërë këtë të fundit të lexueshëm.

Lypje e detyruar

Formë shfrytëzimi ku personi detyrohet ose shtrëngohet të mbledhë donacione, zakonisht në formë monetare. Lypësit detyrohen të marrin pjesë në veprimtari që variojnë nga kërkimi i lëmoshës prej njerëzve të panjohur e deri te shitja e artikujve të vegjël, ndërkohë që pjesën më të madhe të përfitimeve e mbajnë trafikantët.

Konventa e Lanzarotit (Konventa e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual")

Instrument që i kriminalizon të gjitha llojet e veprave penale seksuale kundër fëmijëve.

Konventa parashikon që palët duhet të miratojnë një legjislacion specifik dhe të marrin masat për të parandaluar dhunën seksuale, me qëllim mbrojtjen e fëmijëve viktime dhe ndjekjen penale të autorëve të krimit.

Protokollet e Palermos

Protokolle të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për të plotësuar UNTOC-në (Konventa e OKB-së për "Krimin e organizuar ndërkombëtar", e njohur edhe me emrin "Konventa e Palermos"). Ato janë protokollit "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve", protokollit "Kundër kontrabandimit të migrantëve nga toka, deti dhe ajri" dhe protokollit "Kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe komponentëve dhe municionit".

Telegram

Softuer dhe aplikacion shërbimi pa pagesë, i shtrirë në platforma të ndryshme, i hostuar në re kompjuterike dhe që shërben për shkëmbime mesazhesh. Shërbimi ofron edhe video-telefonata, VoIP, shkëmbim skedarësh dhe disa funksione të tjera me enkriptim fundor.

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor

Grup vendesh që përbëhet nga: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosova,² Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga një vendbanim i varfër, fëmija që paraqitet në foto po ofrohet për vetëm 25 euro në ditë. © *Bahrudin Bandic*

Historikisht, gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë qenë në qendër të vëmendjes dhe hulumtimeve shkencore që përqendrohen te shfrytëzimi seksual tregtar i fëmijëve (SHSTF). Pavarësisht rritjes së korpusit të literaturës lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Evropën Juglindore në përgjithësi, ka pak të dhëna lidhur me SHSTF-në në veçanti. Informacioni rrallë herë raportohet nga media lokale edhe për shkak se struktura patriarkale dhe tradicionale e shoqërive në Ballkanin Perëndimor nxit me të madhe përhapjen e besimit se shfrytëzimi seksual i fëmijëve ose nuk ekziston, ose është përjashtim dhe jo rregull. Për këtë arsye, janë fare të pakta raportet ku është marrë në konsideratë, në një mënyrë gjithëpërfshirëse, roli i gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, dobësitë e këtij rajoni dhe kontributi i tij në dukurinë e SHSTF-së. Ndërkohë që SHSTF-ja është duke fituar vëmendje në nivel global, shoqëritë dhe institucionet në Ballkanin Perëndimor vazhdojnë të kenë nivele të ulëta ndërgjegjësimi dhe kapaciteti për ta trajtuar këtë dukuri.

SHSTF-ja manifestohet në disa forma të ndërlidhura në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë trafikimin e të miturve për qëllime seksuale, shfrytëzimi i fëmijëve në udhëtime dhe turizëm, martesat e hershme dhe të detyruara dhe shfrytëzimi seksual në vende si bordelot, baret dhe klubet e striptizit. Ajo pasqyrohet edhe në krijimin dhe shpërndarjen e materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve (MASF) në internet, duke përfshirë, ndër të tjera, regjistrimin, transmetimin drejtpërdrejt, shpërndarjen dhe shkarkimin e materialeve ku shfaqen të mitur që shfrytëzohen për qëllime seksuale. Gjithashtu, ka disa mbivendosje midis SHSTF-së dhe formave të tjera të shfrytëzimit, ku përfshihet edhe shfrytëzimi në punë (p.sh. lypja). Edhe përpara se gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të goditeshin nga pandemia "Kovid-19", rajoni po regjistronte një rritje të numrit të rasteve të SHSTF-së.

Duke marrë parasysh mungesën e hulumtimeve shkencore dhe të dhënave gjyqësore, të cilat do të shërbenin si bazë analizimi, nuk ekziston asnjë profil i përbashkët i autorëve të krimit, të përfshirë në SHSTF-në në rajon. Në fakt, duket se autorët e krimit janë duke vepruar në gjithë rajonin pa treguar ndonjë kujdes të madh, falë përdorimit të teknologjive digjitale dhe rrjeteve, ngritjes së turizmit dhe dobësive të kudondodhura në sistemet e mbrojtjes së fëmijëve. Kriminelët përfitojnë edhe nga dobësitë shoqëro-ekonomike të rajonit dhe marginalizimi endemik, i cili i bën disa pakica etnike edhe më të cenueshme.

Në këtë raport vlerësohet cenueshmëria e fëmijëve ndaj shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve (SHSTF) në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, me fokus të veçantë në shfrytëzimin seksual në internet të fëmijëve dhe në shfrytëzimin seksual të fëmijëve në udhëtime dhe turizëm (SHSF-UT). Në raport jepet edhe një pasqyrë e përgjithshme e gjërave që janë—dhe që nuk janë—duke bërë autoritetet e zbatimit të ligjit, kompanitë private dhe organizatat e shoqërisë civile për të reaguar ndaj shfaqjeve të ndryshme të SHSTF-së dhe për ta luftuar dhe parandaluar atë.




FIGURA 1 Fokusi i raportit.

Në fillim, në raport vlerësohet situata aktuale në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe jepet një panoramë e përgjithshme e martesave të fëmijëve, SHSF-UT-së dhe SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. Gjithashtu, raporti shqyrton në mënyrë specifike profilin e fëmijëve në rrezik (ku përfshihen fëmijët e komunitetit romë dhe fëmijët në lëvizje), autorët e SHSTF-së dhe ndikimi i pandemisë "Kovid-19". Në pjesën e dytë të raportit shqyrtohen reagimet aktuale ndaj SHSTF-së. Në këtë pjesë, skicohet infrastruktura për mbrojtjen e fëmijëve nga autoritetet ligjzbatuese dhe sistemet e drejtësisë penale dhe vlerësohen mekanizmat e mbështetjes individuale që ofron shoqëria civile në mbarë rajonin dhe roli i sektorit privat, sidomos i ofruesve të shërbimit të internetit (ISP) dhe industria e hotelerisë.

Meqenëse hulumtimet shkencore dhe mbulimi mediatik i SHSTF-së në internet janë disi të rralla në rajon, për hartimin e këtij raporti jemi mbështetur kryesisht në intervista cilësore: 11 ekspertë realizuan në terren më shumë se 135 intervista midis tetorit të vitit 2020 dhe shkurtit të vitit 2021 me zyrtarë të agjencive ligjzbatuese dhe përfaqësues të sistemit gjyqësor, punonjës të kompanive të udhëtimit dhe turizmit dhe atyre të teknologjive, ISP-të, strehimoret dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile që merren me trafikimin e qenieve njerëzore dhe abuzimin e fëmijëve. Më pas, të dhënat u trianguluan dhe u verifikuan duke u krahasuar me informacionet e mbledhura nga qeveritë, raportet nga organizatat ndërkombëtare dhe disa raste të disponueshme të raportuara në medien lokale. Gjithsej, për këtë raport, u konsultuan më shumë se 150 burime.

Në figurën 2 paraqitet procesi i hulumtimit nga qershori i vitit 2020 deri në mars të vitit 2021.



FIGURA 2 Procesi i hulumtimit

Të gjitha gjetjet u diskutuan edhe në takimin rajonal të grupit të ekspertëve, i cili u mbajt në mes të marsit të vitit 2021. Në këtë takim, ekspertët theksuan edhe një herë se, pavarësisht rritjes së korpusit të literaturës rreth temës së trafikimit të qenieve njerëzore në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, vazhdon të ketë mungesë të konsiderueshme të kuptimit të duhur të SHSTF-së dhe se reagimet janë të pamjaftueshme. Për shembull, termi "pornografi me fëmijë" vazhdon të përdoret gjerësisht si përkufizim ligjor, edhe pse ky term është hutues dhe i pasaktë. Duke marrë parasysh që ky term shpërfill natyrën shfrytëzuese të dukurisë dhe nënkupton legjitimitetin nga ana e autorit të krimit dhe bindjen nga ana e fëmijës viktimë, rekomandohet fuqishëm që në vend të këtij termi të përdoren termat "abuzim" dhe "shfrytëzim" seksual i fëmijëve".

Megjithatë, sfidat nuk qëndrojnë vetëm te përkufizimi i termave dhe i shtrirjes së SHSTF-së, por edhe tek identifikimi i viktimave, kuptimi i drejtë i dinamikave shoqërore midis trafikantëve dhe personave të trafikuar dhe te dallimi i formave të ndryshme të shfrytëzimit. Me sa duket, për momentin, edhe pse kuadrot ligjorë kombëtarë në përgjithësi përputhen me standardet ndërkombëtare, mungon qasja gjithëpërfshirëse me shumë palë interesi dhe burimet e mjaftueshme për të baraspeshuar dhe ulur, në mënyrë të përshtatshme, ekspozimin e fëmijëve ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual në mbarë rajonin.


Format e SHSTF-së janë të pranishme në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe secili vend ka përgjegjësinë për të reaguar në nivel kombëtar ndaj përhapjes së SHSTF-së dhe për ta parandaluar atë. Megjithatë, duke marrë dobësitë e përbashkëta të vendeve të rajonit dhe karakterin ndërkombëtar të kësaj dukurie, lipset të ndiqet një qasje e përbashkët rajonale për të siguruar një reagim të suksesshëm e efikas. Në raport jepen edhe rekomandime konkrete dhe shembuj të praktikave më të mira që duhet të ndiqen në të ardhmen. Në veçanti, në raport rekomandohet krijimi i një rrjeti parandalimi rajonal në Ballkanin Perëndimor:

- Për të mundësuar një cikël vicioz praktike dhe hulumtimi shkencor;
- Për të mbështetur gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që të rrisin ndërgjegjësimin, duke krijuar fushata mediatike dhe materiale trajnimi të fokusuara;
- Për të ngritur grupe pune që do të lehtësonin shkëmbimin e praktikave më të mira dhe do të punonin në lidhje me nisma konkrete në funksion të arritjes së rezultateve të prekshme.



DUKURIA GLOBALE E SHFRYTËZIMIT SEKSUAL TË FËMIJËVE PËR QËLLIME FITIMI (TREGTARE)

Këtij fëmije po i jepet ndihmë nga një OJQ në Bosnjë dhe Hercegovinë, e cila merret me mbrojtjen e tyre. © Bahrudin Bandić



Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) përlogarit se rreth 1 milionë fëmijë në të gjithë botën janë viktima të shfrytëzimit seksual tregtar.³ Krahas kësaj, Këshilli i Evropës dhe Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar (NCMEC) vlerësojnë se, në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një e pesta e fëmijëve pësojnë një formë dhune, duke përfshirë edhe abuzimin seksual.⁴

SHSTF-ja është abuzim dhe shfrytëzim seksual i fëmijës ose një personi që është nën moshën e dhënies së pëlqimit, zakonisht nën 18 vjeç, për qëllime përfitimi ekonomik dhe monetar (para fizike, mallra ose përfitime në natyrë).⁵ SHSTF-ja kërcënon mirëqenien fizike dhe psikosociale dhe integritetin e fëmijëve.⁶ Sipas neneve 19 dhe 34 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, marrëveshja e parë ndërkombëtare me të cilën njihen të drejtat e fëmijëve,⁷ vendet nxiten të marrin të gjitha masat e nevojshme dhe të bëjnë përpjekje "për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore" dhe të mos lejojnë që të nxiten ose detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari dhe praktika të paligjshme seksuale ose të shfrytëzohen në këto veprimtari dhe praktika.

Më tej, Konventa nr. 182 e ILO-s (1999) e përkufizon shfrytëzimin seksual si një prej formave më të këqija të punës së fëmijëve.⁸ SHSTF-ja është pjesë edhe e protokollit të OKB-së "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve",⁹ i cili u miratua në dhjetor të vitit 2000.¹⁰ Në protokoll specifikohet që, për sa u takon fëmijëve, "rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi", do të konsiderohen "trafik personash". Provat për mjetet e përdorura (kërcënimi ose përdorimi i forcës dhe i formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit ose mashtrimit) ose për pëlqimin e dhënë nga fëmija janë të pavenda.


Përmbledhje

- SHSTF-ja është dukuri e përhapur në mbarë botën, ku përlogaritet se numri i viktimave është rreth 1 milionë.
- Dhënia e pëlqimit dhe provat për mjetet e përdorura (kërcënim, dhunë, shtrëngim) janë të pavenda në SHSTF.
- Faktorët e rrezikut të SHSTF-së kanë tri nivele: individ-familje, bashkëmoshatarë-komunitet, dhe niveli makro dhe sistemik. Faktorët e rrezikut mund të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë në nivele të ndryshme. Kur funksionojnë të kombinuar, faktorët kanë të ngjarë të paraqesin nivel përgjithësisht më të lartë ndaj grupeve të cenushme.
- SHSTF-ja përfshin shumë pasoja të rënda mendore, fizike, shoqërore dhe ligjore për të mbijetuarit. Të mbijetuarit mund të bëhen përsëri viktimë kur materialet e paligjshme hidhen për qarkullim në internet. Të mbijetuarit e SHSTF-së duhet të pranohen dhe të trajtohen si të tillë, në vend që të kriminalizohen për sjellje dhe veprimtari tek të cilat i ka çuar, në mënyrë të pandashme, shfrytëzimi që u është bërë (p.sh. delikuenca e të miturve, varësia nga droga/alkooli).
- Përdorimi i teknologjive digjitale nga ana e trafikantëve që merren me shfrytëzimin seksual tregtar të fëmijëve ka krijuar sfida të shumta për përpjekjet kundër SHSTF-së, duke përfshirë rritjen e rrezikut ndaj të cilit ekspozohen fëmijët në internet, përmirësimin e anonimitetit në veprimtaritë kriminale, rritjen e presionit mbi palët e interesit që të përmirësojnë kuadrin ekzistues ligjor, bashkëpunimin ndërkuftar dhe shumë-palësh si dhe aftësitë teknike.

Faktorët e rrezikut

Për të adresuar këtë problem dhe për të hartuar politika dhe bërë ndërhyrje në funksion të parandalimit dhe zbutjes së kësaj dukurie, është tepër e rëndësishme të kuptohen si duhet faktorët e rrezikut që çojnë në SHSTF.

Për sa u përket viktimave të mundshme, faktorët e ekspozimit të tyre ndaj rrezikut të SHSTF-së mund të identifikohen në shumë nivele, sikurse paraqitet në figurën 3.



FAKTORËT E NIVELIT TË MJEDISIT "MAKRO" DHE NIVELIT SISTEMIK

- Mungesa e sistemeve efektive të mbrojtjes së fëmijëve (kujdesi shëndetësor, arsimit, zbatimi i ligjit)
- Normat shoqërore dhe kulturore
- Seksualizimi i fëmijëve në media dhe produkte komerciale
- Diskriminimi racor dhe etnik

FAKTORËT E NIVELIT TË BASHKËMOSHATARËVE DHE KOMUNITETIT

- Presioni i bashkëmoshatarëve
- Lagjet e marginalizuara
- Kohezioni i komunitetit dhe normat që përbëjnë sjelljen, pëlqimin dhe detyrimin seksual

FAKTORËT E NIVELIT INDIVIDUAL DHE FAMILJAR

- Të dhëna të neglizhencës/keqtrajtimit/dhunës në familje ndaj fëmijëve
- Nivelet e ulëta të arsimit
- Varfëria
- Çështjet psikogjenike
- LGBT

FIGURA 3 Faktorët e ekspozimit ndaj rrezikut të SHSTF-së

BURIMI: Instituti i Mjekësisë dhe Këshilli Kombëtar i Kërkimit, 2013.

Këta faktorë rreziku mund të paraqiten njëherazi në të gjitha nivelet e ndryshme të përmendura më lart. Kur veprojnë të kombinuar, këta faktorë kanë të ngjarë të rrisin nivelin e përgjithshëm të rrezikut ndaj të cilit ekspozohen grupet e cenueshme. Duhet theksuar këtu që djemtë që janë viktimë të SHSTF-së përmenden, në mënyrë të konsiderueshme, më pak në literaturë. Studimet raportojnë se meshkujt viktimë të SHSTF-së ishin shumë më pak të dukshëm dhe kishin shumë më pak të ngjarë të identifikoheshin sesa femrat, edhe pse të dy ekspozohen ndaj rreziqeve të shumëfishta për t'u bërë viktimë të SHSTF-së, duke përfshirë edhe nivelet e larta të dhunës në familje dhe keqtrajtimin e fëmijëve.¹¹ Në kontekstin e Ballkanit Perëndimor, kjo dukuri është vëzhguar dhe raportuar, sikurse do të paraqesim më poshtë me më shumë hollësi.

Pasojat

Ndër pasojat e shumta të SHSTF-së, traumatizimi, ndikimi i përhershëm (gjatë gjithë jetës) në shëndetin mendor, fizik dhe social dhe në zhvillimin e fëmijëve viktimë janë pasojat që raportohen më së shumti.¹² Këtu përfshihen nivelet e larta të depresionit, mendimet për të kryer vetëvrasje, humbja e kujtesës, agresioni, përdorimi i tepërt i drogave dhe alkoolit ose varësia ndaj tyre, ankthi, çrregullimi i stresit post-traumatik, sindroma e Stokholmit, probleme me shëndetin fizik si disfunzioni psikosocial, probleme me shëndetin riprodhues ose edhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, përvoja personale, ndjenja e vajit, turpit dhe damkosja shoqërore.¹³ Në rastet kur SHSTF-ja ruhet në formë material, p.sh. imazh ose video, fëmija mund të bëhet përsëri viktimë kur ky material qarkullohet më tutje, ngarkohet në internet dhe shpërndahet.

ASPEKTI SOCIAL DHE LIGJOR	ASPEKTI MENDOR DHE FIZIK
<ul style="list-style-type: none"> • Traumatizim/mendime e plane për vetëvrasje • Nivele të larta depresioni • Varësi nga droga/alkooli • Çrregullim i stresit pastraumatik • Vuajtje nga sindroma e Stokholmit • Probleme të shëndetit riprodhues • Sëmundje seksualisht të transmetueshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Kthim në industrinë e seksit tregtar (për qëllime fitimi) • Presion nga bashkëmoshatarët • Bëhen trafikantë/trafikante • Marrja me veprimtari kriminale • Delikuencë të miturish

FIGURA 4 Pasojat e SHSTF-së

BURIMI: Ellen Wright Clayton, Richard D Krugman dhe Patti Simon (redaktorë), *Confronting Commercial Sexual Exploitation and Sex Trafficking of Minors in the United States* [Përballja me shfrytëzimin seksual tregtar dhe trafikimin seksual të të miturve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës], Institute of Medicine and National Research Council, Washington DC: The National Academies Press, 2013, <https://ojdp.ojp.gov/sites/g/files/xyckuh176/files/pubs/243838.pdf>.

SHSTF-ja mund të çojë edhe në pasoja ligjore të shumëfishta për viktimat. Përballë shumë problemeve mendore, fizike dhe sociale, të shkaktuara nga SHSTF-ja, të gërshetuara me mosndërrhyrjen në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, të miturit, që dikur kanë qenë viktimë të SHSTF-së, kanë më shumë të ngjarë të shfrytëzohen përsëri, të bëhen pjesë e punës seksuale tregtare kur arrijnë moshë madhore dhe/ose të merren me veprimtari kriminale. Këto mund të çojnë në ngritjen e një vargu akuzash penale kundër tyre, p.sh. delikuencë të miturish ose abuzim, kontrabandim ose trafikim të substancave të paligjshme. Kjo situatë bën që viktimat të futen në kurthin e rrethit vicioz.¹⁴ Prandaj, është shumë e rëndësishme të njihen dhe të trajtohen viktimat e SHSTF-së si të tillë, në vend që të kriminalizohen dhe ndiqen penalisht sjelljet dhe veprimtaritë tek të cilat i ka çuar, në mënyrë të pandashme, shfrytëzimi që u është bërë si viktimë.

Roli i teknologjive të rrjeteve digjitale

Teksa përparimet teknologjike janë duke transformuar pareshtur ekonominë globale, ato kanë çuar edhe në daljen në pah dhe përhapjen e disa veprave penale që mundësohen nga hapësira kibernetike, duke përfshirë këtu edhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet.¹⁵ SHSTF-ja raportohet se është një prej krimeve që i përshtatet më shpejt teknologjisë dhe që shfrytëzon me shpejtësi mundësitë që ofron teknologjia. Teknologjitë digjitale dhe ato të rrjeteve tani mund të gjenden në çdo fazë të procesit të SHSTF-së: (1) forume në rrjetin e errët vetëm për anëtarë dhe aplikacione me komunikim të koduar, siç janë "ShadowCrew" dhe "WhatsApp" raportohet se përdoren nga trafikantët për të komunikuar në mënyrë të sigurt dhe anonime dhe për të planifikuar veprimtaritë e tyre kriminale; (2) është zbuluar se fëmijët joshen dhe manipulohen përmes Instagram-t, Facebook-ut, Snapchat-it dhe KIK-ut;¹⁶ (3) të miturit detyrohen t'i nënshtrohen SHSTF-së nëpërmjet aplikacionit "Skype", lojërave në internet dhe lojërave virtuale si "Second Life" dhe "VRChat";¹⁷ (4) këto veprimtari të paligjshme më pas transmetohen drejtpërdrejt në internet, regjistrohen dhe ruhen në aplikacione me bazë në re kompjuterike, si p.sh. Dropbox, Google Drive dhe OneDrive, përpara se të shpërndahen më tej nëpërmjet rrjeteve të kompjuterëve të barabartë ("peer-to-peer") ose në forumet ku pjesëmarrja është vetëm me ftesë, si në rrjetin sipërfaqësor, ashtu edhe në rrjetin e errët;¹⁸ (5) trafikantët raportohet se i kanë "reklamuar" viktimat e tyre të SHSTF-së në faqe interneti si "Backpage" dhe Craigslist";¹⁹ (6) të ardhurat dhe transaksionet e paligjshme më pas shpërndahen dhe qarkullohen në mënyrë anonime midis blerësve të SHSTF-së, trafikantëve dhe rrjeteve kriminale të SHSTF-së; dhe, në fund, ky rreth veprimtarish kriminale, i ndihmuar nga teknologjia, nis sërish në hapin (1) ose në fazën e planifikimit të krimit.




FIGURA 5 Roli i teknologjive digjitale

BURIMI: Lucia Bird et al, Transformative technologies: How digital is changing the landscape of organized crime [Teknologjitë transformuese: Si po e ndryshon digjitalja peizazhin e krimit të organizuar], Global Initiative Against Transnational Organized Crime, June 2020, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/06/Transformative-Technologies-WEB.pdf>.



Përdorimi i teknologjive digjitale nga trafikantët e SHSTF-së ka krijuar sfida të shumta për përpjekjet për parandalimin e SHSTF-së:

- Një prej të metave kryesore është kufizimi i aftësive teknike të agjencive ligjzbatuese, ekipeve hetimore kombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile. Teknologjitë digjitale, jo vetëm që kanë rritur ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve në internet, por edhe kanë përmirësuar nivelin e anonimitetit të veprimtarive kriminale, duke bërë kështu që palët e interesit ta kenë të vështira të identifikojnë dhe zbulojnë viktimat dhe materialet e SHSTF-së dhe të kryejnë hetime ose gjurmojnë prurjet financiare të paligjshme që kanë të bëjnë me SHSTF-në.²⁰
- Më tej, legjislacioni për sigurinë në fushën e kibernetikës, sidomos në lidhje me adresimin e SHSTF-së, mungon ose vazhdon të jetë i fragmentarizuar.
- Gjithashtu, ekziston një kuadër i pamjaftueshëm ligjor për menaxhimin e bashkëpunimit ndërkuftar, komunikimit, hetimeve juridiksionale dhe ndjekjeve penale të rasteve të SHSTF-së të mundësuar nga teknologjia, pavarësisht se vetë krimi ka natyrë ndërkuftare.²¹

Këta faktorë kontribuojnë të gjithë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e rasteve të raportuara të SHSTF-së dhe materialeve përkatëse në internet, madje edhe përpara pandemisë së koronavirusit. Raporteri Special i Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara për Shitjen e Fëmijëve raportonte se, në çdo moment, në gjithë botën ka rreth 750 000 grabitqarë të lidhur me internetin dhe platformat digjitale.²² Në vitin 2018, kompanitë botërore të teknologjisë raportonin mbi 45 milionë imazhe dhe video në internet të SHSTF-së: dyfishi i numrit të regjistruar në vitin 2017.²³ Materiali i ruajtur në vendet e BE-së përbënte më shumë se dy të tretat e të gjitha materialeve të paligjshme në vitin 2019.²⁴

▲ Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë aftësi teknike të kufizuara për të luftuar përdorimin e teknologjive digjitale nga trafikantët e fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual tregtar. © Besart Cani

HISTORIKU DHE KUADRI I BALLKANIT PERËNDIMOR

Fëmijët lypin pará nga makinat që kalojnë në rrugë në Tiranë të Shqipërisë. © Besart Cani

Në pjesën paraardhëse diskutuam për dukurinë e SHSTF-së, faktorët e rrezikut që kontribuojnë në të dhe pasojat e saj në nivel botëror. Edhe pse kjo pjesë përbën një panoramë të rëndësishme të vetë dukurisë së SHSTF-së, ajo mund të manifestohet në mënyra të ndryshme, në varësi të faktorëve dhe specifikave rajonale. Prandaj, është po aq e rëndësishme që të merren parasysh edhe kushtet e veçanta sociale, ekonomike dhe politike si dhe infrastruktura digjitale dhe konteksti rajonal i Ballkanit Perëndimor, faktorë këta që mund të zvogëlojnë ose lehtësojnë disa forma dhe rreziqe të caktuara të SHSTF-së në rajon.

Përmbledhje

- Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, grupet kriminale, pa humbur kohë, filluan të anashkalojnë kufijtë administrativë të sapokrijuar. Sot, Ballkani Perëndimor është rajon origjine, tranziti dhe destinacioni edhe i trafikimit të qenieve njerëzore, edhe i trafikimit të personave.
- Informacionet dhe të dhënat lidhur me shfrytëzimin seksual tregtar të fëmijëve në Ballkanin Perëndimor raportohen rrallë në median lokale. Kjo ndodh edhe për shkak të strukturës përgjithësisht patriarkale të shoqërive në rajon, të cilat nxisin përhapjen e besimit se kjo dukuri ose nuk ekziston, ose përbën përjashtim dhe jo rregull.
- Të dhënat për trafikimin e qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor, të ofruara nga UNODC-ja dhe Departamenti Amerikan i Shtetit, tregojnë se numri më i madh i viktimave të shfrytëzimit seksual janë gratë e rritura. Megjithatë, nuk duhet nënvlerësuar as numri i vajzave.



FIGURA 6 Vendet e fokusit.

Ballkani Perëndimor vazhdon të përballlet me sfida socio-ekonomike. Në mbarë rajonin, papunësia vazhdon të jetë më shumë se tri herë më e lartë sesa mesatarja e BE-së,²⁵ ku norma e papunësisë së të rinjve është 35%: një prej normave më të larta në botë.²⁶ Normat e papunësisë pritet të rriten në mënyrë të konsiderueshme për shkak të pandemisë "Kovid-19". Deri në tetor të vitit 2020, Banka Botërore llogarit që edhe 300 000 njerëz nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia kanë rënë në varfëri për shkak të pandemisë "Kovid-19".²⁷ Për këtë arsye, pandemia "Kovid-19" rrit numrin e njerëzve që rrezikojnë të bëhen viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Paqëndrueshmëria institucionale dhe ekonomike e rajonit ka kontribuar në krijimin e një ekosistemi krimi dhe korrupsioni, ku lulëzojnë tregjet e paligjshme dhe faktorët kriminalë.²⁸ Kjo situatë i ka bërë disa njerëz t'i përkufizojnë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor si "stabilokraci": vende që udhëhiqen nga elita që pretendojnë se ofrojnë stabilitet edhe brenda kufijve edhe ndërmjet tyre, por institucionet e tyre i nënshtrohen ndikimit të veprimtarive të paligjshme dhe kontrollohen, *de facto*, nga aktorë kriminalë.²⁹

I ndodhur në udhëkryqet midis Lindjes dhe Perëndimit, Ballkani Perëndimor ka qenë historikisht rrugë kalimi për trafikimin e njerëzve dhe mallrave. Në fakt, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, grupet kriminale, pa humbur kohë, filluan të anashkalonin kufijtë administrativë të sapokrijuar. Sot, Ballkani Perëndimor vazhdon të jetë rajon origjine, tranziti dhe destinacioni edhe i trafikimit të qenieve njerëzore, edhe i trafikimit të personave.³⁰

Megjithatë, pavarësisht rritjes së korpusit të literaturës mbi trafikimin e qenieve njerëzore, vazhdon të ketë mungesë të konsiderueshme të kuptimit të drejtë të kësaj dukurie në mbarë rajonin. Ka sfida të shumta jo vetëm për ta përkufizuar shtrirjen e trafikimit të qenieve njerëzore, por edhe për të identifikuar viktimat në internet dhe jashtë tij, për të kuptuar dinamikat sociale midis trafikantëve dhe personave të trafikuar dhe, madje, edhe për të dalluar trafikimin nga krime të tjera të ngjashme si kontrabandimi i njerëzve ose puna ndërkombëtare e seksit.³¹

Në vitin 2020, UNODC-ja përlogariste se një nga pesë gra, të identifikuar si viktima të trafikimit në Evropën Perëndimore, ishte nga Evropa Juglindore.³² Të dy, edhe UNODC-ja, edhe Departamenti Amerikan i Shtetit, publikojnë statistika për numrin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore (të ndara sipas formës së shfrytëzimit) në Ballkanin Perëndimor dhe japin një panoramë të përgjithshme të fëmijëve viktima.³³ Këto tregojnë se, ndonëse numri më i madh i viktimave të shfrytëzimit seksual janë gra të rritura, numri i vajzave nuk duhet nënvlerësuar.³⁴ Krahas kësaj, ndërkohë që numri i viktimave meshkuj, i zbuluar në rajon, në përgjithësi është më i ulët sesa ai i femrave, djemtë janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual sesa burrat e rritur.³⁵

Informacionet dhe të dhënat për shfrytëzimin seksual tregtar të fëmijëve në Ballkanin Perëndimor mungojnë edhe për faktin se kjo problematikë rrallë herë raportohet ose trajtohet në median lokale. Më tej, strukturat përgjithësisht patriarkale dhe tradicionale të shoqërive në Ballkanin Perëndimor nxisin me të madhe përhapjen e besimit se shfrytëzimi seksual i fëmijëve ose nuk ekziston, ose është përjashtim dhe jo rregull.

Dëshmitë që paraqiten në këtë raport lënë të kuptohet e kundërta: të dhënat e mbledhura në lidhje me fëmijët tregojnë ekzistencën e dobësive dhe ekspozimit ndaj shfrytëzimit për qëllime seksuale. Këto dobësi janë shtuar gjatë viteve të fundit për shkaqe të ndryshme, siç janë zhvillimet teknologjike dhe rritja e turizmit në mbarë rajonin. Deri më tani, në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, duket se nuk ka qasje koherente as nga qeveritë dhe as nga agjencitë e zbatimit të ligjit, shoqëria civile ose sektori privat për të parandaluar dhe ulur ekspozimin e fëmijëve ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual. Edhe pse kuadrot ligjorë kombëtare përputhen gjerësisht me standardet ndërkombëtare, zbatimi i tyre shpesh pengohet nga mungesa e vetëdijesimit, kapacitetit dhe madje e mjeteve teknologjike për trajtimin efikas të kësaj dukurie.

Siç do të shqyrtohet më hollësi në pjesët në vijim, faktorët socio-ekonomikë rajonalë, të kombinuar me paqëndrueshmërinë institucionale dhe mungesën e raportimit dhe zbatimit të përshtatshëm të kuadrove ligjore dhe mekanizmave të reagimit, u kanë hapur rrugën disa manifestimeve të SHSTF-së, duke përfshirë martesën e fëmijëve dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve përmes teknologjive digjitale dhe/ose në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit.

Ndonëse numri më i madh i viktimave të shfrytëzimit seksual janë gra të rritura, numri i vajzave nuk duhet nënvlerësuar.



SHFRYTËZIMI SEKSUAL TREGTAR I FËMIJËVE NË GJASHTË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Fëmijët romë dhe fëmijët në lëvizje janë veçanërisht të rrezikuar nga kjo formë shfrytëzimi në rajon. © *Bahrudin Bandic*

SHSTF-ja manifestohet në disa forma të ndërlidhura në Ballkanin Perëndimor, ku bëjnë pjesë: trafikimi seksual i të miturve, shfrytëzimi i fëmijëve në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit, martesë e fëmijëve, shfrytëzimi seksual në vende si bordellot, baret dhe klubet e striptizit, dhe krijimi dhe shpërndarja e materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve, duke përfshirë, ndër të tjera, inçizimin, transmetimin e drejtpërdrejtë, shpërndarjen dhe shkarkimin e materialeve ku paraqitet shfrytëzimi seksual i të miturve.³⁶ Dhe problemi duket se vazhdon të përkeqësohet.

Në kapitullin vijues do të shohim manifestimet kryesore të SHSTF-së në mbarë Ballkanin Perëndimor. Do të paraqesim edhe një panoramë të hollësishme të shfrytëzimit seksual në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit, shfrytëzimit të mundësuar nga teknologjia dhe martesave të fëmijëve. Megjithatë, pavarësisht pikave të ndryshme të vëmendjes, është e rëndësishme të mbahet parasysh se jo të gjitha rastet janë "të prera me thikë". Në fakt, janë konstatuar shumë mbivendosje, jo vetëm midis llojeve të ndryshme të shfrytëzimit, por edhe midis metodave që përdoren. Se sa ngushtë lidhen me njëra-tjetrën format e ndryshme të shfrytëzimit, kjo bëhet e qartë edhe kur shohim profilin e fëmijëve në rrezik dhe tipat e autorëve të krimit, të cilët përshkruhen në pjesën e dytë të këtij kapitulli.

Përmbledhje

- Fëmijët që rrezikojnë të bien pre e SHSTF-së shpesh kanë një profil të ngjashëm, i cili shpesh ka për themel disa rrethana specifike socio-ekonomike të familjes dhe mungesën e sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve. Fëmijët romë dhe fëmijët në lëvizje janë identifikuar si fëmijët që janë në rrezik më të madh.
- Përkundër kësaj, për shkak se mungojnë hulumtimet shkencore dhe të dhënat nga gjykatat, nuk ka profil të përbashkët për autorët e krimit, të përfshirë në SHSTF.
- Forma të ndryshme të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Ballkanin Perëndimor ndihmohen nga teknologjia dhe kanë të bëjnë me ndjelljen ose krimin e njohjeve me qëllim shfrytëzimi ("grooming"), shkëmbimin e mesazheve me përmbajtje seksuale ("sexting"), zhvatjen seksuale ("extortion"), transmetimin e drejtpërdrejtë në internet të abuzimit seksual ose MASF-në. Rastet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve, të mundësuar nga teknologjia, janë duke u shtuar në numër në Ballkanin Perëndimor.
- Martesa e fëmijëve shpesh ndodh brenda komuniteteve minoritare etnike në Ballkanin Perëndimor, sidomos në komunitetin e romëve. Kjo praktikë shpesh çon në dinamika ekstreme dhe të përhershme shfrytëzimi, duke përfshirë këtu shfrytëzimin seksual dhe shfrytëzimin në punë.
- Edhe shfrytëzimi seksual në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit duket se ndjek modelet e tjera të trafikimit të fëmijëve. Kur marrim parasysh SHSF-UT-në, nuk është e rëndësishme të shohim vetëm shfrytëzimin brenda industrisë së turizmit, por edhe vullnetarizmin dhe punën sezonale. Megjithatë, duke qenë se ky nuk konsiderohet si krim i veçantë në Ballkanin Perëndimor, të dhënat lidhur me mbizotërimin e tij janë të rralla.
- Pandemia "Kovid-19" ka rritur ekspozimin e fëmijëve nda rrezikut të shfrytëzimit seksual në internet dhe në jetën reale, duke qenë se pandemia përkeqëson disa prej faktorëve kryesorë që bëjnë të lehtë vetë shfrytëzimin seksual.

Industria e udhëtimeve dhe turizmit

Sikurse kemi përmendur më lart, SHSF-UT-ja është një prej manifestimeve të SHSTF-së në Ballkanin Perëndimor. SHSF-UT-ja zakonisht i referohet shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve nga njerëz që udhëtojnë nga rrethi, rajoni ose shteti i tyre drejt një vendi tjetër me qëllim që të kryejnë veprimtari seksuale me të mitur. Individët që përfshihen në SHSF-UT mund të jenë udhëtarë vendas ose turistë ndërkombëtarë. SHSF-UT-ja zakonisht ka të bëjë me përdorimin e akomodimit, transportimit dhe shërbimeve të tjera të ndërlidhura me turizmin, të cilat mundësojnë kontaktin me fëmijët dhe u mundësojnë autorëve të krimit, në njëfarë mase, që të mos bien në sy. SHSF-UT-ja përfshin shkëmbimin e parave fizike, rrobave, ushqimeve ose gjërave të tjera me rëndësi për fëmijën ose një palë të tretë përkundrejt kontaktit seksual.³⁷ Sipas organizatës "End Child Prostitution and Trafficking" (Fund prostitucionit dhe trafikimit të fëmijëve [ECPAT]), disa shfrytëzues të SHSF-UT-së, ku përfshihen abuzuesit me fëmijët dhe pedofilët, shënjestrojnë të miturit, në mënyrë specifike, ndërkohë që të tjerët "përfitojnë nga situata ku fëmijët u vihen atyre në dispozicion".³⁸

Përpara pandemisë, turizmi ishte një prej industrive më të mëdha dhe me rritjen më të shpejtë në Ballkanin Perëndimor. Rajoni ka regjistruar një rritje të konsiderueshme vjetore në numrin e turistëve të huaj, pas liberalizimit të vizave me BE-në në vitin 2009/2010. Mbi një milionë turistë janë regjistruar se kanë udhëtuar për në Mal të Zi në vitin 2018 dhe 2019.³⁹ Në Shqipëri, numri i të huajve që hyjnë në vend pothuaj është dyfishuar midis vitit 2014 (3 415 550 mbërritje) dhe 2019 ((6 094 889 mbërritje),⁴⁰ ndërkohë që në Kosovë, numri i turistëve të huaj pothuaj është katërfishuar midis vitit 2014 (46 477) dhe 2019 (177 358).⁴¹ Në fakt, të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë bërë një prej destinacioneve kryesore turistike jo vetëm për njerëzit që jetojnë dhe punojnë në rajon, por edhe për udhëtarët nga Turqia, BE-ja dhe Rusia.⁴² Edhe pse kjo është gjë e mirë për industrinë e turizmit në rajon, kjo paraqet rritje të rreziqeve për shfrytëzim seksual të fëmijëve, sidomos të atyre nga komunitetet e cënueshme.⁴³

▼ Fëmijët nga e gjithë

Shqipëria kontaktohen përmes internetit dhe sillen në qendrat urbane si Tirana, e paraqitur më poshtë, për shfrytëzim seksual.

© Besart Cani






FIGURA 7 Industria e turizmit si përqindje ndaj PBB-së.

SHËNIM: Nuk janë ofruar të dhëna për Kosovën.

BURIMI: World Travel and Tourism Council, Economic Impact Reports for Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, North Macedonia and Serbia [Raportet e ndikimit ekonomik për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë], hulumtimi vjetor për vitin 2020: gjetjet kryesore, <https://wtcc.org/Research/Economic-Impact>.

Në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, rregullimi i dobët i turizmit (duke përfshirë edhe daljen në pah të shërbimeve turistike informale), kapaciteti i ulët i agjencive ligjzbatuese të ngarkuara me detyrën e garantimit të mbrojtjes për fëmijët dhe mungesa e ekspertizës në lidhje me SHSTF-në në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit kanë rritur rrezikun e shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Shumë OJQ në mbarë rajonin kanë vënë re një prirje shqetësuese gjatë viteve të fundit. Ato raportojnë se shfrytëzimi ndodh shpesh në industrinë e hotelerisë dhe kanë vënë në dukje rritjen e rreziqeve gjatë verës, sidomos në bregdetin Adriatik.⁴⁴

Ka pak të dhëna ose informacione lidhur me prevalencën e SHSF-UT-së në Ballkanin Perëndimor, duke qenë se kjo problematikë nuk raportohet ose trajtohet shpesh në mediet lokale, industrinë e udhëtimeve dhe turizmit ose nga sistemi i drejtësisë penale. Pjesë e këtij problemi është fakti që SHSF-UT-ja nuk përkufizohet si krim i veçantë në kodet penale të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, prandaj agjencitë përgjegjëse për zbatimin e ligjit nuk kanë regjistruar asnjë rast zyrtar ose gjykatat lokale nuk kanë trajtuar asnjë rast të tillë gjatë viteve të fundit. Kjo gjendje është rezultat i një shqyrtimi të kodeve penale në fuqi në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi dhe i hulumtimit të statistikave të disponueshme për trafikimin e qenieve njerëzore. Siç do të përshkruhet më poshtë, SHSF-UT-ja zakonisht trajtohet si trafikim qeniesh njerëzore në përgjithësi ose si "abuzim me fëmijët". Megjithatë, përfaqësuesit e institucioneve publike, me të cilët jemi konsultuar për qëllime të këtij raporti, konfirmuan se ata kanë parë një rritje të numrit të rasteve, sidomos gjatë sezonit veror të pushimeve.⁴⁵



FIGURA 8 Vendet kyçe të pushimeve dhe të shfrytëzimit në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

SHËNIM: Figura paraqet një analizë të thellë të shpërndarjes rajonale, por nuk është shteruese. Të intervistuarit nuk përmendën vatra të nxehta që janë specifike për shfrytëzimin seksual të fëmijëve në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit në Kosovë.



SHSF-UT-ja duket se është e lidhur ngushtë me modelet e trafikut të brendshëm të fëmijëve, si formë trafiku të fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual. Pavarësisht kësaj, ajo nuk ka lidhje vetëm me industrinë e hotelierisë, por edhe me baret, restorantet, operatorët turistikë dhe të evenimenteve dhe, më gjerë, edhe me kompanitë e transportit. Krahas kësaj, SECTT-ja përfshin edhe incidente si rasti famëkeq "David Braun" në vitin 2008, ku një qytetar britanik menaxhonte një jetimore në Tiranë të Shqipërisë, por u shpall i fajshëm për abuzim seksual me fëmijët që qëndronin aty.⁴⁶ Merret e mirëqenë se edhe shumë udhëtarë të tjerë ndërkombëtarë që kanë ardhur për ta vizituar jetimoren janë përfshirë në këtë praktikë.⁴⁷ Ndonëse kanë kaluar mbi 10 vjet nga ky rast, ai shërben për të përfaqësuar problematikat më të gjera që kanë të bëjnë me SHSF-UT-në, domethënë cenueshmëria e llojeve të ndryshme të organizatave ndaj udhëtarëve të huaj që vijnë si vullnetarë. Shumë institucione që punojnë me vullnetarë nuk bëjnë kontrolle të historikut të tyre, nuk vënë në fuqi politika për mbrojtjen e fëmijëve ose nuk u ofrojnë vullnetarëve trajnim të përshtatshëm, duke krijuar kështu mundësi që autorët që udhëtojnë për qëllime të seksit me fëmijë ta kenë të lehtë të kenë qasje te fëmijët.⁴⁸ Në këtë kuadër, edhe ndikimi i punonjësve sezonalë monitorohet ngushtësisht për ndikimin që ka te SHSF-UT-ja në Malin e Zi.⁴⁹

Martesa e fëmijëve

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut e përkufizon "martesën e fëmijëve" si "martesë ku të paktën njëra prej palëve është nën 18 vjeç" dhe e përshkruan si martesë të detyruar, d.m.th. kur një ose të dy palët nuk kanë shprehur personalisht miratimin e tyre të plotë e të lirë për t'u martuar.⁵⁰

Sipas Fondit Ndërkombëtar të Emergjencave të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), rreth 650 milionë gra që janë gjallë sot në botë, janë martuar si fëmijë. Numri i përgjithshëm i vajzave të martuara në fëmijëri aktualisht përllorëritet të

▲ Rritja e madhe e industrisë së turizmit në Ballkanin Perëndimor ka paraqitur rrezikun për shfrytëzimin seksual të fëmijëve. Më lart, një prej destinacioneve më të famshme turistike të Shqipërisë në Durrës. © Besart Cani

*Format e ndryshme
shfrytëzimi
karakterizojnë në
mënyrë progresive
jetët e fëmijëve romë.*

jetë 12 milionë në vit.⁵¹ Gjithashtu, ndërkohë që Azia Jugore ka pësuar një ulje të konsiderueshme të rasteve të martesave të fëmijëve gjatë dekadës së fundit, barra globale ka rënë mbi supet e vendeve afrikane nën-sahariane, të cilat po dëshmojnë aktualisht norma dramatike të larta.⁵²

Në Ballkanin Perëndimor, martesat e fëmijëve është e përhapur sidomos te minoritetet, veçanërisht te komunitetet rome.⁵³ Ekspertët shpjegojnë se prindërit dhe anëtarët me ndikim të komunitetit bëjnë shkuesi sa më shpejt që mundet, për të shmangur shtatzëninë e jashtëligjshme dhe turpin në sy të botës që do të shkaktonte një gjë e tillë.⁵⁴ Krahas kësaj, kur martesat organizohet me dhëndurë që vijnë nga jashtë shtetit, përfshihen edhe ndërmjetësuesit nga komunitetet e tjera rome.⁵⁵ Ka edhe raporte për fëmijë që kërkojnë vetë të martohen në moshë të hershme, gjë që të jep të kuptosh se sa thellë është rrënjësuar kjo dukuri te komunitetet rome.⁵⁶

Një tjetër element kyç i martesës së fëmijëve është edhe kompensimi monetar i familjes së vajzës. Të gjithë të intervistuarit konfirmuan se nuk mund të ketë martesë pa përfitimin financiar të familjes dhe, pas shitjes, vajza zakonisht ndërpret të gjitha lidhjet me prindërit dhe familjen e saj.⁵⁷ Sa për të krijuar një ide për shumën e parave, nga raporti i një rasti gjyqësor, të zhvilluar në Banja Lukë të Bosnjës dhe Hercegovinës, në vitin 2020, një baba e shiti vajzën e tij 13-vjeçare për 2 300 KAM (1 180 euro) dy burrave të rritur, të cilët, më pas, abuzuan me të.⁵⁸

Shumë vajza rome detyrohen të martohen brenda vetë komunitetit të tyre ose me komunitete të tjera rome në mbarë rajonin. Për shembull, ka raporte për vajza rome nga veriu i Shqipërisë të cilat janë duke u detyruar të martohen në komunitete nga Maqedonia e Veriut ose Kosova dhe për vajza rome nga Kosova që martohen, kundër vullnetit të tyre, në komunitete rome në Mal të Zi.⁵⁹ Modele të ngjashme janë vënë re edhe te komunitetet rome në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Rumani.⁶⁰

Hulumtimet në terren kanë treguar se ka dinamika shfrytëzimi ekstrem dhe të përhershëm: raportohet se në Maqedoninë e Veriut, një vajzë rome ishte detyruar të martohej katër herë dhe kishte lindur fëmijë, numri i të cilëve nuk dihej.⁶¹ Në raste të tjera, doli në pah mënyra se si format e ndryshme të shfrytëzimit karakterizojnë, në mënyrë progresive, jetën e fëmijëve romë. Të shfrytëzuar në fillim për lypje të detyruar ose lustrim këpucësh, shumë fëmijë romë raportohet se, në fakt, kanë qenë subjekt i shfrytëzimit seksual tregtar në bare, bordello dhe klube striptizi.⁶²

Në figurën 9 paraqiten modelet që kanë dalë në dritë gjatë hulumtimit shkencor, të cilat tregojnë se si i mashtrojnë shfrytëzuesit fëmijët romë dhe se si, nëpërmjet premtimeve të rreme, fëmijët futen në forma të ndryshme shfrytëzimi, shpesh të organizuara nga rrjetet kriminale.

Për shembull, fëmijët romë në Maqedoninë e Veriut raportohet se detyrohen të futen në punë shfrytëzuese nëpërmjet abuzimit verbal dhe fizik ose nëpërmjet imponimit të substancave narkotike.⁶³ Në Mal të Zi, shfrytëzimi i fëmijëve romë është i organizuar aq mirë sa që lypja dhe martesat e fëmijëve janë hyrje e shkurtër drejt shfrytëzimit më të rëndë seksual tregtar gjatë një faze të mëvonshme.⁶⁴




FIGURA 9 Format e ndërlidhura të shfrytëzimit në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

SHËNIM: Hulumtimet shkencore mbi martesën e fëmijëve kanë nxjerr shpesh në dritë mbivendosjet dhe lidhjet midis formave të shfrytëzimit që ka të bëjë me punën dhe SHSTF-së, si dhe midis formave të ndryshme të SHSTF-së.

Edhe pse pjesa më e madhe e shfrytëzimit është duke ndodhur brenda rajonit, ka raporte edhe për trafikim të fëmijëve romë drejt Evropës Perëndimore (Francë, Itali dhe Gjermani), ku detyrohen të martohen me dhëndurë nga komunitetet lokale rome.⁶⁵ Në vitin 2015, rasti "Hamidoviç" u vu në qendër të vëmendjes kur autoritetet ligjzbatuese të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Francës, së bashku me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësi Penale, zbuluan një rrjet ndërkombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore, i cili vepronte nga Parisi. Hamidoviçi, shtetas boshnjak, u shpall fajtor për shfrytëzimin e më shumë se 500 vajzave dhe grave (kryesisht rome), të cilat ishin trafikuar nga Bosnja dhe Hercegovina drejt Francës dhe ishin detyruar të lypnin, të vidhnin xhepat dhe të bënin punë të seksit.⁶⁶ Në disa raste, për të anashkaluar kontrollet kufitare dhe për të siguruar trafikimin e suksesshëm të vajzave drejt Francës, ishin kryer paraprakisht edhe martesa fëmijësh.⁶⁷

Ka shenja që tregojnë se shfrytëzimi seksual tregtar i fëmijëve romë është duke u zhvendosur në internet. Në vitin 2017, një rast ku ishte përfshirë një shtetas evropian tregoi se si vajzat rome nga zonat e vogla urbane në veri të Serbisë në fillim josheshin me premtime të rreme për punë në industrinë e modës dhe më pas bëheshin subjekt i materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve, të cilat shiteshin në internet.⁶⁸ Siç përshkruhet më poshtë, kjo është pjesë e një prirjeje më të gjerë drejt SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia

Ndonëse në nivel kombëtar, në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ka të dhëna të kufizuara lidhur me SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia, përfaqësuesit e OJQ-ve nga rajoni tregojnë se ky problem në shtetet e tyre është duke u përkeqësuar.

SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia zakonisht fillon me ndjelljen ("grooming": krijimin e marrëdhënies me viktimën e mitur), pastaj me sekstingun (krijimi dhe/ose bashkëndarja e imazheve me përmbajtje seksuale të viktimës), zhatjen seksuale (shantazhimi i fëmijës viktimë duke përdorur imazhet e tij me qëllim zhatjen e favoreve seksuale ose parave) ose abuzimin seksual të drejtpërdrejtë (detyrimi i fëmijës për të kryer akte seksuale) dhe materialet e seksualizuara të MASF-së ku paraqiten fëmijë.




FIGURA 10 Fazat dhe elementet e SHSTF-së në internet.

BURIMI: ECPAT International, Online child sexual exploitation: A common understanding [Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet: Kuptimi i përbashkët], maj 2017, https://www.ecpat.org/wp-content/uploads/2017/05/SECO-Booklet_ebook-1.pdf.

Sipas një studimi të vitit 2020 të kryer nga UNICEF-i, Njësia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike në Shqipëri kishte marrë 5 000 deri në 20 000 rekomandime në vit nga partnerët ndërkombëtar si INTERPOLI, EUROPOL-i dhe NCMEC-ja, në lidhje me posedimin, shpërndarjen, prodhimin dhe përdorimin e MASF-së.⁶⁹ Vetëm NCMEC-ja ka referuar 6 300 raste imazhesh të pahijshme të fëmijëve midis janarit dhe tetorit të vitit 2019, ku mesatarja e përdoruesve që kishin qasje dhe bashkëndanin materialet e abuzimit ishte rreth 200.⁷⁰

Në Shqipëri, një në katër fëmijë raportonte se kishte kontakt në internet me të paktën një person të cilin nuk e kishin takuar kurrë më përpara personalisht dhe pothuaj dy nga 10 raportonin se kishin takuar dikë personalisht, të cilin e kishin njohur më përpara vetëm nga interneti. Një në dhjetë fëmijë raportonte të paktën një përvojë seksuale të padëshiruar përmes internetit.⁷¹



FIGURA 11 Domeni shqiptar ".al"

BURIMI: Sibt Ali et al, Çështjet e humbura: Gjetje dhe rekomandime nga një vlerësim i thelluar i mangësive në hetimin e abuzimit seksual në internet të fëmijëve në Shqipëri, UNICEF Shqipëri, gusht 2020, [https://www.unicef.org/albania/media/3386/file/The%20lost%20cases%20\(ALB\).pdf](https://www.unicef.org/albania/media/3386/file/The%20lost%20cases%20(ALB).pdf).

Hulumtimi i kryer në vitin 2016 nga "Save the Children" në Ballkanin Veriperëndimor dhe OJQ-ja "Qendra për Kërkime Politikash Penale" (Criminal Policy Research Centre) lidhur me qëndrimet sjellore të fëmijëve, prindërve dhe mësuesve në internet në Bosnjë dhe Hercegovinë ka nxjerrë rezultate alarmuese: 48,5% e fëmijëve kanë marrë mesazhe nga njerëz të panjohur në internet; një në katër fëmijë (23,1%) u është përgjigjur atyre mesazheve dhe një në dhjetë fëmijë (11,4%) kishte thënë se do të ishte dakord të takohet (në jetën reale) me personin me të cilin kishin folur në internet.⁷² Të dhënat statistikore të institucioneve gjyqësore tregojnë se është duke u rritur abuzimi seksual i fëmijëve në internet.⁷³ Më tej, në vitin 2019, në Republikën Serbe (në Bosnjë dhe Hercegovinë) u raportuan 117 vepra penale në fushën e krimit të teknologjisë së lartë, 67 vepra më shumë se në vitin 2018. Shfrytëzimi i fëmijëve për qëllime pornografie dhe seksuale është një ndër veprat penale më të zakonshme.⁷⁴

Midis viteve 2015 dhe 2019, Qendra Kombëtare Serbe e Kontaktit për Sigurinë e Fëmijëve në Internet ka marrë 19 500 komunikime (telefonata, e-maile, etj.) lidhur me keqpërdorimin e mundshëm të internetit në lidhje me fëmijët. Më tej, një në tre fëmijë në Serbi raportohet se ka pasur ndonjë përvojë shqetësuese në internet gjatë vitit të mëparshëm, sipas anketës së vitit 2019 për vendin të UNICEF-it "Për përdorimin e internetit dhe teknologjisë digjitale të fëmijët dhe të rinjtë".⁷⁵ Megjithatë, policia ka pasur njëfarë shkalle suksesi në shkatërrimin e këtij krimi. Në vitin 2019, në kuadër të operacionit policor "Armageddon", u sekuestruan më shumë se 15 terabajt materiale abuzimi, u ngritën mbi 200 akuza penale dhe dhjetëra persona u arrestuan në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA dhe në vende të tjera.⁷⁶

Numri real i rasteve të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia mund të jetë ndjeshëm më i lartë sesa numri i raportuar ose i identifikuar.

Në Maqedoninë e Veriut, në aplikacionin "Telegram" për celularë, në fillim të vitit 2020 u krijua një grup me më shumë se 7 000 përdoruesish me qëllim shpërndarjen e materialeve abuzive të adoleshenteve dhe të reja.⁷⁷ Nuk ka të dhëna lidhur me veprimet e ndërmarra kundër autorëve të krimit, edhe pse agjencitë ligjzbatuese ishin në dijeni të administratorëve të grupit të rrjetit social. Raste të ngjashme u raportuan edhe në Serbi në mars të vitit 2021, ku disa autorë u arrestuan për shpërndarje materiale pornografike që përfshinin fëmijë dhe u dënuan me deri në dhjetë vjet heqje lirie.⁷⁸

Në Mal të Zi, sipas një ankete të UNICEF-it, 29% e fëmijëve, ose rreth 20 000 fëmijë, shpreheshin se kishin parë në internet fotografi me përmbajtje të qartë seksuale.⁷⁹

Duke qenë se aftësia e agjencive ligjzbatuese për të zbuluar SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia vazhdon të jetë në hapat e parë dhe numri i mekanizmave të raportimit është fare i paktë dhe meqë nuk ka monitorim sistematik të prirjeve, mendohet se numri real i rasteve mund të jetë konsiderueshëm më i lartë sesa ai që raportohet ose sesa rastet e identifikuara.

Ngacmimi në internet dhe krimet e mundësuar nga interneti

Një segment i rëndësishëm që kërkon ndërhyrje të përbashkët në rajonin e Ballkanit Perëndimor është ai i lojërave në internet dhe i platformave të shkëmbimit të mesazheve, të cilat janë identifikuar si kanale për faktorë të ndryshëm kërcënimi që cenojnë fëmijët duke filluar nga privatësia, abuzimi e deri te manipulimi dhe radikalizimi.

Sikurse u shpreh një ekspert i krimeve kibernetike në Shoqatën maqedonase të Sigurisë Korporative, dy prej formave më të zakonshme të ngacmimit në lojërat në internet janë doksingu ("doxing") dhe suatingu ("swatting"). Doksingu ndodh atëherë kur një ose më shumë pjesëmarrës në internet kërkojnë informacione identifikuese personale në lidhje me një përdorues të caktuar për qëllime shantazhimi ose kërcënimi. Doksingu shpesh mund të çojë në publikimin e emrave realë, numrave të telefonit, adresave të shtëpisë, informacioneve rreth punëdhënësit dhe shumë gjëra të tjera. Suatingu është formë ngacmimi për realizimin e të cilit përdoren teknikat e doksingut për të krijuar një kërcënim real dhe të prekshëm. Ngacmuesi i telefonon agjencisë ligjzbatuese lokale të përdoruesit të doksuar për ta kërcënuar këtë të fundit, shpesh duke pretenduar se është duke ndodhur një rrëmbim ose pengmarrje në adresën e viktimës, me qëllim që të kërcënojë, shantazhojë dhe ushtrojë kontroll mbi viktimën.

Profili i fëmijëve në rrezik

Ka pak të dhëna lidhur me numrin e fëmijëve të shfrytëzuar dhe grupmoshave të tyre, por të dhënat lënë të kuptohet se fëmijët e ekspozuar ndaj rrezikut të SHSTF-së në mbarë Ballkanin Perëndimor—qoftë në internet dhe në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit, qoftë për martesë fëmijësh—kanë një profil të ngjashëm. Në fakt, të intervistuarit—përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile—pohonin se faktorët e rrezikut kanë të bëjnë kryesisht me rrethanat socio-ekonomike familjare të fëmijëve (varfëria dhe papunësia e lartë, niveli i ulët i arsimit, përjashtimi social, historiku me abuzimin/alkoolizmi, etj.), mungesa e angazhimit dhe parandalimit nga sistemi i kujdesit social dhe mbrojtjes së fëmijëve, si dhe mungesa e qasjes në informacionet rreth SHSTF-së në komunitet.⁸⁰

Të dhënat nga Maqedonia e Veriut tregojnë se fëmijët që janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të SHSTF-së/SHSF-UT-së janë vajzat dhe se shumica e viktimave janë midis 13 dhe 17 vjeç.⁸¹ Pjesa më e madhe e tyre trafikohen brenda vendit për shfrytëzim seksual tregtar dhe punë të detyruar në restorante, bare, hotele, motele në autostrada, klube nate dhe qendra akomodimi joluksoze jashtë qyteteve, të cilat frekuentohen nga banorët vendas dhe udhëtarët.⁸² Edhe pse nuk ka studime gjithëpërfshirëse për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ekspertët me të cilët zhvilluam konsulta për këtë raport konfirmonin se ata kishin vëzhguar modele të ngjashme në vendet e tjera të rajonit. Hulumtuesit theksonin se cenueshmëria e djemve ndaj SHSTF-së nuk duhet të nënvlerësohet,⁸³ pohim ky që duket se përputhet me literaturën e përgjithshme mbi SHSTF-në.

Spektori i OJQ-ve ka identifikuar disa karakteristika që kanë të bëjnë veçanërisht me viktimat e shfrytëzimit në internet. Ndonëse në Shqipëri, SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia prek kryesisht adoleshentët (mosha 11-17 vjeç), OJQ-të në Maqedoninë e Veriut raportojnë se të ekspozuar ndaj rrezikut janë edhe fëmijët më të vegjël, duke marrë parasysh që ata e përdorin internetin gjithmonë e më shumë dhe në moshë të hershme. Edhe vajzat në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut u identifikuan si të ekspozuara ndaj një rreziku më të lartë për t'u bërë viktimat të shfrytëzimit seksual tregtar të mundësuar nga teknologjia. Intervistat e realizuara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Maqedoninë e Veriut lënë të kuptohet se viktimat përzgjidhen me kujdes, sipas faktorëve të ndryshëm të rrezikut, në lidhje me shëndetin e tyre mendor e fizik dhe shprehive të tyre të dobëta sociale, gjë që i bën ato edhe më të hapura ndaj sugjerimeve dhe manipulimit.

▼ Familje rome në Beograd të Serbisë. © Vladimir Zivojinovic



Pjesa më e madhe e fëmijëve romë jetojnë në shtëpi të mbipopulluara, ku mungon uji i pijshëm, energjia elektrike, ngrohja dhe sanitimi.

Cenueshmëria e romëve

Fëmijët romë janë veçanërisht të cenueshëm ndaj shfrytëzimit seksual tregtar. Në vitin 2014, për shembull, Komisioni Evropian publikoi një raport për SHSF-UT-në ku trajtoheshin në veçanti cenueshmëria me të cilat përballen fëmijët romë në lëvizje në Kosovë. Raporti zbuloi se si disa fëmijë ishin detyruar të lëviznin midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, zakonisht gjatë verës, ose midis Shqipërisë dhe Kosovës në verë dhe në dimër.⁸⁴ Megjithatë, raportet e organizatave ndërkombëtare ose joqeveritare për fëmijët romë dhe SHSTF-në në Ballkanin Perëndimor janë të rralla. Raportet që ekzistojnë shpesh janë të vjetërsuara, por të vjetërsuara janë edhe të dhënat demografike specifike rreth komuniteteve rome.⁸⁵

Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një popullsi të konsiderueshme rome, që varion nga gjashtë dhe tetë mijë njerëz në Shqipëri dhe Mal të Zi deri në rreth 150 000 në Serbi.⁸⁶ Përlllogaritja e madhësisë së komunitetit romë në mbarë Ballkanin Perëndimor është sfiduese, duke qenë se shumë prej anëtarëve të këtij komuniteti jetojnë në vendbanime joformale me qasje të kufizuar në infrastrukturë dhe institucionet sanitare. Për shembull, në Shqipëri, më pak se 50% e të gjitha familjeve rome kanë qasje në ujin që vjen me çezmë.⁸⁷ Procesi i formalizimit të këtyre vendbanimeve ka qenë i ngadaltë. Shumë komunitete rome vazhdojnë të jetojnë si grupe të mbyllura, me pak qasje në ekonominë formale ose shërbimet qeveritare. Për shembull, në Kosovë, vetëm 10% e romëve mbi moshën 16 vjeçare raportohet se kanë qasje në sigurimin e shëndetit.⁸⁸

Ruajtja e gjuhës së tyre dhe zakoneve të jetës nomade ose gjysmë-nomade, e gërshetuar me marginalizimin në vendbanime të veçuara, ka çuar në vazhdimin e stereotipave lidhur me mënyrën e tyre të jetesës, kulturës, gjuhës dhe traditave, gjë që e ka vështirësuar më tej integrimin e tyre në shoqëritë lokale.⁸⁹

Përrjashtimi, paragjykimi dhe diskriminimi ndikojnë në jetën dhe mundësitë e komunitetit romë në jetën e tyre të përditshme, sidomos të fëmijëve romë, të cilët vazhdojnë të kenë nivel të ulët përfshirjeje në arsim. Në Serbi, për shembull, më pak se 4% e fëmijëve romë përfshihen në arsimin parashkollor. Vetëm gjysma e atyre që regjistrohen në klasë të parë arrijnë në klasën e pestë.⁹⁰ Në Bosnjën dhe Hercegovinën fqinje, vetëm 2% e fëmijëve romë midis tre dhe pesë vjeç regjistrohen në programet arsimore.⁹¹ Edhe statistikat e Bankës Botërore janë të ngjashme: ato tregojnë se dy nga pesë fëmijë romë marrin arsim jocilësor në shkolla të ndara dhe se vetëm një nga tre prej tyre përfundojnë shkollën e mesme. Krahas kësaj, pjesa më e madhe e fëmijëve romë jetojnë në shtëpi të mbipopulluara, ku mungon uji i pijshëm, energjia elektrike, ngrohja dhe sanitimi.⁹²

Këto nivele të ulëta arsimimi dhe mobiliteti social i bëjnë shumë fëmijë romë të cenueshëm ndaj formave të ndryshme të shfrytëzimit: si brenda komunitetit, ashtu edhe në raport me rrijetet e krimit të organizuar që veprojnë në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. Hulumtimet e mëparshme dhe artikujt në media shpesh fokusohen te fëmijët romë që shfrytëzohen për lypje të detyruar dhe vjedhje xhepush.⁹³ Fëmijët (sidomos djemtë) shpesh trafikohen nga zonat nënurbane drejt atyre urbane për qëllime të lypjes në rrugë.⁹⁴ Për shembull, në Tiranë të Shqipërisë, përlllogaritet se ka qindra fëmijë që nxjerrin jetesën duke lypur, duke shitur artikuj në rrugë dhe duke lustruar këpucët.⁹⁵ Megjithatë, ka pasur edhe raportime për fëmijë meshkuj që jetojnë në rrugë dhe që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual në klube nate edhe si kërcimtarë, por edhe si punonjës të seksit.⁹⁶

Prirjet në zhvillim

Rreziku i lartë i fëmijëve në lëvizje për t'u ekspozuar ndaj SHSTF-së: Që prej "krizës së refugjatëve" të viteve 2015-2016, rruga Ballkanike është bërë shtegu kryesor për emigrantët dhe refugjatët që nisen drejt Evropës Perëndimore. Sikurse përshkruhet në një raport të fundit të Inicativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, si të rriturit, ashtu edhe të miturit e pashoqëruar, kanë udhëtuar përmes dy korridoreve kryesore: "korridorit qendror" që kalon nga Greqia për te Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia dhe të çon në Hungari dhe "korridorit perëndimor" që shtrihet në bregdetin e Adriatikut nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina drejt Kroacisë.




FIGURA 12 Mbërritjet në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, deri në fund të vitit 2019.

BURIMI: UNHCR, Western Balkans – Refugees, asylum-seekers and other mixed movements [Ballkani Perëndimor—Refugjatët, azilkërkuesit dhe lëvizjet e tjera të përziera], <https://data2.unhcr.org/en/documents/download/73832>.

Edhe pse numrat zyrtarë të të miturve të pashoqëruar janë relativisht të ulët, dëshmitë lënë të kuptohet se numri real është konsiderueshëm më i lartë sesa ai që pasqyrohet në statistikat zyrtare, sidomos nëse marrim parasysh që një numër i konsiderueshëm i të miturve zgjedhin të vetëdeklarohen si më të rritur se 18 vjeç me qëllim që të mos veçohen nga emigrantët e tjerë.⁹⁷

Në mbarë rajonin, rritja e madhe e emigrantëve të padokumentuar brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore ka shkaktuar presion të konsiderueshëm mbi kapacitetet administrative dhe pritëse, çka nënkupton se nevojat bazë të emigrantëve shpesh nuk përmbushen. Krahas kushteve kritike higjienike dhe mungesës së qasjes në kujdesin shëndetësor parësor — probleme këto me të cilat duhet të ndeshen shumica e emigrantëve—të miturit shpesh përballen me rreziqe të mëdha ndaj sigurisë së tyre, duke përfshirë këtu edhe rrezikun ndaj rënies viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.⁹⁸ Edhe pse në Serbi, gjatë periudhës 2013-2019, janë parashtruar më shumë se 100 kallëzime nga viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, vetëm tetë u identifikuan si të tillë, ndërkohë që nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë ose moshës.⁹⁹

Të dhënat e përpiluara në Serbi nga Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit tregojnë se në vitin 2016 kishte pasur 40 viktima të supozuara, por vetëm dy viktima të trafikimit u identifikuan zyrtarisht. Të dyja ishin femra: një vajzë afgane e trafikuar për shfrytëzim pune dhe martesë fëmijësh dhe një grua nga Nepali, e trafikuar për shfrytëzim seksual. Në vitin 2017, u identifikuan 14 raste viktimash të supozuara të trafikimit në radhët e emigrantëve, nga të cilat vetëm një—djalë afgan që ishte viktimë e shfrytëzimit seksual—u identifikua zyrtarisht si rast trafikimi.¹⁰⁰ Janë edhe rastet e "Bacha bāzī"-ve, të ashtuquajtur "djemtë që kërcëjnë", të cilët janë kryesisht nga Afganistani, të cilët abuzohen nga emigrantë të tjerë në qendrat e pritjes gjatë udhëtimit në rrugën e Ballkanit.¹⁰¹

Edhe organizatat e shoqërisë civile kanë raportuar praktikën e seksit për mbijetesë, domethënë ofrimin të shërbimeve seksuale në këmbim të ushqimit, një vendi për të fjetur ose për nevoja të tjera bazike.¹⁰² Një përfaqësues i Qendrës për Mbrojtjen e Viktimave në Serbi e përshkroi kështu këtë dukuri në një intervistë: "Këta janë kryesisht fëmijë që përpiqen të ndihmojnë familjet e tyre ose që janë vetëm. Njëherë ishte një vajzë që ishte abuzuar seksualisht në Turqi, Greqi dhe Serbi. Trafikantët e prisnin në Turqi, ku ishte punësuar si dado, sipas marrëveshjes, por e kishin detyruar të punonte në seks".¹⁰³

Duke parë statistikat, mund të duket se këto janë raste të izoluara. Megjithatë, dyshohet se kjo dukuri, në një masë të madhe, nuk raportohet sa duhet, sidomos nëse marrim parasysh vështirësitë që lidhen me identifikimin e fëmijëve emigrantë. Për shkak të qëndrimit të shkurtër të emigrantëve në qendrat e pritjes dhe faktit që raportet nuk dorëzohen shpesh nga vetë viktimat nga frika se mos i riatdhesojnë dëshmitë vijnë nga bashkëmoshatarët, bashkudhëtarë ose emigrantët që luajnë rolin e "kujdestarit" në zonat e pritjes), është e vështirë të identifikohen dhe monitorohen prirjet/modelet e shfrytëzimit.

Profili i autorëve të krimit

Literatura botërore lidhur me SHSTF-në, më përpara, i kategorizonte autorët e krimit në dy grupe kryesore: trafikantët, qëllimi kryesor i të cilëve ishte të rekrutonin dhe të ushtronin kontroll mbi viktimat dhe t'i shfrytëzonin ato për përfitime monetare dhe blerësit e SHSTF-së.¹⁰⁴ Në mbarë botën, raportet lënë të kuptohet se shumica e trafikantëve janë burra.¹⁰⁵ Në disa raste, gratë që më përpara kishin qenë viktimat të trafikimit, u bënë vetë rekrutuese. Ato motivoheshin nga dëshira për të pushuar së qeni viktimë dhe për të përfituar mbrojtje ose favore nga autorët e krimit.¹⁰⁶ Trafikantët raportohet se bashkëdanin disa faktorë rreziqesh me viktimat e shfrytëzimit seksual tregtar, duke përfshirë faktin që kishin qenë viktimat të abuzimit seksual ose të abuzimit me drogën, dhunës në familje dhe rritjes në ambiente të disavantazuara shoqërore, arsimore dhe ekonomike.¹⁰⁷ Megjithatë, duke marrë parasysh mungesën e hulumtimeve shkencore dhe të dhënave gjyqësore në lidhje me këtë temë, të cilat do të shërbenin si bazë analizimi në Ballkanin Perëndimor, nuk ekziston asnjë profil i përbashkët i autorëve të krimit, të përfshirë në SHSTF në rajon.¹⁰⁸

Për sa u takon blerësve, hulumtimet shkencore theksojnë rëndësinë e vlerave dhe besimeve shoqërore dhe kulturore përkundër faktorëve individualë të izoluar.¹⁰⁹ Raportet kanë treguar se pjesa më e madhe e burrave që blejnë shërbime seksuale nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ata që nuk i blejnë këto shërbime.¹¹⁰ Disa blerës raportohet se nuk e dinin që ishin duke blerë shërbime ose materiale nga të mitur, ndërsa të tjerët e injoronin me vullnet të plotë një mundësi të tillë.¹¹¹ Edhe në vitin 2016, ECPAT-i paralajmëronte se SHSTF-ja (sidomos në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit) po bëhej e padukshme, duke kaluar te vendndodhjet e mbyllura si bordellot, klubet, hotelet dhe bujtinat e shtëpitë për mysafirë në zona urbane, rurale dhe bregdetare. Edhe pse disa autorë vazhdonin t'u qaseshin fëmijëve në rrugë, rekrutimi i fëmijëve në Evropë, për qëllime shfrytëzimi seksual në udhëtime dhe turizëm, po kalonte gjithmonë e më shumë në internet, i cili u mundëson autorëve të ulin shfaqjen e tyre dhe rrezikun e arrestimit.¹¹² Kjo është konfirmuar edhe nga shumë përfaqësues të shoqërisë civile dhe agjencive ligjzbatuese, të cilët kanë vënë në dukje sofistikimin e individëve dhe rrjeteve kriminale që përfshihen në organizimin e SHSF-UT-së.¹¹³

Sipas ECPAT-it, mërgimtarët dhe banorët me lejeqëndrim të zgjatur përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës së autorëve të krimeve të përfshirë në SHSF-UT në destinacionet evropiane. Globalizimi i tregut të punës dhe udhëtimi i shpeshtë ndërkuftar për punë dhe turizëm, tashmë përbëjnë burim të rëndësishëm kërkese që e nxit më tej SHSF-UT-në.¹¹⁴ Ndonëse në Ballkanin Perëndimor shpesh pranohet se SHSF-UT-ja ndodh vetëm në raste të izoluar dhe të dhënat rajonale vazhdojnë të jetë të kufizuara, është e rëndësishme të vihet në dukje se shumë të huaj, në fakt, janë arrestuar në rajon për krime të ndryshme të ndërlidhura me shfrytëzimin seksual të fëmijëve (p.sh. një qytetar britanik në Shqipëri në vitin 2008,¹¹⁵ një izraelit i arrestuar në Prishtinë në vitin 2019¹¹⁶ dhe një shqiptar i arrestuar në Maqedoninë e Veriut në vitet 2017-2018¹¹⁷).

Për sa i takon SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia, përfaqësuesit e OJQ-ve në Shqipëri deklarorin se autorët e krimit janë shpesh njerëz të cilët viktimat i njeh. Përfaqësuesit e OJQ-ve nga Bosnja besojnë se disa prej autorëve të krimit mund të kenë përvoja post-traumatike ose çrregullime të tjera, siç është kontrolli i sjelljeve impulsive. Në Maqedoninë e Veriut, autorët e raportuar të veprave penale zakonisht janë të rritur me moshë të mesme (midis 25 dhe 55 vjeç) që dinë ta përdorin

Në nivel global, shumica e trafikantëve janë burra. Në disa raste, gratë që më përpara kishin qenë viktimat të trafikimit, u bënë vetë rekrutuese.

teknologjinë digjitale dhe që kanë qasje në kompjuter. Edhe pse disa janë "të rinj të vetmuar", shpesh autorët e krimit janë njerëz që kanë familje dhe fëmijë.

Një dukuri tjetër interesante që raportohet nga zyrtarët e policisë shqiptare dhe psikologët ligjorë që ofrojnë këshillim për fëmijët në komisariate ishte "abuzimi i anasjellë ose i përmbysur". Fëmijët e shfrytëzuar, kryesisht vajza të reja, detyroheshin të ofronin favore seksuale në këmbim të parave dhe mallrave të tjerë. Vajzat pretendonin se ishin mbi 18 vjeçe. Nëse burrat që ato kontaktonin refuzonin të përfshiheshin më tej, ata shantazhoheshin me video dhe fotografi intime të veprimeve të tyre të paligjshme me të mitur. Në këtë mënyrë, shfrytëzuesit bëheshin viktima. Në Mal të Zi, autorët e huaja raportohet se i përgatisin fëmijët në internet me qëllim shfrytëzimin seksual dhe zhvatjen seksuale.

Ndikimi i pandemisë "Kovid-19"

Ndonëse është shumë herët për të vlerësuar ndikimin që ka pasur pandemia "Kovid-19" në SHSTF, ajo, pa dyshim, e ka rritur cenusshmërinë e fëmijëve ndaj shfrytëzimit seksual të mundësuar nga teknologjia. Mbyllja e shkollave i detyroi fëmijët të futeshin në sferën digjitale të papërgatitur, pa njohuritë e duhura rreth mënyrën se si funksionon sfera digjitale ose se çfarë rreziqesh paraqet ajo. Lojërat në internet dhe grupet e bisedave u bënë vendet kryesore të takimeve për ndërveprime midis fëmijëve, duke rritur në këtë mënyrë rrezikun e SHSTF-së. Në fakt, që prej fillimit të vitit 2020, ka pasur një rritje të shpejtë të digjitalizimit në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Ende nuk ka të dhëna të besueshme në nivel botëror (e lëre më në nivelin e Ballkanit Perëndimor) në lidhje me masën e fëmijëve të ndikuar nga rritja e përdorimit të internetit, duke marrë parasysh që hulumtimi është në kryerje e sipër. Megjithatë, EUROPOL-i¹¹⁸ dhe INTERPOL-i¹¹⁹ raportojnë se kufizimet e caktuara nga qeveritë kanë ndikuar te prirjet dhe kërcënimet e veprave penale të shfrytëzimit seksual tregtar në mbarë botën. Ata vunë re një rritje të madhe të kërkesës për trafikim fëmijësh për shfrytëzim seksual në internet dhe të shpërndarjes së materialeve të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet në shumë pjesë të Evropës, duke qenë se u rrit numri i grabitqarëve dhe autorëve të mundshëm që ishin izoluar në shtëpi.

Sipas raportit të EUROPOL-it, shumë tregues të MASF-së u bënë më të dukshëm, për shembull, rritja e numrit të përpjekjeve për t'u qasur tek uebsajtet e paligjshme dhe forumet që përmbajnë materiale të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, rritja e veprimtarisë në rrjetet me kompjuterë të barabartë (rrjete të tipit "P2P"), rritja e referimeve nga NCMEC-ja dhe rritja e numrit të kallëzimeve të bëra nga publike tek agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet e tjera.¹²⁰ Lojërat në internet, grupet e bisedave, përpjekjet për "peshkim" ("fishing") nëpërmjet e-maileve, kontakti përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve edukative u bënë vendet kryesore takimi për fëmijët dhe autorët e veprave penale seksuale. Edhe koha e përdorimit të internetit pa mbikëqyrje ka rritur rrezikun që të miturit të prodhojnë dhe shpërndajnë materiale të pahijshme të krijuara nga ata vetë. Në fakt, ekspertët nga EUROPOL-i parashikojnë se në vitin 2021 do të ketë një rritje të madhe të sasisë së materialeve të pahijshme të prodhuara vetë, gjë që mund të çojë në një rritje përpjesëtimore të përfitimit dhe shfrytëzimit në internet.¹²¹

Por pandemia "Kovid-19" ka pasur ndikim edhe në SHSTF-në "jashtë linje" dhe në parandalimin dhe ndjekjen penale të rasteve. Në fakt, ka të ngjarë që individët e cenushtëm, të cilët më përpara janë marginalizuar për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike ose statusit të emigrantit, tani po përjetojnë tjetërsim, pasiguri dhe diskriminim



edhe më të madh sesa përpara pandemisë. Krahas kësaj, shumë veta, që më përpara nuk ishin në grupin e njerëzve tepër të rrezikuar, tani janë më të rrezikuar ndaj SHSTF-së për shkak se kalojnë më shumë në internet, papunësia është rritur dhe shumë burime informale të ardhurash janë bërë të padisponueshme gjatë pandemisë "Kovid-19".¹²² Ndonëse numri i turistëve ndërkombëtarë ka rënë në mënyrë të konsiderueshme në verën dhe dimrin e vitit 2020, udhëtimi i brendshëm vazhdoi i pakontrolluar, sidomos gjatë verës.¹²³

Edhe identifikimi i viktimave është penguar për shkak të futjes në karantinë. Ndonëse strehimoret, zyrtarisht, kanë qëndruar të hapura, shumë viktime nuk kanë pasur mundësi t'i vizitojnë personalisht, por mund të kontaktonin me to vetëm përmes telefonit.¹²⁴ Ekspertët raportojnë se linjat e tyre të ndihmës "SOS" kanë marrë më shumë telefonata gjatë krizës "Kovid-19" sesa në vitet e mëparshme. Në Serbi, për shembull, numri i telefonatave kaloi pothuaj dyfishin e numrit të telefonatave që ishin bërë në vitin 2019.

Shumë qeveri kanë ndryshuar prioritetet e tyre gjatë vitit të fundit duke e larguar vëmendjen e tyre të kufizuar nga parandalimi dhe zbulimi i SHSTF-së dhe duke e përqendruar atë te reagimet, politikat dhe masat gjatë pandemisë. Në fakt, në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, qeveritë nuk morën asnjë masë specifike për të adresuar rritjen e cenueshmërisë së fëmijëve ndaj SHSTF-së për shkak të pandemisë "Kovid-19".¹²⁵ Ekziston nevoja urgjente që të gjitha palët e interesit të hartojnë veprime dhe plane parandaluese dhe të zbatojnë strategji dhe masa efektive për migrimin, sidomos përpara se të fillojë turizmi.

▲ Pandemia "Kovid-19" ka rritur kohën që fëmijët kalojnë në internet, gjë që i ekspozon ata më shumë ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual të ndihmuar nga teknologjia. © Bahrudin Bandić



SISTEMI I MBROJTJES SË FËMIJËVE DHE REAGIMET

Vendet e rajonit kanë krijuar sisteme të mbrojtjes së fëmijëve dhe kuadro ligjorë, por këto vuajnë nga mungesa e burimeve dhe moszbatimi sistematik. © Besart Cani

Pas ekzaminimit të situatës specifike sociale, ekonomike dhe politike të Ballkanit Perëndimor dhe të formave të ndryshme të SHSTF-së që janë të pranishme në rajon, është e rëndësishme të kuptohet se cilat reagime ekzistojnë tashmë në drejtim të ndihmesës me identifikimin e sfidave dhe hendeqeve në adresimin efikas të kësaj dukurie. Në pjesën e mëposhtme shqyrtohet infrastruktura e rajonit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve – sistemi kombëtar që siguron mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit ose shfrytëzimit dhe që zbatohet përmes një grupi ligjesh, politikash, rregulloresh dhe shërbimesh në të gjithë sektorët e shoqërisë. Duke qenë se koordinimi i përgjegjësive të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve shtrihet në të gjitha agjencitë qeveritare, p.sh. organet ligjzbatuese, organet e gjyqësorit dhe aktorët e mirëqenies sociale, dhe zbatohet nga ofruesit e shërbimeve, p.sh. autoritetet lokale dhe organizatat e specializuara të shoqërisë civile, në kapitullin e mëposhtëm do të përqendrohemi në mënyrë specifike tek aktivitetet dhe nismat e këtyre aktorëve.

Përmbledhje

- Vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës, kanë nënshkruar kuadro ligjorë të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe rajonalë, konventa dhe protokolle me të cilat adresohet SHSTF-ja.
- Në nivel kombëtar, elementet e abuzimit seksual të fëmijëve si vepër penale janë të shpërndarë kryesisht nëpër nenet e kodeve penale të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, por jo të gjitha vendet parashikojnë veprat penale të veçuara në lidhje me prostitucionin me fëmijë.
- Megjithëse kuadrot ligjorë kombëtarë të të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor përputhen me standardet ndërkombëtare, duket se nuk ka as një qasje koherente me shumë palë të interesuara dhe as burime të mjaftueshme në dispozicion për të parandaluar dhe ulur cenueshmërinë e fëmijëve ndaj shfrytëzimit seksual.
- Të gjitha vendet kanë mekanizma kombëtarë referimi për të lehtësuar raportimin dhe përpunimin e rasteve të dyshuara të trafikimit për shfrytëzim seksual dhe në punë.

- Zbatimi sistematik i përgjegjësive për mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha nivelet administrative, si dhe burimet e kufizuara financiare, njerëzore dhe teknike, vazhdojnë të jenë sfidë. Një tjetër sfidë është edhe mungesa e zbatimit të koordinuar të planeve të shënjestruara të veprimit midis grupeve të palëve të interesuara, duke përfshirë këtu bashkëndarjen dhe përditësimin e informacioneve.
- Agjencitë ligjzbatuese kanë shkallë të ndryshme ekspertize në lidhje me shfrytëzimin seksual të mundësuar nga teknologjia dhe SHSF-UT-në. Pavarësisht kësaj, në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor është vënë në pah ekzistenca e nevojës për ngritjen e shënjestruar të kapaciteteve të personelit gjyqësor dhe atij të zbatimit të ligjit.
- Një prej sfidave kryesore për OJQ-të e mbrojtjes së fëmijëve, të cilat merren me SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia, është mungesa e bashkëpunimit me policinë dhe bashkëndarja e kufizuar e të dhënave nga agjencitë ligjzbatuese.
- Ka mbrojtje dhe asistencë të kufizuar për fëmijët në lëvizje dhe fëmijët nga komunitetet që janë pakica etnike, sidomos në lidhje me ofrimin e akomodimit dhe riintegrimin për fëmijët romë.
- Në të gjitha vendet, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, kompanitë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) pretendojnë se kanë staf të dedikuar që trajton raportet për përmbajtje të pahijshme dhe joligjore.
- Industria lokale e udhëtimeve dhe turizmit nuk është e përgatitur mjaftueshëm për të identifikuar, raportuar dhe parandaluar SHSF-UT-në.

Kuadri ligjor

Ka disa kuadro ndërkombëtarë dhe kombëtarë, konventa dhe protokolle me të cilat trajtohet SHSTF-ja, duke përfshirë këtu edhe veprimtaritë kriminale të SHSTF-së të mundësuar nga teknologjia. Dokumentet më të rëndësishme për vendet e Ballkanit Perëndimor janë: konventa e OKB-së "Për të drejtat e fëmijës" (KDF);¹²⁶ Protokollin jo i detyrueshëm i OKB-së për konventën "Për të drejtat e fëmijëve në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë"; Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" (UNTOC) dhe protokollin "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve"; Konventa e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual" (Konventa e Lanzarotit);¹²⁷ Konventa e Këshillit të Evropës "Për krimin kibernetik" (Konventa e Budapestit);¹²⁸ Rezolutat 1099 (1996) dhe 1307 (2002) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës "Për shfrytëzimin seksual të fëmijëve"; dhe Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011, "Për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë".¹²⁹ Këto dokumente përfaqësojnë standardet ndërkombëtare dhe mbarë-evropiane në luftën kundër abuzimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve, me ndihmën e teknologjisë, dhe kanë pasur ndikim në legjislacionin përkatës kombëtar.

Në figurën 13 paraqitet statusi i ratifikimit dhe/ose ecuria e pajtueshmërisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor në lidhje me disa prej kuadrove ligjorë ndërkombëtarë dhe evropianë, konventave dhe protokolleve të përmendura më lart, me të cilat adresohet SHSTF-ja, duke përfshirë këtu edhe veprimtaritë kriminale të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia (për më shumë hollësi, shihni "Shtojcën II").

Detyrimet që rrjedhin nga akti specifik	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
KDF-ja e OKB-së	Ratifikuar më 27 shkurt 1992	Ratifikuar më 1 shtator 1993	–	Ratifikuar më 23 tetor 2006	Ratifikuar më 2 dhjetor 1993	Ratifikuar më 12 mars 2001
KDF-ja e OKB-së, P jo i det. për SHF-në	Ratifikuar më 5 shkurt 2008	Ratifikuar më 4 shtator 2002	–	Ratifikuar më 23 tetor 2006	Ratifikuar më 17 tetor 2003	Ratifikuar më 10 tetor 2002
UNTOC	Ratifikuar më 21 gusht 2002	Ratifikuar më 24 prill 2002	–	Ratifikuar më 23 tetor 2006	Ratifikuar më 12 janar 2005	Ratifikuar më 6 shtator 2001
Protokolli i Palermos	Ratifikuar më 21 gusht 2002	Ratifikuar më 24 prill 2002	–	Suksesion më 23 tetor 2006	Ratifikuar më 12 janar 2005	Ratifikuar më 6 shtator 2001
Këshilli i Evropës, "Lanzaroti"	Ratifikuar më 14 prill 2009	Ratifikuar më 14 nëntor 2021	–	Ratifikuar më 25 nëntor 2020	Ratifikuar më 11 qershor 2012	Ratifikuar më 29 korrik 2010
Këshilli i Evropës, "Budapesti"	Ratifikuar më 20 qershor 2002	Ratifikuar më 19 maj 2006	–	Ratifikuar më 3 mars 2010	Ratifikuar më 15 shtator 2004	Ratifikuar më 14 prill 2009
Direktiva 2011/92/BE130	–	–	–	–	–	–

FIGURA 13 Statusi i ratifikimit nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të kuadrove ligjorë kryesorë ndërkombëtarë dhe rajonalë, konventave dhe protokolleve me të cilat trajtohet SHSTF-ja.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës, kanë ratifikuar kuadro ligjorë të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe rajonalë, konventa dhe protokolle me të cilat adresohet SHSTF-ja. Në nivel kombëtar, pjesa më e madhe e elementeve që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare kundër abuzimit seksual të fëmijëve janë përfshirë jo vetëm në nenet e kodeve penale të të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe në ligjet për familjen dhe ligjet kundër krimit kibernetik. Edhe mbrojtja e fëmijëve, në bazë të parimeve ndërkombëtare me të cilat adresohen nevojat e pakicave etnike, garantohet me kushtetutat e shteteve.

Ndonëse kuadrot ligjore kombëtare duket se përputhen me standardet ndërkombëtare, nga analiza e thelluar del se të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, në kodet e tyre penale, nuk ofrojnë mbrojtje të njëtrajtshme për fëmijët. Për shembull, jo të gjitha vendet kanë vepra penale të veçuara që kanë të bëjnë me "prostitucionin me fëmijë". Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës, kanë dispozita të përshtatshme në kodet e tyre penale për "ndjelljen" ose krijimin e njohjes për qëllim shfrytëzimi (anglisht "grooming"), por në varësi të vendit ku ndodhin veprat penale, edhe ndëshkimi për të ndryshon mjaft. Gjithashtu, edhe detyrimet e ofruesve të shërbimit të internetit ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin: ata kanë detyrime në Serbi, Mal të Zi dhe Shqipëri, por jo në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë.

Terminologjia

Edhe pse termi "pornografi me fëmijë" vazhdon të përdoret gjerësisht si përkufizim ligjor në shumë vende, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende të Ballkanit Perëndimor, përdorimi i tij është, në një masë të madhe, hutues dhe i pasaktë. Termi "pornografi" përdoret për t'iu referuar materialeve si imazhe, video, libra dhe medime të tjera që kanë për qëllim shkaktrimin e eksitimit seksual.

Duke qenë se fëmijët nuk janë ende të pjekur nga aspekti mendor dhe fizik, ata nuk mund të jenë plotësisht të vetëdijshëm për veprimtaritë të cilat të tjerët i kanë detyruar të bëjnë. Prandaj, përfshirja e fëmijëve në këto materiale nuk duhet të përkufizohet si "pornografi", por si "abuzim ose shfrytëzim seksual i fëmijës". Përdorimi i pasaktë i terminologjisë mund të ulë peshën e natyrës shfrytëzuese të dukurisë dhe të lërë të nënkuptohet njëfarë shkalle legjitimiteti nga ana e autorit të veprës dhe njëfarë bindjeje nga ana e fëmijës viktimë.

Qasjet kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve

Mekanizmat kombëtarë të referimit (MKR) janë një përbërës vendimtar i sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve. Në Ballkanin Perëndimor, të gjitha vendet i kanë këto mekanizma për të lehtësuar raportimin dhe përpunimin e rasteve të dyshuara të trafikimit për shfrytëzim seksual dhe në punë dhe për identifikimin e trafikantëve të mundshëm.¹³¹ Për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë, kohët e fundit u krijua një rrjet zyrtarësh policorë dhe prokurorësh të specializuar, në kuadër të strategjisë kombëtare "Për shtypjen e trafikimit të qenieve njerëzore", të periudhës 2020-2023.

Ky rrjet pritet të sigurojë një qasje më aktive ndaj luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprave penale të ndërlidhura me të, si p.sh. shfrytëzimi i fëmijëve me ndihmën e teknologë, duke përfshirë përgjegjësitë për planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta, koordinimin, pjesëmarrjen në punën e strukturës së re koordinuese dhe mbështetjen e veprimtarive të grupit të punës (task forcës).




FIGURA 14 Ekipet e koordinimit në strukturën e mekanizmit kombëtar të referimit, të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, veprimtaritë për identifikimin e viktimave kanë rënë që prej vitit 2012, sikurse kanë rënë edhe hetimet, ndjekja penale dhe dënimi i autorëve të veprës penale të trafikimit. Një prej arsyeve është se, megjithëse ekzistojnë kuadrot e nevojshme ligjorë dhe institucionalë, mungon zbatimi në mbarë vendin. Këshilli i Ministrave miratoi "Planin e veprimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e dhunës kundër fëmijëve me anë të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në Bosnjë dhe Hercegovinë" (2014-2015), e hartuar për të nxitur zhvillimin e një mekanizmi efikas për mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe për parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet. Megjithatë, gjatë periudhës së parashikuar kohore, veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të planit të veprimit kanë qenë fare të pakta. Edhe pse "Strategjia e re për eliminimin e trafikimit të personave" (2020-2023) përfshin të gjitha detyrimet që janë pranuar me nënshkrimin e Protokollit të Palermos dhe Konventa e Këshillit të Evropës "Për masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore", zbatimi do të jetë pjesa vendimtare.

Në Maqedoninë e Veriut, në vitin 2008 u themelua një organ kombëtar koordinimi në funksion të zbatimit të planit të veprimit të vitit 2009-2012 "Për parandalimin dhe luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe të pedofilisë". Ky organ, me sa duket, nuk është funksional: nuk u gjetën të dhëna lidhur me veprimtaritë e tij, ndërkohë që gjendja e zbatimit të planit të veprimit nuk mund të vlerësohet. Pengesa kryesore vazhdojnë të jenë zbatimi i dobët i ligjit, mungesa e qasjes strategjike dhe sistematike dhe burimet dhe kapaciteti i kufizuar financiar, njerëzor dhe teknik. Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut ka krijuar një skemë raportimi të quajtur "Butoni i kuq"¹³² dhe një faqe interneti për të raportuar krimet që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të fëmijëve në internet dhe me gjuhën e urrejtjes.¹³³

Në Serbi, Departamenti për Shtypjen e Krimeve Kibernetike i Ministrisë së Brendshme, në bashkëpunim me Departamentin Special për Luftën kundër Krimeve Kibernetike të Prokurorisë Publike të Lartë të Beogradit, ka realizuar operacionin "Armagedon", një veprim policor i përhershëm, i cili nisi në vitin 2010. Qëllimi është luftimi i shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe të miturve në internet dhe i formave të tjera të dhunës digjitale kundër të miturve. Më tej, qeveria ka hartuar një strategji për luftën kundër krimit kibernetik për periudhën 2019-2023, e cila parashikon veprimtari dhe detyra të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve në Serbi nga trafikimi dhe shfrytëzimi për pornografi dhe prostitucion.¹³⁴

Në Mal të Zi, UNICEF-i mbështeti në vitin 2015 krijimin e një njësie për hetimin e krimeve kibernetike në kuadër të Drejtorisë së Policisë, duke ofruar trajnime për punonjësit dhe duke blerë softuerin për funksionimin e tij. Kjo njësi merret në mënyrë specifike me veprat penale që kanë të bëjnë me pornografinë me fëmijët dhe përndjekjen ("stalking").

Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar sisteme për mbrojtjen e fëmijëve dhe kuadro legjislativë. Megjithëkëtë, zbatimi sistematik në të gjitha nivelet administrative dhe burimet e kufizuara financiare, njerëzore dhe teknike, vazhdojnë të jenë sfidë. Krahas kësaj, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe organeve ligjzbatuese raportojnë se mungonte koordinimi i zbatimit të planeve të veprimit nga ana e grupeve të palëve të interesuara, duke përfshirë bashkëndarjen e informacioneve në kohën e duhur.

Zbatimi sistematik dhe burimet e kufizuara financiare, njerëzore dhe teknike, vazhdojnë të jenë sfidë në rajon.

Procedurat standarde të veprimit për hetimet rreth SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia

"Raporti i vlerësimit për sigurimin dhe përdorimin e regjistrave elektronike në procedurat kriminale në kuadër të legjislacionit vendas në Evropën Juglindore dhe Turqi"¹³⁵ i vitit 2018 tregon se nuk ka procedurë të unifikuar për shqyrtimin e provave digjitale në Ballkanin Perëndimor, edhe pse ekzistojnë shumë ngjashmëri në aspektin e gjuhës dhe ligjit, sidomos në vendet e ish-Jugosllavisë.

Për sa i takon materialit të abuzimit seksual të fëmijëve, shumë shpesh, të vetmet shenja që ekzistojnë për identifikimin e viktimës dhe kapjen e autorit të krimit janë pikërisht videot ose imazhet e ruajtura në pajisjet elektronike. Ekzaminimi i duhur i provave digjitale dhe pajisjeve është i nevojshëm për ruajtjen e provave për ndjekjen penale ose ngritjen e aktakuzave për krime. Krijimi i një protokollit për shqyrtimin e provave digjitale është çelësi i suksesit të një aktakuze, sikurse shpjegohet me hollësi në punimin "Shqyrtimi mjekoligjor i provave digjitale: Udhëzues për organet e zbatimit të ligjit",¹³⁶ të Departamentit Amerikan të Drejtësisë. Megjithatë, Kosova është e vetmja që ka protokolle të specializuara për

policinë në lidhje me trajtimin e provave digjitale në rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.

Në Shqipëri, ekziston një strukturë procedurale për hetimin dhe trajtimin e secilit rast të raportuar të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. Informacione përcillet zyrtarët e policisë te prokurorët dhe Njësia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike për hetime të mëtejshme. Nëse policia kërkon informacione më të hollësishme lidhur me adresat e IP-së ose lidhjeve të internetit, prokuroria e autorizon kërkesën ndërkohë që Njësia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike udhëheq procesin.

Shpesh është e vështirë të përcaktohet me saktësi adresa e IP-së e autorit të veprës, kredencialet e saj ose rrjeti i IP-së nga i cili është bërë lidhja. Në Shqipëri, shumë ofrues të shërbimit të internetit ofrojnë vetëm një GPON (rrjet optik pasiv gigabit) për zonë, çka e bën të vështirë gjurmimin e IP-ve specifike. Megjithëse ekzistojnë mjete që mund t'i ndihmojnë ofruesit e shërbimit të internetit që të gjurmojnë dhe lokalizojnë adresën e saktë, shumë prej këtyre mjeteve nuk ekzistojnë në Shqipëri dhe këto lloje hetimesh nuk ndiqen.




FIGURA 15 Struktura procedurale për hetimin e rasteve nga Policia e Shqipërisë.

Për sa i takon SHSF-UT-së, këtë dukuri nuk e trajton në mënyrë specifike asnjë plan veprimi për mbrojtjen e fëmijëve në rajon. Vetëm në strategjinë e Malit të Zi për periudhën 2019-2024 "Kundër trafikimit" pranohen sfidat për trafikimin e qenieve njerëzore, sfida këto që paraqiten nga resortet e mëdha turistike dhe prurjet prej një milionë turistësh në vit. Në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, SHSF-UT-ja nuk trajtohet në mënyrë specifike në strategjinë kundër trafikimit të qenieve njerëzore ose në planin kombëtar të veprimit. Në Shqipëri, ekspertët shpresojnë që kjo do të përfshihet në "Strategjinë e re për të drejtat e fëmijës" për periudhën 2021-2026 dhe si strategji e re për trajtimin e abuzimit të fëmijëve. Megjithëse Maqedonia e Veriut ka rënë dakord prej kohësh që të krijojë një plan veprimi të veçantë për luftimin e trafikimit të fëmijëve,

vendi nuk parashikon asnjë veprimtari specifike për adresimin e SHSF-UT-së.

Pjesa më e madhe e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor janë palë edhe në Organizatën Botërore të Turizmit të Kombeve të Bashkuara (UNWTO), e cila, në vitin 1999, miratoi "Kodin global për etikën në turizëm", një grup parimesh të hartuara për zhvillimin e turizmit nga qeveritë, industria e udhëtimeve, komunitetet dhe turistët.¹³⁷ Edhe pse nuk është i detyrueshëm nga pikëpamja ligjore, Kodi është mekanizëm i zbatimit vullnetar. Këtë kod e kanë pranuar 15 kompani që veprojnë në Ballkanin Perëndimor. Krahas kësaj, ministri i Tregtisë dhe Industrisë i Kosovës (e cila nuk është pjesë zyrtare e UNWTO-së) i ka pranuar parimet e këtij kodi.¹³⁸

Pjesa më e madhe e vendeve në rajon kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe me fqinjët në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore.¹³⁹ Krahas kësaj, në vitin 2007, në Shqipëri, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nënshkruan një marrëveshje me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, me synim mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në sektorin e turizmit. Megjithatë, shumë prej këtyre nismave nuk janë zbatuar ende në mënyrë të plotë.¹⁴⁰

Monitorimi sistematik i prirjeve të SHSTF-së në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor

OJQ-të nga të gjashtë vendet pohojnë se nuk ka të dhëna kombëtare rreth prevalencës së SHSTF-së. Megjithatë, provat anekdotike nga UNICEF-i në Serbi lënë të kuptohet se statistikat me burim të hapur kontributi ("open-source") në këtë fushë janë të disponueshme.¹⁴¹ Disa vendeve si Kosova nuk kanë as bazë të unifikuar të dhënash në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet dhe as mekanizma raportimi për krimet që ndërlidhen me abuzimin seksual të fëmijëve në internet. Në Mal të Zi, ekspertët janë të shqetësuar për mungesën e një bazë të unifikuar të të dhënave. Në përgjithësi, ekspertët e intervistuar janë dakord që mbledhja e të dhënave për SHSTF-në në Ballkanin Perëndimor është e pamjaftueshme.

Vendi	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Statistika kombëtare të besueshme	Po	Mungesë unifikimi, në nivele të ndryshme shtetërore	-	Jo	Jo	Po
Statistika me burim të hapur kontribuuesish	Po	Mungesë unifikimi, në nivele të ndryshme shtetërore	-	Jo	Jo	Po
Norma përkatëse e prevalencës/hulumtime të konsiderueshme	Jo	Jo	-	Jo	Jo	Po

FIGURA 16 Qasja sistematike në monitorimin e prirjeve të SHSTF-së në Ballkanin Perëndimor.

Ekspertët që punojnë me komunitetin romë kanë vënë në dukje mungesën e hetimeve parapr tëse dhe reaguese, sidomos kur është fjala për komunikimin me vendndodhje të largëta ku shpesh jetojnë komunitetet rome.

Pajisjet, ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet

Përfaqësuesit e organeve ligjzbatuese nga Shqipëria, Kosova, Bosnje dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut thanë se policia ka pajisjet dhe softuerët e nevojshëm për mbledhjen, konfiskimin dhe analizimin e provave digjitale të shfrytëzimit të fëmijëve në internet. Megjithatë, Shqipëria nuk ka pajisje për analizimin e telefonave celularë, ndërkohë që Mali i Zi nuk ka pajisje dhe softuerë për sekuestrimin dhe analizimin e provave të mbledhura nga kompjuterët personalë. Përfaqësuesit e intervistuar të Policisë nga Kosova, Bosnje dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut thanë se pajisjet dhe softuerët e tyre përditësoheshin dhe rinovoheshin në mënyrë periodike. Për sa i takon kapacitetit për ruajtjen e provave digjitale, vetëm policia e Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut u shpreh se kishin kapacitet të mjaftueshëm. Përfaqësuesit nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut përmendën se policia është e pajisur dhe trajnuar si duhet për rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. Megjithatë, përfaqësuesit nga Njësia për Krimet Kibernetike dhe Analizë Mjekoligjore e Maqedonisë vunë në dukje se ekziston nevoja për trajnime të tjera.

Pronësia e pajisjeve dhe softuerët e ndërlidhur	Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut
Kanë në pronësi pajisje dhe softuerët përkatës për analizimin e telefonave celularë	Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut
Kanë mirëmbajtje të pajisjeve dhe softuerëve	Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut
Ka protokolle të specializuara	Kosova
Kanë kapacitet të mjaftueshëm për ruajtjen e provave digjitale	Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut

FIGURA 17 Panoramë e përgjithshme e pajisjeve, softuerëve, protokolleve dhe kapacitetit të organeve ligjzbatuese për trajtimin e rasteve të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.

Për sa i takon numrit të personelit që merret me rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia, oficerët e policisë në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi deklarorin se është i pamjaftueshëm numri i oficerëve të policisë që merren me këto lloje rastesh.

Vendi	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Ka numër të mjaftueshëm të personelit që merret me rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia	Jo	Pjesërisht (jo në Federatë ose Rrethin e Bërçkos, "po" në Republikën Serbe)	Ka informacione kundërthënëse	Jo	Jo	Po
Ka personel ose departament të specializuar për trajtimin e rasteve të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia	Jo	Pjesërisht ("jo" në Federatë dhe në Rrethin e Bërçkos, "po" në Republikën Serbe)	Po	Jo	Jo	Jo
I ofron trajnime dhe aftësim personelit që merret me rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia	Jo	Po	Po	Po	Jo	Pjesërisht (nga INTERPOL-i)
Ka polici me kapacitet të mjaftueshëm	Jo	Jo	Po	Jo	Po	Jo
Ka gjyqësor me kapacitet të mjaftueshëm	Jo		Po	Jo	Po	Jo

FIGURA 18 Panoramë e kapacitetit dhe trajnimeve të zyrtarëve të zbatimit të ligjit.

Kosova dhe disa institucione në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë departamente dhe personel të specializuar që merret me rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. Kosova dhe Mali i Zi angazhojnë ekspertë të specializuar të emëruar nga gjykatat në rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia, ndërsa vendet e tjera nuk angazhojnë ekspertë të tillë. Drejtori i Njësisë për Hetime të Krimeve Kibernetike në Kosovë argumentoi se njësi ka kompetencë dhe kapacitete të mjaftueshme për t'u marrë me këto krime. Në të njëjtën kohë, intervistat tregojnë se mungesa e ekspertizës në trajtimin e këtij lloji krimi brenda agjencive rajonale ligjzbatuese është e dukshme. Pavarësisht kësaj, të gjithë përfaqësuesit e organeve ligjzbatuese, me përjashtim të atyre nga Shqipëria, pohuan se personelit që punon me rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia i është ofruar trajnim dhe aftësim. Vetëm të intervistuarit nga Shqipëria dhe Kosova përmendën ekzistencën e protokolleve të specializuara që duhet të ndiqen për trajtimin e rasteve të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.

Kapaciteti gjyqësor duket se është problematik: vetëm përfaqësuesit e organeve ligjzbatuese nga Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut deklaruan se ky kapacitet është i mjaftueshëm për trajtimin e rasteve të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. Ekspertët nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut vunë në dukje se në vendet e tyre nuk ka prokurorë ose gjyqtarë të specializuar në trajtimin e këtyre rasteve. Megjithatë, ekspertët e shoqërisë civile në Mal të Zi vunë në pikëpyetje mjaftueshmërinë e kapaciteteve për personelin gjyqësor në trajtimin e shfrytëzimit që mundësohet nga teknologjia, duke qenë se, me sa dinë prokurorët, nuk ka pasur krime të trafikimit të fëmijëve përmes përdorimit të internetit. Në Serbi, megjithëse kapaciteti gjyqësor nuk konsiderohet i mjaftueshëm, ekziston një atmosferë nxitëse dhe vullnet i mirë për ta ngritur këtë kapacitet.

Në Shqipëri, edhe pse ekziston një njësi për hetimin e krimeve kibernetike në Drejtorinë e Policisë në Tiranë, personeli nuk është trajnuar si duhet dhe nuk ka mjetet dhe teknologjitë mjekoligjore për t'i hetuar këto vepra penale. Njësia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike ka realizuar shumë programe për ngritje kapacitetesh, pjesa më e madhe e të cilëve janë mbështetur nga donatorë, në drejtim të hetimit të rasteve të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet dhe abuzimit të tyre, por nuk ka sistem të brendshëm për transferimin e aftësive të specializuara në këtë sferë. Edhe prokurorët thonë se ekziston nevoja për trajnime për aftësi që kanë të bëjnë me teknologjinë e informacionit dhe për teknika hetimore dhe ndjekjeje penale për sa u takon rasteve të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet dhe abuzimit të tyre. As policia dhe as prokuroria nuk janë të pajisura si duhet me infrastrukturë të përshtatshme për t'i hetuar në mënyrë efektive këto raste. Njësia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike nuk është në gjendje të kryejë mbikëqyrje uebsajtesh, gjë që pengon aftësinë e tyre për të nisur hetime sipas detyrës zyrtare dhe në mënyrë proaktive. Policia nuk ndërmerr operacione të fshehta sepse druhet se mos ato do të konsiderohen si dhënie në kurth. Kjo pengesë duhet të zgjidhet nëpërmjet trajnimeve të përshtatshme, procedurave standarde dhe mjeteve teknike. Mungesa e reagimit të shpejtë të ofruesve të shërbimit të internetit ndaj kërkesave të prokurorisë dhe vështirësitë në identifikimin e adresave të IP-së të autorëve të dyshuar, ndikojnë në cilësinë e hetimeve dhe, për rrjedhojë, edhe në mundësinë për t'u kërkuar llogari autorëve të krimeve. Deri më tani, nuk është ofruar asnjë shërbim ose mbështetje psikologjike ose psikosociale. Këto janë të rëndësishme për të ndihmuar profesionistët që merren me këtë problematikë që të përballojnë stresin mendor dhe rraskapitjen fizike të cilat ndërlidhen me natyrën e tmerrshme të këtyre krimeve.

Kur është fjala për SHSF-UT-në, vetëdijesimi në radhët e zyrtarëve të organeve ligjzbatuese në mbarë Ballkanin Perëndimor, për sa i përket prevalencës dhe prirjeve aktuale, është i ulët, ndërkohë që personelit nuk i ofrohen trajnime të rregullta ose specifike.¹⁴² Megjithatë, organet ligjzbatuese të Maqedonisë së Veriut ofrojnë një kalendar vjetor trajnimesh, ndërkohë që organet ligjzbatuese në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Mal të Zi marrin trajnime specifike për projektet që kanë të bëjnë me SHSF-UT-në dhe këto trajnime ofrohen nga OJQ-të ndërkombëtare. Në Kosovë, zyrtarët e intervistuar të organeve ligjzbatuese theksuan se bëjnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve në fushën e abuzimit të fëmijëve, me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve.¹⁴³ Megjithatë, shumë të intervistuar përmendën faktin se udhëzuesit dhe ligjet shpesh janë të paqarta dhe nuk zbatohen. Krahas kësaj, zyrtarët kanë pak ekspertizë për sa i takon njohjes së modeleve sjellore të abuzuesve ose fëmijëve të pashoqëruar nga kujdestarët e tyre ligjorë.¹⁴⁴

As policia dhe as prokuroria nuk janë të pajisura si duhet me infrastrukturë të përshtatshme për t'i hetuar në mënyrë efektive rastet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve.

Bashkëpunimi ndërsektoral midis palëve të interesuara të mbrojtjes së fëmijëve

Kuadrot rregullatore dhe politikat e shënjestruara shpesh mbeten prapa risive teknologjive. Politikëbërësit duhet të sigurojnë një përpunim më proaktiv të trafikimit të fëmijëve dhe të veprave penale të ndërlidhura me të, ku përfshihet saktësimi i përgjegjësive lidhur me planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta dhe koordinimin. Për t'i mbyllur këto hendeqe, grupe të ndryshme palësh të interesuara, ku përfshihen organet ligjzbatuese, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të bëhen bashkë për të zhvilluar risi teknologjike kundër formave të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore.

Përfaqësuesit e organeve ligjzbatuese nga Mali i Zi, të intervistuar për këtë raport, thanë se për shkak të mungesës së OJQ-ve që përqendrohen te shfrytëzimi i fëmijëve me ndihmën e teknologjisë, nuk ka bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe organeve ligjzbatuese për sa i takon kësaj sfere. Përkundër kësaj situatë, policia e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjës dhe Hercegovinës konfirmoi se ekziston tashmë bashkëpunimi me OJQ-të. Një shembull pozitiv i bashkëpunimit të mirë midis institucioneve qeveritare në luftën kundër SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia është nënshkrimi i "Protokolleve të bashkëpunimit" midis Qendrës për Internet më të Sigurt në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Drejtorisë së Policisë Federale, Ministrisë së Brendshme të Republikës Serbe dhe Policisë së Rrethit të Bërçkos.¹⁴⁵ Këto protokolle rregullojnë përgjegjësitë e përbashkëta dhe procedurat midis Qendrës dhe të tri agjencive policore në Bosnjë dhe Hercegovinë në funksion të marrjes së kallëzimeve për MASF-në, shkëmbimit të informacioneve, vlerësimit të lëndës dhe dorëzimit të rasteve të kallëzuara te sistemet e zbatimit të ligjit. Qëllimi i protokolleve është të çojnë më tej kujdesin social ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të sigurojnë ndihmën e nevojshme kur fëmija ekspozohet ndaj formave të ndryshme të dhunës ose abuzimit, duke garantuar reagim të përshtatshëm dhe të shpejtë të institucioneve dhe shërbimeve kompetente. Këto protokolle parashikojnë edhe bashkëpunimin midis Qendrës dhe agjencive policore në lidhje me realizimin e veprimtarive për ngritjen e kapaciteteve për grupe të ndryshme të synuara (fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët, etj.) dhe të veprimtarive të tjera arsimore dhe promovionale të Qendrës në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Vendi	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Bashkëpunim me OJQ-të	Po	Po, linjë e drejtpërdrejtë telefonike/linjë ndihme	Po, linjë e drejtpërdrejtë telefonike/linjë ndihme	Jo	Po	Po
Bashkëpunim me EUROPOL-in/INTERPOL-in	-	Po, bazik	Po, bazik	Po	Po	Po
Bashkëpunim me sektorin e TIK-ut	Po	Jo	Po	Po	Po	Po
Bashkëpunim pozitiv midis personelit ligjor e prokurorëve dhe policisë	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Po
Bashkëpunim me vendet fqinje dhe organizatat ndërkombëtare	Po	-	Po	Po	Po	Po

FIGURA 19 Panorama e përgjithshme e bashkëpunimit me OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe kompanitë e sektorit privat dhe midis autoriteteve.

Për sa i takon bashkëpunimit me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë vetëm një bashkëpunim bazë, ndërkohë që Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut kanë bashkëpunim të plotë me të dy këto organe. Edhe policia serbe bashkëpunon me INTERPOL-in, ndërkohë që prokurorët punojnë së bashku me EuroJust-in. Krahas kësaj, të gjitha vendet, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, bashkëpunojnë me kompanitë e TIK-ut. Në Shqipëri dhe Mal të Zi, ky bashkëpunim midis sektorit të TIK-ut dhe institucioneve të tjera, si EUROPOL-i, INTERPOL-i dhe organizatat e shoqërisë civile, rregullohet me ligj. Bashkëbiseduesit e tjerë, që punojnë në industrinë e hotelerisë dhe turizmit, shtuan se nuk marrin asnjë informacion nga policia, në lidhje me prirjet ose modelet, gjë që do të lehtësonte identifikimin e rasteve të mundshme të SHSF-UT-së.¹⁴⁶

Prokurorët nga Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut e vlerësuan bashkëpunimin me organet ligjzbatuese me nota pozitive. Të intervistuarit nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor e konsideronin bashkëpunimin me policinë si një prej problemeve kyçe kur ishte fjala për trajtimin e rasteve të SHSTF-së të mundësuar nga teknologjia.

Megjithëse shumica e përfaqësuesve të organeve të zbatimit të ligjit pohonin se bashkëpunimi me shoqërinë civile po ecën mirë, përfaqësuesit e OJQ-ve theksonin se edhe pse kishin kallëzuar raste të mundshme të SHSF-UT-së, policia nuk i kishte përpunuar si duhet informacionet. Sipas një të intervistuarit në Malin e Zi, pavarësisht faktit që OJQ-të kanë dhënë informata lidhur me grupet kriminale të përfshira, "policia nuk nisi asnjë procedurë".¹⁴⁷ Sipas ekspertëve për komunitetet rome, bashkëpunimi midis institucioneve veç e veç, në nivel kombëtar, është shumë i kufizuar. Pjesa më e madhe e rasteve nuk raportohen për shkak të kontrollit të dobët në vende si Kosova ose Maqedonia e Veriut. Në disa raste, autorët e krimit punojnë në rrjete të mirëstrukturuara ku përfshihet edhe korruptimi i policisë, me qëllim që "fëmijët thjesht të transferohen përtej kufirit të Malit të Zi pa pasaportë, certifikatë lindjeje, kartelë mjekësore ose me dokumente të falsifikuara që askush nuk i kontrollon".¹⁴⁸

Në Shqipëri, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve përballen me sfida të shkaktuara nga mungesa e njohurive rreth sigurisë në internet për fëmijët dhe nga mungesa e financimeve bazë për menaxhimin e rasteve.

Numri i kufizuar i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe shpërndarja e tyre jo e njëtrajtshme në mbarë vendin, ua bëjnë atyre punën edhe më të vështirë. Rritja e efikasitetit të hetimeve në lidhje me krimet kibernetike dhe lufta ndaj këtyre krimeve është pjesë e objektivave strategjike edhe të policisë së shtetit edhe të prokurorisë. Policia ka krijuar dhe ka vënë në funksionim një njësi për hetimin e krimeve kompjuterike, e cila është e specializuar në hetimin e rasteve të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit të fëmijëve në internet. Megjithatë, nuk ka koordinim të mjaftueshëm midis kësaj njësie dhe pjesëve të tjera të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, gjë që mund t'i pengojë viktimat që të marrin shërbime të tjera që ato kanë të drejtë të përfitojnë. Njësia nuk ka procedura për të siguruar përfshirjen e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve në procesin e hetimeve.

Në Mal të Zi, gjatë sezonit turistik, policia zakonisht realizon bastisje në bare, klube nate, vende ku tregtohet seksi, agjencitë e eskortave dhe bizneset që dyshohet se ndjekin praktika punësimi të paligjshme. Pavarësisht kësaj, policia nuk u jep informacione lidhur me rezultatet e këtyre operacioneve organeve të tjera kombëtare të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.¹⁴⁹

Me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, të gjitha vendet konfirmuan bashkëpunimin e tyre me vendet fqinje dhe me organizatat ndërkombëtare, për të cilat u shprehën me nota pozitive.

Numri i kufizuar i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe shpërndarja e tyre jo e njëtrajtshme në mbarë vendin, ua bëjnë atyre punën edhe më të vështirë.

Reagimet për ndihmë ndaj viktimave, për fëmijët nga komunitetet rome dhe fëmijët në lëvizje

Të gjitha palët e interesuara duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje ndihmesës ndaj fëmijëve të komuniteteve rome dhe të fëmijëve në lëvizje. Për sa u takon fëmijëve viktimë romë, ekspertët kanë shpjeguar se edhe në rastet kur fëmijët romë janë identifikuar me sukses dhe janë shpëtuar prej trafikantëve të tyre, atyre rrallë herë u jepet strehim i përshtatshëm ose ndihmë e përshtatshme psikologjike. Rehabilitimi dhe, prej këtej, (ri)integrimi në shoqëri është gjë e rrallë. Edhe kur fëmijët romë kalojnë ca kohë në strukturat mbrojtëse, ata shpesh dërgohen te familjet e tyre dhe tek i njëjti mjedis që i vuri në rrezik shfrytëzimi që në krye të herës.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe ekspozimi ndaj trafikimit të qenieve njerëzore të të miturve të pashoqëruar janë shqetësime kryesore për shumë prej organizatave humanitare që punojnë në rajon. Këto organizata, së bashku me autoritetet kombëtare, kanë punuar shumë për të rritur vetëdijen lidhur me cenueshmërinë e të miturve që udhëtojnë në rajon. Megjithatë, të shumtë janë ata që i pranojnë kufizimet e mbështetjes që mund të japin. Një i intervistuar që punon në një qendër pritjeje në Mal të Zi vuri në dukje: "Ata [emigrantët] kishin një qëllim: të kalonin përmes vendit sa më shpejt që të mundnin. Kohëzgjatja e qëndrimit të tyre këtu ishte tepër e shkurtër për të identifikuar dinamikën e shfrytëzimit të mundshëm. Dhe gjërat bëhen edhe më keq, sepse ne nuk jemi në gjendje të zbatojmë të gjitha strategjitë standarde që janë efektive për periudhat më të gjata."¹⁵⁰ Megjithatë, pavarësisht kufizimeve kohore, ka disa shenja alarmi që mund të vihen re, për shembull, kur një prind i vetëm udhëton me shumë fëmijë që ka në ngarkim.

Institucionet publike, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile duhet të punojnë për të krijuar një qasje më efektive parandaluese për të shpejtuar procesin e identifikimit të të miturve në rrezik dhe pajisjes së këtyre fëmijëve me akomodim të përshtatshëm në qendra *ad hoc*, të veçuara nga ato për të rriturit. Në qendrat e pritjes ekziston nevoja edhe për personel shtesë në funksion të ofrimit të mbështetjes së vazhdueshme administrative dhe psikologjike.

Meqanizmat e mbështetjes të shoqërisë civile

Shumë OJQ në mbarë rajonin punojnë si ofrues të shërbimeve për fëmijët viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të shfrytëzimit seksual. Pavarësisht kësaj, kapacitetet e OJQ-ve që merren me këtë dukuri vazhdojnë të mbeten të ulëta, gjë që nënkupton se ato nuk janë në gjendje të ofrojnë strehimore të veçuara për fëmijët dhe të rriturit viktimë të shfrytëzimit seksual. Strehimoret ekzistuese shpesh mbushen përtej kapacitetit të tyre dhe personeli ka pak përvojë në lidhje me mënyrën e identifikimit dhe trajtimit të viktimave të mundshme.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, krijimi i Qendrës për Internet të Sigurt u përfundua vetëm në vitin 2018 nga OJQ-ja "IFS-EMMAUS", me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Ka pasur mungesë të përgjithshme mbështetjeje financiare nga qeveria për të luftuar veprimtaritë e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia në këtë shtet. Kjo është shqetësuese sepse është e qartë se ekziston nevoja për trajtimin e këtyre çështjeve. Linja "Fëmijë i Sigurt" për raportim të drejtpërdrejtë, e krijuar në vitin 2010, ka marrë gjithsej 1 140 raporte të përmbajtjeve të pahijshme gjatë periudhës 2010-2020, duke përfshirë këtu 137 për MASF-në; 127 për bullizmin kibernetik, zhvatjen seksuale, sekstingun dhe veprat penale të lidhura me to; dhe 871 kërkesa nga fëmijët, prindërit e shqetësuar dhe publiku i përgjithshëm në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me rreziqet dhe sigurinë në internet (të regjistruara si raporte të paplota në pajtim me procedurat e rrjetit "INHOPE", meqenëse nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me veprat penale që kanë të bëjnë me MASF-në).¹⁵¹

Përfaqësuesi i një organizata qeveritare nga Mali i Zi tha se raportohet që nuk ka personel të mjaftueshëm në qendrat për punë sociale, ku pesë ose gjashtë kolegë janë përgjegjës për trajtimin e rreth 100 rasteve aktive në çdo moment të dhënë. Strehimorja e parë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në vend u themelua në vitin 2004 dhe u ka ofruar viktimave strehim dhe ndihmë ligjore, psikosociale dhe mjekësore. Strehimorja drejtohej nga aktiviste me përvojë nga OJQ-ja malazeze "Women's Lobby" dhe që prej vitit 2006, puna e saj është financuar plotësisht nga qeveria nëpërmjet Zyrës për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Më pas, kjo strehimore u vu në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila i transferon viktimat në mënyrë ekskluzive te ofrues të licencuar të shërbimeve. Për shkak të procedurës kërkuese dhe të shtrenjtë të licencimit për ofrimin e shërbimeve, kjo strehimore u detyrua të mbyllej në vitin 2019 dhe t'i transferonte klientët e saj te katër strehimore të tjera të licencuara. Një tjetër strehimore që mbështet në mënyrë ekskluzive viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore u themelua nga Instituti për Politika Sociale dhe Arsimore (ISOP) në dhjetor të vitit 2019. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Malit të Zi e përzgjedhi ISOP-in si partnerin e ri nga shoqëria civile në përpjekjet e saj për parandalimin e trafikimit. Megjithatë, "Raporti i vitit 2020 për trafikimin e personave" i Departamentit Amerikan të Shtetit, kritikoi faktin që qeveria nuk i përfshinte në mënyrë zyrtare organizatat e shoqërisë civile në procedurat për identifikimin e viktimave. Më tej, në raport theksohej në mënyrë të veçantë mbyllja e së vetmes strehimore të drejtuar nga një OJQ dhe shpreheshin shqetësime lidhur me cilësinë e ndihmës që ofrohet në qendrën e re për viktimat e trafikimit.

Në Maqedoninë e Veriut, në vitin 2018, u krijuan ekipe lëvizëse nga institucionet dhe OJQ-të. Këto ekipe komunikuan me 390 njerëz, ndihmuan nëntë të mbijetuar të trafikimit dhe identifikuan 104 viktima të mundshme të trafikimit. Fëmijët viktima raportohet se shpesh sistemoheshin bashkë me të rriturit në qendrat e përgjithshme të pritjes, të cilat shpesh janë të mbipopulluara, pa pajisjet e duhura dhe nuk kanë shërbime të posaçme për fëmijët. Në këto aranzhime, fëmijët ekspozohen ndaj rreziqeve kritike të sigurisë dhe mirëqenies fizike dhe psikologjike dhe ekspozohen gjithmonë e më shumë ndaj abuzimit seksual dhe dhunës me bazë gjinore.¹⁵²

▼ Bashkëbisedim në grup i një OJQ-je boshnjake që ofron asistencë për fëmijët që kanë vuajtur nga ndonjë formë dhune. © Bahrudin Bandić



Në Serbi, portali "Better Internet for Kids" (Internet më i mirë për fëmijët) ofron informacione, udhëzime dhe burime lidhur me temat e sigurisë në internet nga rrjeti i bashkuar "Insafe-INHOPE" i Qendrave për Internet të Sigurt në Evropë dhe i palëve të tjera të interesuara. Në shkurt të vitit 2017, u krijua një qendër kombëtare kontakti për sigurinë e fëmijëve në internet.¹⁵³ Përmes kësaj qendre, Ministria e Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikacionit realizon këshillime për fëmijët, prindërit, nxënësit dhe mësuesit dhe për të gjithë qytetarët e tjerë, në lidhje me përfitimet dhe rreziqet e përdorimit të internetit dhe mënyrat e sigurta të përdorimit të teknologjive të reja nëpërmjet veprimtarive të ndryshme që kanë për qëllim rritjen e vetëdijesimit.

Në nivelin rajonal, në vitin 2013 u krijua rrjeti "IRIS", i cili përbëhet nga mbi 200 ofrues shërbimesh sociale dhe organizata nga të shtatë vendet e rajonit (gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor plus Kroacia), të cilat u ofrojnë mbështetje fëmijëve, të rinjve, të moshuarve, viktimave të dhunës, njerëzve me aftësi të kufizuara dhe emigrantëve. Rrjeti "IRIS" ka për qëllim fuqizimin e rolit të ofruesve jofitimprurës të shërbimeve sociale në Evropën Juglindore dhe sigurimin që këto organizata të pranohen si partnerë të barabartë në sektorin publik.

Konventa e Lanzarotit, sidomos nenet 11 deri në 13, përshkruan me hollësi se cilët janë mekanizmat që nevojiten për mbështetjen efektive të fëmijëve nën moshën ligjore.¹⁵⁴ Në nenin 12 sugjerohet zhvillimi i linjave telefonike për raportimin e materialeve të paligjshme, ndërsa në nenin 13 rekomandohet krijimi i linjave telefonike anonime (përmes internetit ose telefonit) për fëmijët dhe prindërit ose kujdestarët e tyre, duke u mundësuar përdoruesve të telefonojnë në mënyrë anonime dhe të kërkojnë këshillim. Në këtë kuptim, të gjitha vendet kanë një mekanizëm zyrtar të linjave telefonike të drejtpërdrejta, me përjashtim të Kosovës, e cila nuk dha informacione në lidhje me këtë aspekt. Serbia dhe Shqipëria kanë mekanizma të komunikimit të drejtpërdrejtë jashtë rrjetit "INHOPE",¹⁵⁵ ndërkohë që Bosnja dhe Hercegovina kanë një brenda këtij rrjeti. Sipas të dhënave zyrtare, as Mali i Zi dhe as Maqedonia e Veriut nuk kanë asnjë lloj mekanizmi linje të drejtpërdrejtë për raportimin e lëndëve të paligjshme ose të papërshtatshme.

Vendi	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Linjë e drejtpërdrejtë në kuadër të anëtarësisë në "INHOPE" ¹⁵⁶	Jo	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Linjë e drejtpërdrejtë telefonike jashtë rrjetit "INHOPE"	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Po ¹⁵⁷
Linjë e drejtpërdrejtë telefonike në kuadër të anëtarësisë në rrjetin "Child Helpline International" ¹⁵⁸	Po	Po	Jo	Po	Po	Po

FIGURA 20 Panoramë e përgjithshme e gjendjes së linjave të drejtpërdrejta telefonike dhe linjave të ndihmës në vendet e përfaqësuesve të pyetur.

Për sa i takon SHSF-UT-së, ka nisma pozitive individuale nga shoqëria civile për ta luftuar këtë dukuri, siç është "Platforma ndërkombëtare kundër turizmit të seksit me fëmijë",¹⁵⁹ e cila u mundëson individëve të raportojë rastet e dyshimta të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, madje edhe nga jashtë vendit, duke përdorur lidhjet

me mekanizmat kombëtare të raportimit përmes internetit. Në vendet ku nuk ka mekanizma kombëtare raportimi, kjo faqe interneti ofron informacione alternative në lidhje me mënyrën se si bëhen raportimet. Gjithashtu, faqja e internetit ofron informacione lidhur me shfrytëzimin seksual të fëmijëve në kuadrin e udhëtimeve dhe turizmit. Pesë organizata me seli në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë anëtare të kësaj platforme.¹⁶⁰

OJQ-të janë edhe në ballë të rritjes së vetëdijesimit për SHSF-UT-në në mbarë Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe shkollat ku SHSF-UT-ja nuk është ende pjesë e kurrikulës arsimore. Ndryshe nga nismat globale si "Shiva Foundation",¹⁶¹ aktualisht nuk dihet se ka nisma që mbledhin tok OJQ-të me kompanitë private për ta trajtuar problemin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit në Kosovë.¹⁶²

Sektori privat

Sektori privat është palë jetike e interesit në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, si aktor në mundësimin e aspekteve të ndryshme të shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe luftës kundër këtyre aspekteve. Duke vepruar në pajtim me rregulloret e industrisë, praktikat më të mira botërore dhe standardet e vetimponuara të shqyrtimit të klientëve, kompanitë e sektorit privat mund të luajnë një rol kyç në uljen e rrezikut të SHSTF-së. Në këtë kapitull shqyrtojmë në mënyrë specifike rolin e TIK-ut dhe të industrisë së teknologjisë dhe të industrisë së hotelarisë në drejtim të luftimit të SHSTF-së dhe tregojmë se sektori privat shpesh është i pari që vëren prirjet e reja dhe, për rrjedhojë, mund t'u ofrojë institucioneve qeveritare informata të rëndësishme.

TIK-u dhe industria e teknologjisë

Adresimi i SHSTF-së —dhe teknologjive që keqpërdoren për ta mundësuar atë—bën të nevojshëm koordinimin e përpjekjeve të palëve përkatëse të interesuara: politikëbërësve që miratojnë rregulloret e mbrojtjes, zyrtarëve të organeve ligjzbatuese që mbikëqyrin zbatimin e tyre, sektorit privat që punon për luftimin dhe parandalimin e keqpërdorimit të teknologjive dhe platformave të tyre digjitale dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat veprojnë si monitoruese dhe ndihmojnë në rritjen e vetëdijesimit të publikut të gjerë. Në kuadër të komunitetit të bizneseve, TIK-u dhe sektori i teknologjisë zënë një vend unik në lidhje me ofrimin e zgjidhjeve inovatore për komunitetet e cenueshme, të mbijetuarit, aktorët kundër trafikimit dhe politikëbërësit, por mund ta ndihmojnë komunitetin e biznesit që të përfitojë nga mjetet ekzistuese për të adresuar trafikimin e qenieve njerëzore.

Në Maqedoninë e Veriut, edhe pse dokumentet strategjike si "Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike dhe Plani i Veprimit 2018-2022" u miratuan në vitin 2018, sektori i teknologjisë ka luajtur vetëm një rol të vogël në procesin e konsultimeve dhe zbatimit. Dhoma e Tregtisë për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (MASIT) nuk e adreson çështjen e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe as nuk përfshihet në mekanizmat për heqjen ose raportimin e përmbajtjeve.¹⁶³ Telekomit në Maqedoni ka deklaruar se kompania ndjek standardet aktuale të kompanisë "Deutsche Telecom",¹⁶⁴ gjë që nënkupton se nuk ka monitorim proaktiv, heqje ose raportim të përmbajtjeve në internet. Për OSHI-të nuk ka procedura detyruese për heqjen e përmbajtjeve nga interneti. OSHI-të mund të veprojnë vetëm pas kërkesës së prokurorëve publike dhe i dërgojnë të dhëna Sektorit për Krimet Kibernetike dhe Analizën Mjekoligjore, të Ministrisë së Brendshme, për përpunim të mëtejshëm.

Kompanitë e sektorit privat luajnë një rol kyç në uljen e rrezikut të SHSTF-së.

Në Serbi, pjesa më e madhe e OSHI-ve dhe të gjitha kompanitë celulare kanë udhëzime të hollësishme parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve në faqet e tyre të internetit. Gjithashtu, ato u ofrojnë prindërve mundësinë teknike që të kontrollojnë se çfarë materiale mund të shohë fëmija në internet. Megjithatë, ka mungesë informacionesh transparente dhe udhëzimesh në lidhje me procedurat e nevojshme atëherë kur ndodhin raste abuzimi. Kompanitë raportohet se janë të detyruara të jenë të ekuilibruara midis mbrojtjes së privatësisë së klientëve të tyre dhe detyrimit për të raportuar rastet e abuzimit.

Në figurat 21 dhe 22 jepen rezultatet e intervistave me kompanitë e TIK-ut.

Bëjnë analiza të raporteve të përmbajtjeve të pahijshme dhe të paligjshme	Shqipëria, Serbia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut
Ofrojnë arsimim dhe trajnime për personelin që punon me raportet	Shqipëria, Serbia
Ka teknologji të skanimit automatik për përmbajtje të pahijshme	Maqedonia e Veriut
Ofrojnë raportim anonim të përmbajtjes së papërshtatshme	Shqipëria, Serbia, Kosova
Kanë programe për parandalimin	Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut

FIGURA 21 Panoramë e përgjithshme e personelit të kompanive të TIK-ut dhe e kapacitetit të tij.

Për sa i takon personelit të kompanive të TIK-ut dhe kapacitetit të tij, të anketuarit nga të gjitha vendet, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, pohojnë se ata kanë personel që trajton raportet për përmbajtje të pahijshme ose të paligjshme. Megjithatë, vetëm punonjësit e kompanive të TIK-ut nga Shqipëria dhe Serbia kanë marrë arsimim dhe trajnime shtesë për të menaxhuar këto raporte. Për sa i takon teknologjisë së skanimit automatik, vetëm punonjësit e TIK-ut në Maqedoninë e Veriut raportojnë se e përdornin këtë teknologji. Për sa i takon raportimit anonim të përmbajtjes së pahijshme, të anketuarit nga Shqipëria, Serbia dhe Kosova pohojnë se e kanë aktivizuar këtë funksion në faqet e tyre të internetit. Më tej, të gjithë respondentët, me përjashtim të atyre nga Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina, konfirmuan se kanë marrë pjesë në programe për parandalimin e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.

Kur punonjësit e kompanive të TIK-ut u pyetën në lidhje me zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e sektorit të TIK-ut rreth rasteve të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia, personeli nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut konfirmoi ekzistencën e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, ndërsa respondentët nga Mali i Zi dhe Serbia deklaruan se vendet e tyre nuk i kanë këto ligje. Punonjësit e kompanive të TIK-ut në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk u përgjigjën kësaj pyetjeje. Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia konfirmuan se kanë protokolle të specializuara për rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. Të intervistuarit nga të gjitha vendet, me përjashtim të atyre nga Bosnja dhe Hercegovina, konfirmuan bashkëpunimin e kompanive të tyre me organizatat dhe institucionet e tjera (kryesisht agjenci qeveritare dhe të zbatimit të ligjit). Për më shumë hollësi, shihni figurën 22.

Vendi	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Zbaton ligje lidhur me përgjegjësitë e sektorit të TIK-ut në rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia	Po	–	Po	Po	Po	Jo
Ka protokolle të specializuara për rastet e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia	–	Jo	Po	–	Po	Po
Ka bashkëpunim me organizata qeveritare/ organizata të shoqërisë civile dhe institucione	Po	Jo	Po	Po	Pjesërisht	Po

FIGURA 22 Panoramë e përgjithshme e zbatimit të ligjeve nga ana e kompanive të TIK-ut dhe e ekzistencës së protokolleve dhe bashkëpunimit

Kompanitë e udhëtimit, hotelet dhe industria e turizmit

Revistat turistike në Serbi e prezantojnë vendin si destinacion me "jetë nate të shkëlqyer e jo të shtrenjtë dhe me vajza të bukura".¹⁶⁵ Ekspertët kanë paralajmëruar që këto lloje reklamash mund të tërheqin autorë të mundshëm të SHSF-UT-së dhe që industria lokale e udhëtimeve dhe turizmit nuk është e përgatitur sa duhet për të identifikuar, raportuar dhe parandaluar rastet e SHSF-UT-së.¹⁶⁶

Në fakt, duket se ka një mospërputhje të madhe midis nivelit të përgatitjes dhe njohurive për SHSF-UT-në te bizneset e vogla dhe te hotelet private dhe te disa zinxhirë më të mëdhenj hotelesh që veprojnë në mbarë rajonin. Këta të fundit shprehën se kishin njohuri të kufizuara rreth SHSF-UT-së dhe rreth procedurave të përshtatshme për reagimin ndaj rasteve të dyshuara. Një menaxhereje të një hoteli të vogël, e intervistuar në Shqipëri, iu desh të kërkonte në "Google" kuptimin e SHSF-UT-së, sepse këtë temë e dëgjonte për herë të parë. Një i intervistuar tjetër në Bosnjë dhe Hercegovinë shprehu frustrimin e tij duke thënë: "Nuk ka të dhëna lidhur me identifikimin dhe referimin e viktimave dhe nuk ka procedura në lidhje me këtë, me përjashtim të udhëzimeve verbale për stafin, d.m.th. që duhet marrë në telefon policia nëse dyshohet se ndonjë fëmijë është i përfshirë në ofrimin e shërbimeve seksuale për klientët që paguajnë".¹⁶⁷ Personeli i hoteleve në Shqipëri ngriti si shqetësim edhe faktin se nuk kishte procedura specifike lidhur me atë se si të verifikonin që fëmijët që kalonin natën në hotel ishin duke qëndruar me kujdestarët e tyre ligjorë.¹⁶⁸

Në nivelin ndërkombëtar, "Kodi i mirësjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në udhëtime dhe turizëm" ("Kodi") është një nismë me shumë palë të interesuara, e cila ka për synim rritjen e vetëdijesimit, ofrimin e mjeteve dhe dhënien e mbështetjes për kompanitë në industrinë e turizmit me qëllim parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Kodi ka për qëllim të përforcojë angazhimin e kompanive që veprojnë në këtë industri që të bëhen pjesë e luftës kundër trafikimit dhe abuzimit të fëmijëve. Ata që angazhohen ta ndjekin këtë kod, angazhohen se do t'i ofrojnë trajnime të herëpashershme personelit të hotelit, do të përfshijnë klauzola mbi SHSTF-në në kontratat e tyre me furnitorët, do të informojnë klientët e hotelit dhe do të heqin dorë publikisht nga SHSTF-ja.¹⁶⁹ Në figurën 23 paraqiten palët e interesuara në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat janë angazhuar të respektojnë Kodin.

Vendi	Kompanitë turistike të regjistruara	Palët nënshkruese të Kodit
Shqipëria	1 326 ambiente të regjistruara akomodimi në Shqipëri në vitin 2018. ¹⁷⁰ 1 259 agjenci udhëtimi të regjistruara duke përfshirë operatorët turistikë, etj.) në Shqipëri në vitin 2019. ¹⁷¹	Shtatë kompani ndërkombëtare të udhëtimeve dhe turizmit, të cilat veprojnë edhe në Shqipëri, janë anëtare të këtij Kodi. Asnjë kompani udhëtimesh dhe turistike me seli në Shqipëri nuk është palë nënshkruese e këtij Kodi. Në faqen e internetit, janë renditur vetëm dy kompani ndërkombëtare.
Bosnja dhe Hercegovina	Në dhjetor të vitit 2020, 62 kompani udhëtimi të licencuara dhe 190 ambiente akomodimi u regjistruan në Republikën Serbe. ¹⁷² Në fund të vitit 2019, kishte 512 ambiente të regjistruara akomodimi në Kantonin e Sarajevës. ¹⁷³	Nuk ka palë nënshkruese të Kodit. Kodi (ose referimet në të) nuk është i disponueshëm në asnjë faqe interneti qeveritare.
Kosova	Në vitin 2016, në Kosovë u regjistruan 490 biznese në fushën e akomodimit. ¹⁷⁴	Nuk ka të dhëna. Kur u intervistuan, përfaqësuesit e Unionit të Turizmit të Kosovës dhe Odës së Hotelarisë dhe Turizmit të Kosovës nuk ishin të informuar për Kodin.
Mali i Zi	Janë regjistruar 248 organizues udhëtimesh dhe 94 agjenci udhëtimi dhe/ose ndërmjetës. ¹⁷⁵	Sipas faqes së internetit, ka dy palë nënshkruese. Megjithatë, më shumë se 200 palë nënshkruese përmenden në një dokument studimor të Këshillit të Evropës. ¹⁷⁶
Maqedonia e Veriut	Në vitin 2010, në Maqedoninë e Veriut u regjistruan 1 132 biznese në fushën e akomodimit. ¹⁷⁷ Në vitin 2016, u regjistruan 571 agjenci udhëtimi. ¹⁷⁸	Në internet nuk është përmendur asnjë palë nënshkruese. Nuk ka informacione të mëtejshme.
Serbia	Në vitin 2018, u regjistruan 1 259 agjenci udhëtimi. ¹⁷⁹	Dy palë nënshkruese.

FIGURA 23 Palët nënshkruese të Kodit në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

BURIMI: Informacionet u siguruan, ndër të tjera, nga faqja e internetit të Kodit dhe nga institutet kombëtare të statistikave.

Zbatimi sporadik i Kodit edhe nga filialet lokale të zinxhirëve ndërkombëtarë të hoteleve ka çuar në kufizim të njohurive rreth SHSF-UT-së. Për shembull, personeli i hoteleve që punon në disa prej hoteleve më të mëdha në Prishtinë të Kosovës deklaroi se nuk kishte asnjë njohuri lidhur me reagimet që janë specifike për industrinë, praktikat më të mira ose nismat për të reaguar si duhet ndaj SHSF-UT-së.¹⁸⁰

Hotelet në Ballkanin Perëndimor nuk janë të detyruara me ligj që të kenë udhërrëfyes ose protokolle specifike lidhur me reagimin ndaj SHSF-UT-së. Një i intervistuar dha këtë shpjegim: "Për sa kohë ndjek ligjin, reagimet ndaj parandalimit të SHSF-UT-së varen nga përpjekjet individuale të menaxherit ose të ndonjë anëtarit tjetër të personelit të hotelit. Kompania jonë nuk ka procedura të përkufizuara qartë, por, meqenëse pjesa më e madhe e menaxherëve të sektorit tonë ka përvojë pune në zinxhirët ndërkombëtarë të hoteleve, ne ndjekim dhe zbatojmë praktikën e mira nga rajoni dhe më gjerë".¹⁸¹ Edhe një koleg i tij nga Serbia dha këto komente bazuar nga përvoja e tij: "Në njërin prej punëve të mia të mëparshme në një hotel privat në Beograd, kuptova—falë përvojës sime të fituar në Perëndim—se një prej të klientëve tanë, një qytetar i huaj, rezervoi një apartament presidencial për 20 ditë dhe priste për vizitë, dy herë në ditë, djem dhe meshkuj të rinj midis moshës 17 dhe 20 vjeçare. Ai i shfrytëzonte ata seksualisht. Ne e raportuam rastin te Policia, e cila na tha se nuk mund të bënte asgjë nëse çdo gjë kryhej me vullnetin e lirë të palëve. E vetmja gjë që mundëm të bënim ishte të refuzonim të zgjasim afatin e tij të qëndrimit, duke nxjerrë si justifikim se apartamenti nuk do të ishte më i lirë."¹⁸²

Situata është disi e ndryshme në një numër të caktuar të zinxhirëve ndërkombëtarë të hoteleve që kanë udhëzimet dhe protokollet e brendshme për trajtimin e SHSF-UT-së. Për shembull, hoteli "Marriott International" raportohet se u ofron trajnime të detyrueshme të gjithë personelit në lidhje me identifikimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual. Kompania ka botuar edhe një udhërrëfyes që përmban informacione lidhur me rritjen e vetëdijesimit dhe reagimet ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.¹⁸³ Krahas raportimit të rasteve të dyshuara tek autoritetet lokale në vend, hoteli i kërkon punonjësve të raportojnë edhe në strukturat e brendshme

të vetë hotelit. Proceset e prokurimit i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm të furnitorëve.

Në të njëjtën mënyrë, grupi i hoteleve "Accor Hotels Group" ka krijuar një program të quajtur "WATCH" (We Act Together for Children—Veprimë së bashku për fëmijët). Programi nisi zyrtarisht në vitin 2014 dhe ka për qëllim parandalimin dhe reagimin, sa më shpejt që të jetë e mundur, në rastet e dyshuara të SHSF-UT-së.¹⁸⁴ Hoteli "Accor Hotels" në Maqedoninë e Veriut nënshkroi zyrtarisht Kodin në vitin 2019 si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me OJQ-në lokale "Open Gate —La Strada Macedonia" dhe Komisionin Kombëtar për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migrimit të Paligjshëm. Trajnimi u bë i detyrueshëm për të gjithë punonjësit dhe u zhvillua në qershor dhe korrik të vitit 2019.¹⁸⁵ Për shkak të pandemisë "Kovid-19", në vitin 2020 nuk mundi të organizohej asnjë veprimtari ose, deri më tani në vitin 2021, nuk është planifikuar asnjë e tillë.¹⁸⁶ Edhe punonjësit e hoteleve "Accor" theksuan rëndësinë që kanë në punën e tyre të përditshme programi "WATCH" dhe Kodi.¹⁸⁷

Edhe pse, gjatë viteve të fundit, nga personeli i hoteleve në Serbi dhe Mal të Zi janë raportuar fare pak raste të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm, shumë ekspertë të intervistuar për këtë raport vunë në dukje se kishte pasur edhe incidente të tjera—madje edhe ndërkohë që ata ishin në detyrë.¹⁸⁸ Një punonjës i një hoteli në Serbi shpjegoi se pas trajnimeve si "moduli i kursit elektronik për Kodin", hoteli raportoi një rritje të ndjeshme të identifikimit të autorëve të veprave penale dhe një rritje të reagimit nga ana e personelit të hotelit.¹⁸⁹ Ai u shpreh: "Shenjat paralajmëruese të këtyre dukurive mund të jenë fare të vogla, por ato mund të vihen re nëse punonjësit e hotelit dinë ku të shohin. Këto janë imtësi të vogla, p.sh. kur klienti përdor shumë celularë ose karta krediti, regjistrohet me bagazh të vogël ose pa bagazh fare, shfaq mosbesim ndaj sigurisë dhe mund të sillt sikur po e vëzhgojnë, etj."¹⁹⁰

Të gjithë ekspertët e intervistuar janë dakord se në mbarë Ballkanin Perëndimor duhet të kihet më shumë vëmendje. Një përfaqësues i hotelit "Marriott Hotel" në Serbi e përshkroi këtë në këtë mënyrë: "Nëse duam ta marrim Beogradin seriozisht si destinacion turistik, duhet ta marrim seriozisht edhe atë [SHSF-UT-në], të flasim për këto problematika dhe të veprojmë në mënyrë parandaluese."¹⁹¹

Megjithëse Shqipëria nuk ka legjislacion që e kriminalizon organizimin e aranzhimeve të udhëtimeve që lehtësojnë, në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, mundësitë për përfshirjen në shfrytëzimin seksual të fëmijëve, kjo nuk do të thotë që një kompani nuk mund të mbajë përgjegjësi nëse veprat penale (duke përfshirë SHSTF-në) ndodhin në emër të saj ose për përfitime të saj.¹⁹² Kompanitë e shpallura fajtoresh për një vepër të parashikuar nga ky ligj mund të ndëshkohen me gjobë ose me anë të humbjes së personalitetit të tyre juridik.¹⁹³ Deri më tani, në Shqipëri, nuk ka pasur shenja se diçka e tillë ka ndodhur ndonjëherë, por në Maqedoninë e Veriut, prona e paluajtshme, që ishte në pronësinë e një biznesi katering, u sekuestrua në vitin 2015, sepse ishte përdorur për të kryer shfrytëzim seksual tregtar të fëmijëve.¹⁹⁴

Aktorët e tjerë në sektorin privat


Sigurisht, industria e udhëtimeve dhe turizmit nuk kufizohet vetëm te hotelet. Motelet, bujtinat me mëngjes dhe platformat si "Airbnb" janë, edhe ato, pjesë e industrisë së hotelierisë. Krahas kësaj, agjencitë e udhëtimeve, industria e argëtimit, kompanitë e vaporëve dhe linjave detare (ndër të tjera), luajnë një rol kyç në identifikimin dhe parandalimin e SHSF-UT-së dhe në reagimin ndaj saj.

Megjithatë, jashtë industrisë së hotelierisë, asnjë biznes me të cilin kontaktua nuk mundi të japë informacion lidhur me mënyrën se si e trajtojnë këtë temë. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, ata iu referuan edhe një herë përvojave ndërkombëtare, të cilat i përdornin si shembuj të praktikave më të mira.



PËRFUNDIME

OJQ-të në Ballkanin Perëndimor ofrojnë informacione dhe organizojnë fushata për rritjen e vetëdijesimit lidhur me rreziqet që paraqet sfera digjitale. © Vladimir Zivojinovic



Pavarësisht se në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, njohuritë dhe vetëdijesimi rreth SHSTF-së janë të kufizuara, ky raport ka treguar se SHSTF-ja ndodh në të gjitha vendet e rajonit. Në këtë raport është paraqitur një panoramë e përgjithshme e manifestimeve të ndryshme të SHSTF-së, është vlerësuar ndikimi i pandemisë "Kovid-19" në këtë dukuri dhe është analizuar roli i autorëve të krimit dhe profili i fëmijëve që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të SHSTF-së në mbarë rajonin.

Gjetjet e këtij raporti mund të lënë të kuptohet se numri i rasteve të SHSTF-së të regjistruara në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor është i ulët. Megjithatë, mungesa e të dhënave të përditësuara dhe të ndara në kategori, e kombinuar me prirjen e përgjithshme për të mos i raportuar rastet aq sa duhet, ka shumë të ngjarë t'i bëjë shifrat që paraqiten këtu të duken si nënvlerësim i ndjeshëm. Sikurse është treguar më herët, fëmijët përballen me rreziqe të ngjashme në mbarë vendet e Ballkanit Perëndimor, ku pakicat etnike dhe fëmijët nga komunitete të disavantazuara nga pikëpamja social-ekonomike janë veçanërisht më të ekspozuar ndaj rreziqeve. Krahas kësaj, "kërkesa" është rritur këto vitet e fundit, falë anonimitetit që ofron interneti dhe rritjes së turizmit. Gjithashtu, edhe pse zbulohen raste të reja të shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve, shfrytëzim ky i mundësuar përmes medieve sociale ose platformave të komunikimit në internet, masat që merren lidhur me ato raste janë të pakta. Edhe kur identifikohen viktimat, institucionet, sektori privat dhe shoqëria civile shpesh nuk kanë kapacitetin dhe njohuritë për të trajtuar dukurinë në një mënyrë efektive.

Megjithëse ky raport rrit njohuritë lidhur me SHSTF-në në mbarë rajonin dhe na jep të kuptojmë më mirë ekosistemin ku ndodh shfrytëzimi, ai nxjerr në pah edhe nevojën për më shumë informacione, sidomos nga burime zyrtare. Në të vërtetë, gjatë realizimit të intervistave për këtë raport, të binte në sy se sa pak dinin autoritetet ose se sa pak informacione ishin të gatshme të bashkëdanin. Gjithashtu, ishte e habitshme se sa pak bëhet për të luftuar dhe parandaluar SHSTF-në çdo ditë, në mënyrë operative. Një pjesë e arsyes mund të jetë që SHSTF-ja, deri më tani, nuk ka qenë në qendër të vëmendjes së organeve të zbatimit të ligjit ndërkohë që çështjet e tjera (p.sh. trafikimi i drogës dhe kontrabandimi i emigrantëve) tërheqin më shumë vota dhe nxisin më shumë interes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



▲ Fëmijët e familjeve rome në Beograd të Serbisë përdorin shërbimet që ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile për të ndenjur larg rrugëve. © Vladimir Zivojinovic


Gjithsesi, një përfundim i përgjithshëm i këtij raporti është se, ndonëse numrat mund të duken të ulët, dobësitë aktuale në infrastrukturën e mbrojtjes së fëmijëve, kapaciteti i kufizuar institucional, mungesa e specializimit dhe angazhimit nga ana e shoqërisë civile dhe vetëdija e ulët e sektorit privat, e ekspozojnë rajonin dhe i bëjnë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të cenueshme përballë SHSTF-së. Në fakt, këto dobësi, të amplifikuara nga rreziku i ulët i zbulimit dhe ndjekjes penale të autorëve, krijojnë një hapësirë të hapur ku aktorët kriminalë mund të shtrijnë veprimtaritë e tyre dhe SHSTF-ja të lulëzojë.

Ekziston një nevojë e qartë për më shumë mirëkuptim dhe më shumë kapacitete në rajon për të trajtuar SHSTF-në. Duke marrë parasysh dobësitë e përbashkëta të vendeve të rajonit dhe karakterin ndërkombëtar të kësaj dukurie, lipset të ndiqet një qasje e përbashkët rajonale për të siguruar një reagim efikas. Komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë mund t'i mbështesë këto përpjekje, jo vetëm duke bashkëndarë njohuritë dhe ekspertizën e tij, por edhe duke këmbëngulur që të bëhet më shumë për t'iu përshtatur standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira ekzistuese dhe për t'i zbatuar dhe respektuar ato.

Në nivel kombëtar, duhet të rriten kapacitetet e të gjitha palëve të interesit dhe të përkrahet një qasje më gjithëpërfshirëse. Duhet të përkrahen bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve midis autoriteteve qeveritare, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Më poshtë, jepet një listë e plotë rekomandimesh.

Si përfundim, për të parandaluar SHSTF-në dhe për të reaguar ndaj saj, ekziston nevojë për më shumë informim dhe koordinim në nivel kombëtar dhe rajonal. Ndërkohë që pandemia "Kovid-19" lehtëson dhe thëllon më tej shumë prej dobësive të përmendura më lart, ky është momenti për të vepruar.

▼ Një organizatë e shoqërisë civile në Bosnjë dhe Hercegovinë ofron mbështetje për fëmijët që kanë vuajtur nga dhuna. © Bahrudin Bandić





REKOMANDIME TË POSAÇME PËR RAJONIN

Fëmijë nga një komunitet i varfër në Bosnjë dhe Hercegovinë, i rrezikuar nga forma të ndryshme të shfrytëzimit. © *Bahrudin Bandić*

Ky raport ka vlerësuar dobësitë aktuale dhe cenueshmërinë ndaj SHSTF-së në mbarë Ballkanin Perëndimor. Duke pasur parasysh se ka nevojë të madhe për kuptim më të thellë dhe për më shumë kapacitete në rajon në drejtim të trajtimit të SHSTF-së, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel rajonal. Së pari dhe mbi të gjitha, sugjerohet të ngrihet një rrjet parandalimi rajonal mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor:

- 1.** Për të mundësuar një cikël vicioz praktikë-hulumtim dhe hulumtim-praktikë.
- 2.** Për të mbështetur gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që të rrisin ndërgjegjësimin, duke krijuar fushata mediatike dhe materiale trajnimi të fokusuara.
- 3.** Për të ngritur grupe pune që do të lehtësonin shkëmbimin e praktikave më të mira dhe do të punonin në lidhje me nisma konkrete në funksion të arritjes së rezultateve të prekshme. Grupet e punës mund të organizohen sipas praktikës (d.m.th. sipas formimit profesional, p.sh. profesionistët e shëndetësisë, punonjësit socialë, arsimtarët, personeli i organeve ligjzbatuese, personeli i autoriteteve gjyqësore, personeli i autoriteteve të burgjeve, politikëbërësit dhe hulumtuesit shkencorë) dhe sipas programit (d.m.th. sipas grupit të synuar).

Më poshtë, jepen rekomandime më të hollësishme, të ndara sipas grupit të synuar. Në pjesën vijuese jepen edhe rekomandime specifike për secilin vend, edhe këto të ndara sipas grupit të synuar. Siç paraqitet në figurën 24, kuadri ligjor është tepër i rëndësishëm për zbatimin e ligjit dhe ndjekjen penale të rasteve të SHSTF-së dhe të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore të ndihmuara nga teknologjia. Këto ligje duhet të shqyrtohen për të siguruar që ato të zbatohen në mënyrën e duhur për këto vepra penale dhe që të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të parashikuara në Konventën e Lanzarotit dhe atë të Budapestit. Në këto ligje bëjnë pjesë kodet penale, kodet e procedurës penale, rregulloret e provave, legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore, legjislacioni për krimet kibernetike, legjislacioni për rregullimin e OSHI-ve (duke përfshirë këtu edhe detyrimet e tyre për të bashkëndarë të dhëna) dhe ligjet që kanë të bëjnë me operacionet dhe hetimet e fshehta.




FIGURA 24 Grupet e shënjestruara të SHSTF-së dhe grupi i palëve të interesuara.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve,¹⁹⁵ nëpërmjet pjesëmarrjes së palëve të ndryshme të interesuara, ku përfshihen autoritetet e zbatimit të ligjit, shoqëria civile dhe sektori privat, mund të përballlet me pengesa burokratike dhe organizative kur është fjala për koordinimin e aktorëve përkatës që merren me mbrojtjen e fëmijëve. Hartimi dhe zbatimi i suksesshëm i operacioneve të koordinuara, shkëmbimi efikas i të dhënave dhe transferimi i qëndrueshëm i njohurive vazhdojnë të jenë sfida që ka nevojë për vëmendje urgjente. Më konkretisht, rekomandohet që:

Të hartohen strategji kombëtare për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

- Të identifikohet një organ ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të konventës "Për të drejtat e fëmijës", e koordinuar midis niveleve vendore dhe qendrore dhe të ofrohen shërbime të përshtatshme të kujdesit social në nivel lokal (ekipe lokale shumëdisiplinore: punonjës shëndetësorë, sociologë, juristë, psikologë, etj.) dhe të ndërlikohen strategjitë përkatëse kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, trafikimin e qenieve njerëzore, arsimimin, përfshirjen sociale, etj.
- Të hartohen masa që kanë për objekt SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia dhe masa që synojnë parandalimin e SHSTF-së, me qëllim mbrojtjen e fëmijëve edhe në afatshkurtër, edhe në afatgjatë.
- Të plotësohen strategjitë kombëtare me plane lokale të veprimit.
- Të angazhohen fëmijët, duke përfshirë edhe fëmijët viktimë, në hartimin dhe procesin e zbatimit të planeve të ndryshme kombëtare të veprimit.

Të përqendrohet vëmendja te përmirësimi i të dhënave lidhur me SHSTF-në.


- Të nisen dhe të financohen hulumtimet për mbledhjen e të dhënave dhe të sigurohet që të gjitha palët e interesuara të përfshihen në procesin e përditësimit të të dhënave.
- Të krijohet një bazë e unifikuar të dhënash, me një grup treguesish të zhvilluar, që do të mundësojnë monitorimin dhe analizimin (identifikimi i kategorive të cënueshme).
 - Të identifikohet një organ si kujdestar ose pronar i kësaj baze të dhënash dhe si pikë e parë kontakti për qasjen në të dhëna (të dhëna meta ("metadata")).
 - Të zhvillohet një sistem numrash unik çështjesh për të gjitha organet e përfshira, me qëllim shmangien e regjistrimeve të dyfishta.
- Të publikohen rregullisht raporte të statistikave kombëtare dhe të shpërndahen informacione herë pas here.

- Të përdoren rezultatet e hulumtimit për të përcaktuar dhe krijuar masa parandaluese.
- Të monitorohet numri i kallezimeve për trafikim të qenieve njerëzore, duke përfshirë këtu trafikimin e fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe në punë, dhe të bashkëndahen të dhëna me aktorët përkatës nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve dhe organet e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Të përmirësohet mekanizmi i koordinimit midis shumë agjencive (jashtë sistemit tradicional të mbrojtjes së fëmijëve).

- Të përfshihen të gjitha organet përkatëse që punojnë në këtë fushë (sidomos OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar dhe njësitë për hetimin e krimeve kompjuterike), duke vënë theksin te roli që luajnë agjencitë e ndryshme në reagimin ndaj nevojës në rritje për më shumë informacion, financim dhe ndërhyrje në fushën e SHSTF-së.
- Të përdoret mekanizmi i koordinimit midis shumë agjencive në funksion të hartimit të standardeve objektive të njohjes së klientëve dhe të bëhen të detyrueshme këto standarde.
 - Akti i BE-së "Për shërbimet digjitale" përbën një mundësi kyçe për caktimin e standardeve të pranura gjerësisht, gjë që është çelësi për të siguruar që kuadrot rregullatore të jenë të përshtatshme për qëllimin e rregullimit të rolit vendimtar të OSHI-ve, duke përfshirë edhe tregjet e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Të punohet me partnerët për t'u angazhuar me sektorin financiar me qëllim nxitjen e zhvillimit të nismave dhe mjeteve për trajtimin e realizimit të paqëllimtë të trafikimit të qenieve njerëzore, të mundësuar nga teknologjia, dhe përmirësimin e përdorimit të inteligjencës financiare për t'ua marrë asetet autorëve të krimit.

▼ Një punonjës social në Bosnjë dhe Hercegovinë gjurmon rastet më të mëdha të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në një hartë. © Bahrudin Bandic



- Të përmirësohet bashkëpunimi me OSHI-të në drejtim të monitorimit dhe rregullimit të ekspozimit të pavullnetshëm të fëmijëve ndaj përmbajtjes seksuale në internet dhe të ofrimit të të dhënave të nevojshme për hetim dhe vlerësim.
- Të nxitet bashkëpunimi midis ministrive të ndryshme, sidomos Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, në drejtim të hartimit dhe miratimit të një strategjie të përbashkët nga shumë palë të interesuara për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual.

Edhe pse pjesa më e madhe e rekomandimeve janë të vlefshme për parandalimin e të gjitha formave të SHSTF-së, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së minoriteteve. Në veçanti:

- Të përkufizohen masat e posaçme për mbrojtjen e fëmijëve romë dhe emigrantë, duke përfshirë ekipet e specializuara ku bëjnë pjesë edhe OSHC-të e drejtuara nga romët, me fokus të veçantë te zbulimi dhe parandalimi i lypjes së detyruar dhe martesave të hershme ose të detyruara.
- Të krijohen programe riintegrimi, për viktimat kombëtare/të huaja të trafikimit të qenieve njerëzore pas qëndrimit të tyre në qendrat e pritjes.
- Të përfshihen përfaqësuesit e komuniteteve romë në organet ekzistuese kuadër.

Të nxitet bashkëpunimi rajonal midis qeverive.

- Të përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe të nënshkruhen marrëveshje me OJQ-të (që duhet të shihen si partnerë dhe jo si ofrues shërbimi).
- Të nisë nënshkrimi i marrëveshjeve midis vendeve në rajon në lidhje me SHSTF-në dhe SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia.

Të krijohen mekanizma zyrtarë të mbrojtjes dhe monitorimit.

- Të krijohen skema regjistrimi për të ndihmuar në monitorimin e sistemeve dhe në identifikimin e fëmijëve viktimë të mundshëm të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe SHSTF-së, sidomos të fëmijëve të pashoqëruar, me qëllim uljen e rrezikut e tyre ndaj shfrytëzimit.
- Të përforcohen dhe mbështeten financiarisht mekanizmat e linjave të ndihmës dhe e linjave të drejtpërdrejta telefonike për raportimin e përmbajtjeve të papërshtatshme dhe për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave, duke siguruar anonimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të viktimave.
- Të krijohen mekanizma të pavarur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, p.sh. nëpërmjet avokatit të popullit.
- Të përfshihen përfaqësuesit e industrisë së udhëtimeve dhe turizmit në mekanizmat kombëtarë të referimit dhe në zbatimin e procedurave ekzistuese standarde të veprimit.
- Të kryhet një analizë e rregullores për licencimin e shërbimeve, në lidhje me licencimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët. Të garantohet që OSHC-të e përzgjedhura që u ofrojnë shërbime viktimave të financohen në mënyrë të mjaftueshme.
- Të garantohet që asistenca ndaj viktimave, p.sh. akomodim, ndihmë psikosociale, ligjore dhe mjekoligjore, dhe çdo ndihmë e mëtejshme të përshtatet sipas nevojave të fëmijëve për t'u mundësuar atyre të rikuperohen plotësisht dhe të riintegrohen në komunitetet e tyre.
 - Të krijohet një fond për ofrimin e kompensimit për fëmijët viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual, në rastet kur ky kompensim nuk mund t'i merret autorit të krimit.



- Të shtohen përpjekjet për konfiskimin e aseteve që janë siguruar përmes veprimeve të ndërlidhura me trafikimin e qenieve njerëzore.

Të rritet vetëdijesimi dhe të fuqizohet ekspertiza.

- Të përmirësohen dhe zgjerohen kurrikulat shkollore për të përfshirë edhe edukatën për sigurinë digjitale dhe sigurinë në internet, identifikimin e rreziqeve dhe sjelljet për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- Të zhvillohen fushata informimi me qëllim informimin e prindërve rreth sigurisë në internet për fëmijët për kanale të caktuara komunikimi.
- Të realizohen trajnime të detyrueshme rreth shfrytëzimit dhe abuzimit seksual në hapësirat virtuale për të gjithë personelën, mësuesit, prindërit, civilët dhe vullnetarët.

Të harmonizohet angazhimi i donatorëve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në lidhje me sferën e SHSTF-së.

- Të përmirësohet koordinimi i donatorëve dhe nismat përcjellëse të ngritjes së kapaciteteve (nuk është e nevojshme të bëhen trajnime të përgjithshme, por trajnime më të specializuara).
- Të mbështetet ofrimi i trajnimeve rajonale rreth SHSTF-së, në mënyrë specifike për njësitë për hetimin e krimeve kibernetike (kompjuterike), prokurorët dhe personelën e organeve ligzbatuese, në vend që të shënjestrohen shtetet e veçanta.
- Të nxiten të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që të marrin pjesë në përpjekjet bashkëpunuese të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, në drejtim të identifikimit të fëmijëve me Qendrën Evropiane për Krimet Kibernetike të Europol-it (EC3) ose përmes bazës së të dhënave ndërkombëtare për Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve (ICSE), e cila ruhet në INTERPOL.

▲ Këtij fëmije po i jepet ndihmë nga një OJQ në Bosnjë dhe Hercegovinë, e cila merret me mbështetjen e fëmijëve në nevojë. © Bahrudin Bandić


Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

Organet kombëtare të zbatimit të ligjit, të ngarkuara me detyrën e hetimit dhe ndjekjes penale të SHSTF-së dhe të veprave të trafikimit të fëmijëve, vepra këto që mundësohen nga teknologjia, argumentuan, në pjesën më të madhe të tyre, se përkufizimet ekzistuese në legjislacionin e tyre kombëtar ishin mjaftueshëm të gjera sa të zbatoheshin për një gamë të gjerë kontekstesh ku ndodh shfrytëzimi. Për këtë arsye, ata nuk e shihnin legjislacionin si pengesë për realizimin e operacioneve të tyre. Megjithatë, nga pikëpamja operative, detyrimet e qarta ligjore për të zbuluar dhe raportuar rreth SHSTF-së dhe shfrytëzimit të ndihmuar nga teknologjia janë të nevojshme për të sjellë më shumë qartësi dhe siguri në punën e organeve ligjzbatuese dhe aktorëve të ndërlidhur në sektorin privat dhe për të trajtuar abuzimin në internet. Duke qenë se ekspertiza e posaçme ka rëndësinë më të madhe, reagimet për të siguruar ngritje të qëndrueshme e të mjaftueshme të kapaciteteve janë në ballë të kërkesave. Më konkretisht, rekomandohet që:

Të shtohen trajnimet dhe të ngrihet kapaciteti i oficerëve të policisë, prokurorëve (dhe personelit mbështetës), gjyqtarëve dhe të gjithë aktorëve përkatës, të cilët kanë kontakte të rregullta me fëmijët (sistemi arsimor, shëndetësor dhe social).

- Të krijohet një organ policor i specializuar për krimet e mundësuar nga teknologjia, me përqendrim të veçantë të SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia. Ministria e Brendshme, përmes akademisë së policisë, duhet të krijojë dhe ofrojë trajnime të përshtatshme dhe të specializuara me qëllim ngritjen e kapacitetit për të gjithë oficerët përkatës.
- T'i kushtohet vëmendje zbatimit të mjaftueshëm të "Kodit të drejtësisë penale për fëmijët" dhe termave teknikë (p.sh. për SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia).
- Të zhvillohen kurrikula trajnimesh të specializuara për akademitë e policisë dhe qendrat e edukimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- Të kryhet një vlerësim i nevojave për trajnim dhe të krijohen plane vjetore të veçanta për zhvillimin profesional të të gjitha palëve përkatëse të interesuara, të cilat përfshihen në sistemin e parandalimit dhe mbrojtjes.

▼ Një punonjëse sociale përgatit materialin për rritjen e vetëdijesimit për rreziqet në internet, për një komunitet të varfër në Bosnjë dhe Hercegovinë. © Bahrudin Bandić



- Të hartohen protokolle për mënyrën se si duhet nxjerrë materiali i abuzimit, duke qenë se pjesa më e madhe e inteligjencës në rajon vjen nga burime dhe ekspertiza e jashtme (Europol-i etj.).
- Të sigurohet që oficerët e zbatimit të ligjit të pajisen si duhet për të menaxhuar rastet që kanë të bëjnë me SHSTF-në, p.sh me përvojë pune të mëparshme me fëmijët, trajnime të përshtatshme, përvojë pune me krimet ku janë të përfshirë fëmijët ose me krimet me natyrë seksuale, etj.

Të nxitet bashkëpunimi midis organeve të sektorit gjyqësor dhe sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve në kuadër të hetimit të rasteve.

- Të përmirësohen linjat e komunikimit të drejtpërdrejtë midis oficerëve të policisë, prokurorëve dhe laboratorëve të njësisë për hetimin e krimeve kibernetike.
- Të organizohen takime të përbashkëta të rregullta për përfaqësuesit e organeve të zbatimit të ligjit dhe ata të prokurorisë në nivelin kombëtar dhe rajonal.
- Të fuqizohet bashkëpunimi me inspektoratin e punës, sidomos për të parandaluar SHSF-UT-në.

Të pajisen organet e zbatimit të ligjit me mjetet e duhura.

- Të përditësohen në mënyrë të rregullt edhe pajisjet dhe softuerët e nevojshëm.
- Të riinvestohet në strukturën e laboratorit kombëtar të kibernetikës për mjete më të mira teknologjike dhe mënyra më të mira hetimi.

Shoqëria civile: OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare dhe shumëpalëshe

Shoqëria civile ka qenë shumë aktive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përmes ofrimit të ndihmesës ndaj viktimave, rritjes së vetëdijesimit për problemin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe avokimit për të drejtat e viktimave. Gjatë viteve të fundit, shoqëria civile ka krijuar, gjithmonë e më shumë, aleanca të reja me sektorin privat në të gjitha industritë, me qëllim përmirësimin e qasjes më gjithëpërfshirëse në drejtim të uljes së rrezikut të shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve në ekonomitë e globalizuara. Gjithashtu, politikëbërësit ndërkombëtarë kanë përsëritur nevojën për përfshirjen e vazhdueshme të shoqërisë civile në shtjellimin dhe zbatimin e politikave për parandalimin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për zbatimin e normave të brendshme përmes vetërregullimit ose bashkërregullimit. Më konkretisht, rekomandohet që:

Të shtohen njohuritë e shoqërisë civile dhe të komuniteteve rreth SHSTF-së, sigurisë digjitale dhe rreziqeve të mundshme që u kanosen fëmijëve në hapësirën virtuale.

- Të lehtësohet pjesëmarrja e fëmijëve dhe rinisë në fushatat për rritjen e vetëdijesimit dhe bashkëndarjen e informacioneve në lidhje me këtë dukuri.
- Gazetarët, sidomos media në internet dhe profesionistët, duhet të edukohen dhe trajnohen për të ofruar informacione të përshtatshme në lidhje me të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit të fëmijëve, duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë së viktimave.

Të ngrihen kapacitetet dhe të përmirësohet qëndrueshmëria e shoqërisë civile.

- T'u kushtohet vëmendje fëmijëve nëpërmjet sistemeve të mbështetjes me bashkëmoshatarë dhe programe edukimi.
- Të mobilizohen burimet financiare dhe njerëzore për të vazhduar më tej shembullin e suksesshëm dhe mekanizmin e ekipeve lëvizëse në identifikimin e viktimave të mundshme.
- Të bashkëpunohet me aktorët e tjerë të shoqërisë civile, OJQ-të dhe kompanitë e TIK-ut (në mënyrë specifike me OSHI-të), sidomos në lidhje me njohuritë, informimin dhe bashkëndarjen e praktikave të mira.



▲ © Bahrudin Bandic

Të shtrihen më tej shërbimet dhe veprimtaritë e shoqërisë civile.

- Shërbimet duhet t'u vihen në dispozicion dhe të jenë të përdorshme nga të gjithë fëmijët, sidomos nga ata në zona rurale dhe në mjedise që janë sfiduese në aspektin ekonomik dhe shoqëror.
- T'i kushtohet vëmendje dhe të hartohet një qasje afatgjatë strategjike për adresimin e kësaj problematike, duke përfshirë realizimin e monitorimit dhe vlerësimit të projekteve dhe programeve të përfunduara.
- Të avokohet për rregullimin e masave mbrojtëse digjitale dhe përgjegjësitë midis palëve të interesuara në sektorët e tyre përkatës, duke përfshirë OSHI-të, prindërit, institucionet arsimore (si shkollat) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.
- Të mbështeten shtetet që kontribuojnë me staf në operacionet paqeruajtëse në krijimin e masave kundër SHSTF-së dhe hartimin e protokolleve të raportimit dhe në hetimin me saktësi dhe pa vonesë të pretendimeve për SHSTF-në.

Sektori privat

Ka një mungesë të pushtetit shtetëror për të detyruar kompanitë që të rregullojnë përgjegjësitë e tyre. Për pasojë, veprimi përmes politikave është i nevojshëm për të mbyllur hendeqet juridiksonale në kuadrot rregullatore. Vetërregullimi i sektorit privat respektohet në shkallë të ndryshme. Megjithatë, politikëbërësit ngrenë shqetësime që vetërregullimi, në vetvete, nuk është efikas, sepse ka pak mbikëqyrje ose zbatim

të angazhimeve vullnetare dhe parashikueshmëri të pamjaftueshme dhe bëjnë thirrje për kuadro të qarta rregullatore. Në sektorin e teknologjisë, megjithëse platformat e përzgjedhura të medieve sociale zbatojnë praktikën e vetërregullimit për të mbyllur hendekun midis juridiksioneve kombëtare që zgjedhin të mos ndërhyjnë në këtë fushë, roli i ndërmjetësve vazhdon të mbetet ndjeshëm i pa rregulluar në shumë kontekste. Edhe sektori i udhëtimeve dhe turizmit është i vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësinë e tij, edhe pse zbatimi i udhëzuesve për sektorët specifikë vazhdon të mbetet sfidë. Sektori privat duhet të ndalojë në mënyrë proaktive përdorimin e imazheve dhe mesazheve të seksualizuara në të cilat përfshihen fëmijë, në produktet dhe shërbimet e tyre. Këtu përfshihet vënia në dispozicion dhe promovimi i produkteve që kanë për qëllim seksualizimin e vajzave në moshë të hershme në revista, filma, lojëra kompjuterike, veshmbathje, lodra, makiazh dhe produkte të tjera që tregtohen edhe për të rritur, edhe për fëmijë. Më poshtë po paraqesim disa rekomandime të hollësishme për sektorët specifikë.

Rekomandime për industrinë e TIK-ut:

- Të përmirësohet regjimi i tyre i përgjegjësisë së kufizuar si ofrues të ndërmjetëm shërbimesh si dhe fusha e parregulluar e procedurave të njoftimit dhe heqjes së materialeve. Kompanitë e TIK-ut duhet të krijojnë protokolle dhe procedura dhe politika të qarta në lidhje me heqjen e materialeve të paligjshme ose të pahijshme nga platformat dhe shërbimet që ato ofrojnë.
- Të caktohet një urdhër për monitorimin dhe raportimin e përmbajtjes së paligjshme që transmetohet përmes rrjeteve të tyre, platformave dhe/ose pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.
- Të bashkëpunohet në mënyrë më proaktive me OJQ-të lokale, sidomos në lidhje me bashkëndarjen e njohurive, përvojës dhe informacioneve, rritjen e vetëdijesimit e punonjësve të TIK-ut, masave mbrojtëse dhe mekanizmave të mbrojtjes së viktimave.

Rekomandimet për industrinë e teknologjisë së informacionit:

- Të sigurohet që platformat në internet të kenë masa të përmirësuara sigurie dhe mbrojtjeje, të nxitet dhe ndihmohen shërbimet e referimit për sigurinë e fëmijëve dhe linjat e drejtpërdrejta të ndihmës.
- Të investohen burime për të siguruar një numër të mjaftueshëm moderatorësh njerëz për të monitoruar disa prej kategorive më të ndjeshme të përmbajtjeve, ku përfshihen materialet e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Rekomandimet për industrinë e udhëtimeve dhe turizmit:

- Të ngrihen kapacitetet dhe të ofrohen trajnime lidhur me SHSF-UT-në dhe SHSTF-në për operatorët turistikë.
- Të rritet angazhimi i operatorëve turistikë ndaj Kodit.
- Të hartohen protokolle operative për ruajtjen dhe identifikimin e viktimave dhe për raportimin e rasteve—këto të bëhen të detyrueshme.
- Të organizohen fushata mediatike, të krijojnë video, spote televizive, fletëpalosje, tabela të mëdha reklamash, etj. për t'i bërë të dukshme në ambientet turistike.
- Të përmirësohet bashkëpunimi me organet ligjzbatuese dhe me OJQ-të lokale, për shembull, duke krijuar një protokoll raportimi për të informuar policinë atëherë kur punonjësit hasin në sjellje jo të hijshme ose raste të dyshimta dhe duke u kërkuar OJQ-ve lokale që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit që të realizojnë trajnime për punonjësit.
- Të nxiten kompanitë ndërkombëtare, rajonale dhe kompanitë e mëdha që të ofrojnë mbështetjen e tyre dhe të bashkëndajnë përvojat dhe protokollat e tyre të ruajtjes dhe raportimit me kompanitë lokale e më të vogla brenda së njëjtës industri.



REKOMANDIME SPECIFIKE PËR VENDET

Një OJQ për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri, mbështet fëmijët që gjenden në rrugë, fëmijët viktimë të trafikimit, fëmijët në konflikt dhe të miturit e pashoqëruar. © Besart Cani

Shqipëria

Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve

- Të përmirësohen metodat e mbledhjes së të dhënave me qëllim që të kuptohen më mirë shkalla dhe fushëveprimi i SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia, gjë që do të mundësonte ndjekjen e qasjeve më të përqendruara te parandalimi dhe mbrojtja. Të vazhdohet hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave për të publikuar raporte statistikore kombëtare në lidhje me këtë temë.
- Të krijohen mekanizma formale të mbrojtjes dhe monitorimit, duke përfshirë skemat e regjistrimit për ndihmimin dhe identifikimin e fëmijëve viktime të mundshme, sidomos të fëmijëve të pashoqëruar, duke çuar kështu në pakësimin e rreziqeve të shfrytëzimit.
- Të përmirësohet mekanizmi koordinues për të përfshirë të gjitha subjektet përkatëse që punojnë në këtë fushë.
- Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të theksojë rolin e agjencive të ndryshme në reagimin ndaj nevojës në rritje për më shumë informacion, financim dhe ndërhyrje në lidhje me SHSTF-në.
- Të krijohen veprime afatshkurtër dhe afatgjata për parandalimin dhe mbrojtjen nga SHSTF-ja në planet kombëtare të veprimit dhe strategjitë kombëtare.
- Të angazhohen fëmijët, duke përfshirë edhe fëmijët viktime, në hartimin dhe procesin e zbatimit të planeve të ndryshme kombëtare të veprimit që prekin fëmijët dhe rininë.

SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia

- Të adresohet mungesa e një komponenti për SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia në planin kombëtar të veprimit.
- Të bashkëpunohet si partnerë me OSHI-të dhe kompanitë e TIK-ut për të monitoruar dhe rregulluar ekspozimin e pavullnetshëm të fëmijëve ndaj përmbajtjes seksuale në internet.
- Të hartohen procedura të qarta për bashkëpunimin midis institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm në lidhje me procesin e heqjes nga interneti të materialeve të paligjshme ose të pahijshme.
- T'u jepet përparësi politikave dhe fushatave për informimin e prindërve lidhur me sigurinë e fëmijëve në sferën digjitale.
- Të krijohet një mekanizëm koordinimi për të angazhuar të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë policinë dhe prokurorët, OSHI-të kryesore, Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe përfaqësuesit e sistemeve të drejtësisë dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

- Të rritet më tej bashkëpunimi i OSHI-ve me strukturat shtetërore dhe palët e tjera të interesuara në fushën e ofrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e hetimeve dhe vlerësimeve.

SHSF-UT

- Qeveria e Shqipërisë, sidomos ajo e nivelit lokal, duhet të hartojë plane veprimi dhe të marrë masa për mbrojtjen e fëmijëve nga SHSF-UT-ja. Një gjë e tillë është e rëndësishme sidomos kur turizmi të arrijë nivelet e larta që kishte para pandemisë.
- Agjencitë ligjzbatuese dhe operatorët turistikë duhet të informohen për SHSTF-në dhe për mënyrën se si t'i mbrojnë fëmijët që këta të mos shfrytëzohen.
- Duhet të ofrohen më shumë financime për të siguruar shërbime të përshtatshme të kujdesit ndaj fëmijëve, mbrojtje, edukim dhe gjëra të tjera të ndërlidhura me këto, në nivelin lokal.
- Të përmirësohet bashkëpunimi midis subjekteve lokale dhe qeverisë qendrore, sidomos në kuadër të "Strategjitë së re kombëtare për të drejtat e fëmijës 2021-2025".
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës duhet të sigurojë që të mbijetuarit e SHSTF-së të mbrohen dhe të përfitojnë shërbime të përshtatshme të kujdesit shoqëror në nivel lokal.
- Ministria e Turizmit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera përgjegjëse për mirëqenien e fëmijëve si Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme, duhet të punojë për zbatimin e një qasjeje të përbashkët (rritja e vetëdijesimit për operatorët e udhëtimeve dhe turizmit, politikat për fushatat informuese, etj.) në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit.

Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

- Të kryhen trajnime të shënjestruara për ngritjen e kapaciteteve për të ndihmuar në përmirësimin e efektivitetit të oficerëve të policisë, prokurorëve, gjyqtarëve dhe të gjithë aktorëve të ndërlidhur në këtë fushë.
- Të përmirësohet bashkëpunimi midis subjekteve të ndryshme që përfshihen në hetimin e rasteve dhe të sigurohen linja të komunikimit të drejtpërdrejtë midis oficerëve të policisë, prokurorëve dhe laboratorit të njësisë për hetimin e krimeve kompjuterike.
- Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të bashkëpunojnë ngushtë me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve për t'iu përgjigjur nevojave të të mbijetuarve të SHSTF-së. Për këtë arsye, duhet të ofrohen trajnime dhe seminare praktike (uorkshojet) për ngritjen e kapaciteteve me qëllim rritjen e nivelit të njohurive rreth këtyre dukurive dhe rreth mjeteve për mbështetjen e viktimave gjatë përgjigjes ndaj nevojës së tyre për mbrojtje.
- Të investohet në strukturën e laboratorit kombëtar të kibernetikës për vegla dhe mjete më të mira teknologjike të hetimit të rasteve.
- Ministria e Brendshme, përmes Akademisë së Policisë, duhet të krijojë dhe ofrojë trajnime të përshtatshme dhe të specializuara me qëllim ngritjen e kapacitetit për të gjithë oficerët përkatës.
- Të integrohen qasjet të ndjeshme ndaj fëmijëve dhe viktimave në masat e drejtësisë penale që merren si reagim ndaj veprave penale të SHSTF-së dhe SHSF-UT-së dhe veprave që lidhen me SHSTF-në. Qëllimi i këtyre qasjeve duhet të jetë parandalimi i viktimizimit dhe traumatizimit të sërishëm të fëmijës.
- Të sigurohet që hetuesit kombëtar të jenë të pajisur dhe të trajnohen si duhet për të menaxhuar rastet që kanë të bëjnë me SHSTF-në, p.sh. të kenë përvojë të mëparshme me punën me fëmijët dhe me trajtimin e krimeve me natyrë seksuale, etj.

Shoqëria civile, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

- Të mundësohet pjesëmarrja e fëmijëve dhe rinisë në fushatat e rritjes së vetëdijesimit dhe në shpërndarjen e informacioneve lidhur me këtë problematikë, me qëllim që të përmirësohet efektiviteti i përpjekjeve të shënjestruara për parandalimin e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe SHSTF-së dhe për reagimet për mbrojtje ndaj këtyre.
- Rritja e vetëdijesimit të fëmijëve dhe prindërve, kujdestarëve dhe profesionistëve në lidhje me SHSTF-në dhe manifestimet e saj, duke përfshirë këtu edhe SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia, dhe në lidhje me mekanizmat e raportimit për të informuar organet e zbatimit të ligjit kur ka dyshime për raste SHSTF-je ose kur raste të tilla kanë ndodhur.
- Të informohen prindërit, dhënësit e kujdesit, kujdestarët dhe profesionistët e tjerë rreth kurrikulës së rishikuar të TIK-ut, të prezantuar në shkollat publike, e cila do të përmbajë udhëzime për sigurinë në internet të fëmijëve të shkollave nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë.
- Të sigurohet që fëmijëve që kanë përjetuar ndonjë manifestim të SHSTF-së t'u jepen shërbime të përshtatshme për t'u mundësuar që të rimëkëmben në mënyrë të plotë dhe të riintegrohen në komunitetet e tyre.
- Të përforcohet aftësia e komuniteteve për të kontrolluar dhe mbrojtur fëmijët në internet dhe të informohen ata më tej në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet e mundshme të sferës digjitale.
- Të ngrihen kapacitetet dhe të përmirësohet qëndrueshmëria e fëmijëve nëpërmjet sistemeve të mbështetjes nga bashkëmoshatarët dhe programeve të arsimit.

Sektori privat

- OSHI-të dhe kompanitë e TIK-ut duhet të përmirësojnë regjimin e përgjegjësive të kufizuara si ofrues ndërmjetës të shërbimeve dhe të krijojnë procedura për identifikimin, njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme të SHSTF-së.

Bosnja dhe Hercegovina

Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve

- Të krijohen programe dhe struktura efikase sociale për të siguruar mbështetjen e nevojshme për viktimat, të afërmit e tyre të afërt dhe kujdestarët. Në kuadër të këtyre programeve duhet të sigurohet mbrojtja e të dhënave personale të viktimave dhe të ofrohet mbështetje e përshtatshme për viktimat dhe fëmijët në rrezik.
- Të përforcohen mekanizmat e linjave telefonike të ndihmës dhe të linjave telefonike të drejtpërdrejta për raportimin e përmbajtjes së pahijshme dhe për mbështetjen e viktimave, duke siguruar anonimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të viktimave.
- Të rritet vetëdijesimi për problematikën me mbrojtjen e fëmijëve dhe për të drejtat e fëmijëve, në radhët e punonjësve që kanë kontakt të rregullt me fëmijët në sektorin e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe policisë, sidomos në fushat që kanë të bëjnë me veprimtari sportive, kulturore dhe argëtuese. Të pajisen këta profesionistë me njohuri rreth SHSTF-së, mënyrave për ta identifikuar dhe raportuar atë të shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe rreth mënyrave se si të shquajnë situatat ku kanë dyshime të bazuara për të besuar se fëmija është viktimë e SHSTF-së.
- Të përmirësohet bashkëpunimi midis qeverive dhe OJQ-ve në drejtim të parandalimit të SHSTF-së. OJQ-të duhet të shihen si partnere dhe jo si ofrues shërbimi.
- Të ndiqen dhe zbatohen praktikët e mira nga vendet e tjera të rajonit dhe të botës.
- Të përmirësohet bashkëpunimi rajonal në luftën kundër SHSTF-së dhe manifestimeve të saj, sidomos në lidhje me: zbatimin e instrumenteve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare kundër SHSTF-së, mbrojtjen dhe ndihmesën ndaj

viktimave, hetimet ose procedurat gjyqësore të ndërlidhura me veprat penale të SHSTF-së dhe format e tjera të dhunës kundër fëmijëve në mjedisin digjital.

- Të nxitet dhe përkrahet bashkëpunimi midis autoriteteve shtetërore kompetente, shoqërisë civile dhe sektorit privat për të parandaluar dhe luftuar më mirë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve.

Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

- Të krijohet një organ i specializuar i ngarkuar me detyrën e përpunimit të krimeve të mundësuar nga teknologjia, duke përfshirë edhe SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia.
- Të rritet numri i prokurorëve të specializuar me ekipe bashkëpunëtorësh për të trajtuar krimet specifike të SHSTF-së. Profesionistët e certifikuar duhet të trajnohen lidhur me përpunimin e kësaj vepre penale dhe të tregohen të ndjeshëm ndaj trajtimit të viktimave, për të rritur numrin e rasteve të identifikuar dhe të ndjekura penalisht. Ata do të shërbenin si pika e parë e kontaktit për veprat penale të SHSTF-së.
- Të edukohen dhe trajnohen gjykatës, prokurorë dhe avokatë në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve.
- Të adresohet mungesa e zyrtarëve profesionistë dhe e personelit të ngarkuar me detyrën e zbulimit, hetimit dhe përpunimit të rasteve të SHSTF-së, për shkak të emërimit politik të personelit të papërshtatshëm në agjencitë prokuroriale dhe ligjzbatuese.
- Të rritet niveli i njohurive dhe të ofrohen trajnime dhe arsim i specializuar për oficerët e policisë, prokurorët dhe gjykatësit, në lidhje me përpunimin e krimeve digjitale, sidomos në akademitë e policisë dhe në qendrat për edukimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- Të merren masat e nevojshme për të siguruar që hetimet dhe procedurat penale të realizohen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij, duke përfshirë ndjekjen e një qasjeje mbrojtëse ndaj viktimave, duke siguruar që hetimet dhe procedurat penale të mos përkeqësojnë traumën e fëmijës dhe që reagimet e drejtësisë penale, aty ku është e përshtatshme, të përcillen me dhënie ndihme.
- Të përkufizohet termi "viktimë" në legjislacionin kombëtar.
- Të sigurohet që të drejtat dhe interesat e viktimave të mbrohen në çdo kohë, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e procedurës hetimore dhe penale. Viktimat duhet të kenë qasje tek autoritet kompetente dhe të jenë të informuara lidhur me procedurat gjyqësore dhe administrative të rastit të tyre dhe t'u jepet ndihmë ligjore falas dhe përfaqësim ligjor në procedurat gjyqësore.

Shoqëria civile, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

- Përmbytja e detyrueshme që ka të bëjë me sigurinë e fëmijëve në mjedisin digjital duhet të bëhet pjesë e studimeve të TIK-ut dhe kurrikulave shkollore.
- Të edukohen fëmijët e të gjitha moshave rreth të gjitha formave të dhunës dhe abuzimit kundër fëmijëve, si në jetën reale, ashtu edhe në sferën virtuale.
- Të caktohen buxhete për të financuar veprimtaritë dhe mekanizmat për parandalimin e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia, siç është Qendra për Internet më të Sigurt.

Spektori privat

- Media, sidomos media në internet dhe profesionistët, duhet të edukohet dhe trajnohet për të ofruar informacione të përshtatshme në lidhje me të gjitha format e SHSTF-së, duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë së viktimave.

KOSOVA

Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve

- Të përmirësohet bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve në përputhje me standardet më të fundit normative ndërkombëtare.
- Të ngrihen më tej kapacitetet dhe palëve të interesuara dhe specializimi i tyre në drejtim të adresimit të SHSTF-së dhe manifestimeve të saj.
- Të përmirësohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar me aktorët e tjerë shtetërore në funksion të shkëmbimit të informacioneve dhe praktikave të mira.
- Të realizohen fushata për ngritjen e vetëdijesimit me qëllim që të informohen palët e interesuara në lidhje me SHSTF-në dhe rreziqet që vijnë si rezultat i veprimtarive të fëmijëve në internet.
- Të informohet publiku i gjerë për legjislacionin e ndërlidhur me SHSTF-në, mekanizmat e raportimit dhe pasojat që vuajnë viktimat në jetën e tyre.
- Të edukohen fëmijët për rreziqet reale dhe të mundshme të botës digjitale.
- Të zhvillohen masat parandaluese dhe mekanizmat e monitorimit në qendrat lokale të internetit (internet kafe).
- Të themelohen dhe financohen qendra dhe institute që mbledhin të dhëna dhe realizojnë hulumtime shkencore në lidhje me këtë problematikë.
- Të bëhen investime në mjetet e filtrimit për të identifikuar, rregulluar, bllokuar dhe hequr nga interneti materialet e paligjshme të SHSTF-së. Shembull për këtë është Qendra Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri, e cila në vitin 2020 mbylli 74 faqe interneti që kishin të bënin me SHSTF-në.
- Të përmirësohen linjat e drejtpërdrejta telefonike kombëtare, sidomos ato për raportimin e materialeve të paligjshme të SHSTF-së në internet.
- Të fuqizohet bashkëpunimi institucional në nivelin kombëtar dhe lokal.
- Të krijohet një plan kombëtar veprimi për mbrojtjen e fëmijëve, ku të përfshihen veprime për adresimin e veprimtarive dhe cenueshmërisë së fëmijëve në internet.

Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

- Të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin privat, sidomos me OSHI-të dhe kompanitë e TIK-ut, në luftën kundër SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.
- T'u ofrohen trajnime të specializuara gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë, rreth SHSTF-së, sidomos në lidhje me menaxhimin e rasteve të SHSTF-së, mjekësisë ligjore digjitale dhe mbrojtjes së fëmijëve viktimë.

Shoqëria civile, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

- Të trajnohen gazetarët dhe reporterët rreth çështjeve që lidhen me SHSTF-në, me qëllim që të përmirësojnë punën dhe standardet etike të medieve.

Sektori privat

- Të përmirësohet bashkëpunimi me agjencitë e zbatimit të ligjit në luftën kundër SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.
- Operatorët turistikë dhe kompanitë e hotelarisë me seli në Kosovë duhet të rrisin angazhimin e tyre ndaj Kodit, një nismë kjo ku përfshihen shumë palë të interesuara me qëllim rritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve për identifikimin, raportimin dhe parandalimin e SHSTF-së në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit.

MALI I ZI

Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve

- Të përcaktohen masa të veçanta për mbrojtjen e grupeve të cenueshme, ku përfshihen fëmijët romë dhe ata emigrantë.
- Të zhvillohen mekanizma për identifikimin e viktimave.
- Të krijohet një bashkëpunim i përhershëm me shërbimet e tjera të sigurisë dhe të ndiqet një qasje shumëdisiplinore në parandalimin, edukimin dhe trajtimin, mbajtjen e regjistrimeve të përshtatshme në këtë fushë dhe qarkullimin e informacioneve midis shërbimeve.
- Të përforcohen reagimet ndaj SHSTF-së, duke përfshirë këtu edhe SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia, në nivel komunal nëpërmjet ekipeve lokale shumëdisiplinore.
- Të zhvillohen shërbime të specializuara të dedikuara vetëm ndaj fëmijëve, për akomodim, ndihmë psikosociale dhe ndihmë ligjore, mjekësi ligjore dhe për çdo ndihmë tjetër të mëtejshme.
- T'i jepet përparësi dhe të përmirësohet integrimi i sërishëm i viktimave dhe monitorimi i viktimave të mundshme.
- Të përfshihen të gjitha palët e interesuara në zhvillimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të një baze të përbashkët të dhënash për rastet e raportuara të SHSTF-së, duke u përqendruar te mbrojtja e të dhënave dhe privatësia e viktimave.
- Të zhvillohen grupet e treguesve që mundësojnë monitorimin dhe analizimin sistematik, duke përfshirë identifikimin e treguesve të cenueshmërisë dhe të rreziqeve të SHSTF-së.
- Të përgatiten plane lokale veprimi dhe të hiqen mënjatë burime për të punuar me kategoritë e përfituesve.
- Të përfshihen përfaqësuesit ligjore për të ofruar ndihmë ligjore në rregullimin e statusit ligjor të fëmijëve emigrantë.
- Të përmirësohet bashkëpunimi i të gjitha organeve dhe institucioneve të ndërlidhura me këtë dukuri, organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare dhe OSHC-ve, duke përcaktuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë dhe duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.
- Të kryhen hulumtime shkencore për të shqyrtuar dhe monitoruar vetëdijen e publikut dhe opinionin publik lidhur me SHSTF-në, duke përfshirë këtu edhe SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia dhe veprimtaritë dhe cenueshmërinë e fëmijëve në internet.
- Të hartohen hulumtime shkencore/masa parandaluese të mbështetura në prova, duke përfshirë masat kundër diskriminimit dhe stigmatizimit social të të mbijetuarve të SHSTF-së.
- Të mbështeten programet arsimore në shkollë dhe komunitet (formale dhe joformale) që përqendrohen te zhvillimi i programeve parandaluese në drejtim të njohjes së shkaqeve dhe faktorëve të rrezikut.
- Parandalimi të bëhet konsistent dhe të shtrihet përtej programeve me bazë projektesh, të drejtuara vetëm nga OJQ-të.
- Të pajisjen OSHC-të me shërbime dhe mbështetje të specializuara.

Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

- Të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme zbatimi i kuadrit ligjor dhe të përcaktohen hendeqet që duhet të adresohen me anë të ndryshimeve në ligj.
- Të përmirësohet zbatimi i politikave dhe legjislacionit përkatës.
- Të vazhdohet të punohet për identifikimin e rasteve të SHSTF-së dhe të krijohen ekipe në nivelin lokal.
- Të ndiqen penalisht rastet e raportuara në përputhje me nenet përkatëse të kodit penal.

- Të hartohen standarde për mirësjelljen brenda dhe midis autoriteteve kompetente në kuadër të rasteve të SHSTF-së, gjë që do t'i bënte autoritetet dhe shërbimet përgjegjëse edhe më shumë përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme në kuadër të kompetencave të tyre në drejtim të ndihmimit të fëmijëve.
- Të vendoset dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal me agjencitë e tjera policore dhe prokuroritë, për ta monitoruar dhe luftuar SHSTF-në në mënyrë efektive.
- Të trajnohen oficerët e policisë dhe personeli përkatës lidhur me identifikimin e autorëve të krimit dhe viktimave të mundshme.
- Të përfshihen të gjitha palët e interesuara në përpjekjet për të mbështetur identifikimin dhe raportimin e rasteve.
- Të hartohen dhe ofrohen programe trajnimi lidhur me punën me grupet e fëmijëve të cenueshëm.
- Të realizohen trajnime të përbashkëta për të gjithë aktorët përkatës, në nivel komunal, për t'i njohur ata me përgjegjësitë e njëri-tjetrit.
- Të rritet vetëdijesimi brenda institucioneve shtetërore dhe departamenteve përkatëse që janë përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes dhe qasjes të drejtat, në nivel kombëtar dhe lokal.
- Të realizohen trajnime të rregullta të përbashkëta midis zyrtarëve policorë në detyrë, sidomos midis zyrtarëve të policisë kufitare, zyrtarëve të aeroportit dhe përfaqësuesve të organeve të kundërvajtjeve, për të rritur njohuritë lidhur me standardet ndërkombëtare të së drejtës humanitare dhe për të pranuar nevojën për mbrojtjen e grupeve të ekspozuara ndaj rrezikut.
- Të organizohen ekipe speciale ku të përfshihen OSHC-të e drejtuara nga romët, në zbulimin dhe parandalimin e lypjes së detyruar dhe të martesave të hershme ose të detyruara.
- T'i jepet përparësi identifikimit të fëmijëve të pashoqëruar dhe emigrantë dhe mbështetjes ndaj tyre.

Shoqëria civile, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

- Të ngrihen më tej kapacitetet e OSHC-ve me qëllim që shërbimet e tyre të licencohen.
- Të analizohet rregullorja për licencimin e shërbimeve, në lidhje me licencimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët.
- Të ndiqet një qasje pjesëmarrëse për të krijuar shërbime që shërbejnë për të mbështetur fëmijët që kanë mbrojtje të miratuar.
- Të caktohen burime financiare për ofrimin e shërbimeve nga OSHC-të për të gjithë përfituesit në sistemin e mbështetjes së fëmijëve.
- Të promovohen shërbimet që ofrohen nga OSHC-të.
- Të sigurohet që grupet e cenueshme të kenë qasje, brenda afateve të arsyeshme, në shërbimet e OSHC-ve.
- Të përmirësohet bashkëpunimi me OSHC-të e tjera, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare në vend dhe në rajon.

Sektori privat

- Të hartohen protokolle të përshtatshme dhe të detyrueshme veprimi, me qëllim identifikimin dhe raportimin e rasteve të SHSTF-së në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit (hotele, akomodim privat, kompani private, agjenci, etj.)
- Të trajnohen punonjësit që punojnë në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit lidhur me protokollet dhe masat parandaluese.
- Të organizohen fushata mediatike për ngritjen e vetëdijesimit, të krijohen video, fletëpalosje, tabela të mëdha reklamash, etj. Këto duhet të vihen aty ku shihen lehtësisht në ambientet turistike.
- Të fuqizohet bashkëpunimi me policinë dhe me inspektorët e punës.

MAQEDONIA E VERIUT

Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve

- Të fuqizohet asistenca për riintegrimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktime.
- Të përmirësohen trajnimet, bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi lidhur me rolin e secilit prej institucioneve kompetente dhe të sigurohet monitorimi i përshtatshëm i reagimit institucional ndaj rasteve të SHSTF-së.
- T'i jepet përparësi zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive të miratuara në lidhje me të drejtat e fëmijëve.
- Të hartohet një strategji kombëtare për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
- Të krijohet një qasje strategjike dhe një plan për zhvillimin profesional të personelit të institucioneve të ndryshme, të cilat janë pjesë e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.
- Të kryhet një vlerësim i nevojave për trajnim dhe të krijohen plane vjetore të veçanta për zhvillimin profesional të të gjitha palëve përkatëse të interesuara, të cilat përfshihen në sistemin e parandalimit dhe mbrojtjes.
- Të rishikohet organi ligjor i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e fëmijës".
- Të zbatohen rekomandimet "GRETA", duke përfshirë ofrimin e masave të përshtatshme të asistencës, siç është akomodimi, dhe identifikimi i përshtatshëm i meshkujve viktime të trafikimit të qenieve njerëzore.
- T'i jepet përparësi identifikimit dhe ndjekjes penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të SHSTF-së në vend që të rritet vëmendja ndaj problematikës së kontrabandimit të emigrantëve.
- Të rriten përpjekjet për të konfiskuar asetet dhe të ardhurat nga krimi, të fituara përmes veprave kriminale të ndërlidhura me SHSTF-në.
- Të krijohet një kuadër i fuqishëm monitorimi, duke përfshirë qasjen e publikut në mekanizmat e pavarur të ankesave.
- Të përmirësohet mbështetja dhe shërbimet që u drejtohen fëmijëve emigrantë dhe atyre që janë kthyer si azilkërkues të pasuksesshëm, si dhe për rininë LGBT, sepse edhe këta janë grup tepër i rrezikuar.
- Të ndryshohet baza aktuale statistikore për të bërë të mundur planifikimin e shërbimeve të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe monitorimin e të gjitha grupeve që janë në rrezik të madh.
- Të krijohen programe speciale të asistencës dhe të merren masa që kanë për objektiv fëmijët romë, në bashkëpunim me familjet dhe komunitete romë.
- T'u ofrohet qasje në strehim të gjitha viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të SHSTF-së, pavarësisht statusit të tyre ligjor ose rezidencial. Në rast se kjo nuk është e mundur dhe viktimat kombëtare të huaja, që janë duke qëndruar në vend në mënyrë të paligjshme, vendosen nga Ministria e Brendshme, Njësia për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandimit të Emigrantëve në Qendrën e Pritjes për Shtetasit e Huaj, atëherë punonjësit në qendrën e pritjes duhet të trajnohen si duhet për t'u ofruar ndihmë dhe mbështetje viktimave.
- Të prezantohet dhe/ose përforcohen programet e riintegrimin në strehimore dhe në Qendrën e Pritjes për Shtetasit e Huaj, me qëllim që të mbijetuarit të mund të pajisjen më mirë për t'u riintegruar me sukses në shoqëri.
- Të shtohen fondet për organizatat e shoqërisë civile që merren me veprimtari parandaluese dhe që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të dhunës seksuale.
- Të përfshihen fëmijët dhe të rinjtë e të rejtat në debatin publik rreth rreziqeve në internet, sigurisë digjitale dhe mundësive që ofron fusha kibernetike.
- Të garantohet disponueshmëria e shërbimeve të përshtatshme të përkrahjes për personat që përfshihen në lëndim në internet dhe që fëmijët të jenë të informuar për mënyrën se si mund t'i përdorin këto shërbime.

Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

- Të rriten përpjekjet për zbulimin dhe zgjidhjen e rasteve të SHSTF-së dhe të merren masa të përshtatshme për ndjekjen penale të autorëve të krimit.
- Të caktohen fonde të mjaftueshme për zbatimin e strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për uljen e numrit të SHSTF-së.
- Komiteti kombëtar duhet të rishikojë dhe përmirësojë qasje aktuale dhe sistemin për mbledhjen e të dhënave dhe ta bëjë publik informacionin që mund të përdoret për të gjurmuar ecurinë që vendi ka bërë në drejtim të adresimit të SHSTF-së. Gjithashtu, të merret parasysh edhe rritja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies.
- Të ngrihen më tej kapacitetet për sektorin për hetimin e krimeve kibernetike pranë Ministrisë së Brendshme dhe të krijohet një mjedis nxënies ku nxitet kuptimi i mëtejshëm dhe fitimi i njohurive rreth SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.
- Të vazhdohet monitorimi i përmbajtjes në internet, trajnimet për aftësitë digjitale dhe preferencat dhe politikat e medie sociale, me qëllim që të ngrihet kapaciteti për zbulimin e hershëm dhe parandalimin e SHSTF-së të mundësuar nga teknologjia dhe të shpërndarjes së përmbajtjes së paligjshme përmes internetit.
- Të ngrihet kapaciteti për masat e parandalimit të hershëm, të zbatohen praktikatat e mira nga aktivitetet e ekipeve lëvizëse dhe të sigurohet mbështetje financiare institucionale për punën e tyre të vazhdueshme.
- Të fuqizohet mbështetja për komisionin, punonjësit socialë, policinë dhe personelin shëndetësor.
- T'i jepet përparësi trajnimit të personelit që punon në sistemin e parandalimit lidhur me fëmijët.
- Të zbatohen udhëzimet për politikëbërësit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në internet nga ITU-ja.¹⁹⁶

Shoqëria civile, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

- Të mobilizohen burimet për vazhdimin e punës së suksesshme të ekipeve lëvizëse, të cilat ofrojnë mekanizma efektivë për identifikimin e viktimave të mundshme të SHSTF-së.
- Të rritet vetëdijesimi i rinisë rreth SHSTF-së.
- Të promovohen mekanizmat e raportimit të publiku i gjerë: rastet e dyshuara të SHSTF-së duhet t'i raportohen Ministrisë së Brendshme në numrin e urgjencave të policisë (192), linjës së drejtpërdrejtë telefonike të THB-së (0800 111 11) ose në aplikacionin në internet: redbutton.mvr.gov.mk.
- Të promovohen dhe t'u jepet përparësi mekanizmave parandalues, siç është përdorimi i hashtagut "#blockcybertrafficking" (bllokim trafikimit që ndodh përmes hapësirës kibernetike) dhe krijimi i një linje telefonike aktive të drejtpërdrejtë për rritjen e vetëdijesimit dhe ngritjen e kapacitetit për raportim.
- Të hartohen materiale edukative për prindërit, mësuesit dhe punonjësit socialë.
- Të përditësohet hartëzimi i infrastrukturës aktuale (institucionet dhe organizatat) që merret me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe punon me fëmijët viktime.
- Të bashkëpunohet me sektorin privat, sidomos me kompanitë e hotelierisë, agjencitë e udhëtimeve, hotelet lokale dhe kompanitë e TIK-ut.

Sektori privat

- Të hartohen programe trajnimi të koordinuara për punonjësit në sektorin publik.
- Të krijohet një kulturë rajonale kibernetike dhe një portal vetëdijesimi të të gjithë sektorët e ndryshëm të shoqërisë, për të bërë të mundur rritjen e vetëdijesimit dhe të reagimeve më të shpejta ndaj peizazhit të sigurisë kibernetike, i cili është në ndryshim të vazhdueshëm.
- Të ndihmohen palët e tjera të interesuara në aspektin e identifikimit të grupeve të cënueshme dhe sjelljes me rrezik të lartë të publiku, sidomos të fëmijët dhe

gratë, me qëllim që të nxirren të dhëna mbi të cilat mund të mbështeten fushatat e shënjestruara dhe të koordinuara të rritjes së vetëdijesimit.

- Të bashkëpunohet me OJQ-të në hartimin e programeve parandaluese dhe në mbështetjen e përpjekjeve ekzistuese në luftën kundër SHSTF-së.
- Të nxiten masat e disponueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe për t'u mundësuar përdoruesve të marrin vendime të informuara lidhur me atë se kur dhe si i bashkëndajnë informacionet e tyre personale në internet.
- Të zhvillohet një mekanizëm bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (MASIT), i cili mund të shtojë vlerë dhe ndikim në drejtim të zhvillimit të mbështetjes për rritjen e vetëdijesimit, zbulimin dhe raportimin e viktimave të mundshme të SHSTF-së.¹⁹⁷
- T'u jepet përparësi trajnimeve për zbulimin e hershëm dhe shquarjen e viktimave të mundshme të SHSTF-së.
- Të fuqizohet bashkëpunimi midis njësive të telekomunikimit dhe organeve të zbatimit të ligjit.

SERBIA

Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve

- Të përfshihen në kurrikulat shkollore, si tema të detyrueshme, SHSTF-ja dhe manifestimeve të saj, si SHSTF-ja që mundësohet nga teknologjia dhe SHSTF-ja në industrinë e hotelierisë.

Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale

- Të caktohet buxhet i veçantë për luftimin e SHSTF-së dhe manifestimeve të saj, sidomos të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia.
- Të vazhdojnë trajnimet për përfaqësuesit e organeve të zbatimit të ligjit dhe për ata të gjyqësorit.
- Të fillojë nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis vendeve në rajon në lidhje me SHSTF-në.
- Të kapërcehen pengesat ligjore dhe administrative në përdorimin e platformave të disponueshme për adresimin e SHSTF-së dhe mbështetjen e hetimeve (p.sh. "Better Internet for Kids": "Internet më i mirë për fëmijët").
- Të fuqizohen burimet njerëzore të organeve të zbatimit të ligjit, sistemit gjyqësor dhe të ofruesve të shërbimeve për të parandaluar shterimin e energjive ("burnout"-in) e personelit që trajton rastet e SHSTF-së.
- Të nxitet shkëmbimi i informacioneve dhe përvojave midis profesionistëve në vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë.
- Të organizohen takime dhe trajnime për përfaqësuesit e organeve të zbatimit të ligjit dhe ata të prokurorisë në nivelin kombëtar dhe rajonal.

Shoqëria civile, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

- Të ngrihen kapacitetet e OSHC-ve serbe në lidhje me SHSTF-në.
- Të krijohen dhe mbështeten shërbimet dhe programet e riintegritimit për viktimat e SHSTF-së.
- Shërbimet duhet të vihen në dispozicion të të gjithë fëmijëve, sidomos për ata që jetojnë në mjedise rurale dhe të prapambetura nga ana ekonomike dhe shoqërore.
- Të përfshihen fëmijët në zhvillimin e shërbimeve dhe të masave parandaluese.
- Të hartohen programe parandaluese për prindërit lidhur me SHSTF-në, sidomos për SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia dhe për rreziqet që u kanosen fëmijëve në sferën digjitale.
- Të përshtaten veprimtaritë parandaluese për të shënjestruar gjuhën dhe mjetet e teknologjisë informative që fëmijët përdorin më së shpeshti.

- Të përmirësohen kapacitetet e medie dhe të nxiten mediet për të raportuar lidhur me rastet e SHSTF-së, në përputhje me kodin e mirësjelljes.

Sektori privat

- Të nxitet angazhimi ndaj Kodit kundër SHSTF-së në sektorët e hotelarisë dhe të TIK-ut.
- Të ngrihet kapaciteti dhe të zbatohen veprimtari parandaluese në kuadër të luftës kundër SHSTF-së në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit dhe në sektorin e TIK-ut.
- Të bëhen transparente procedurat e identifikimit dhe të raportimit.
- Të përfshihen përfaqësuesit e sektorit privat në mekanizmat kombëtarë të referimit dhe në zbatimin e procedurave ekzistuese standarde të veprimit.

▼ Vende shfrytëzimi në Shqipëri. © Besart Cani



MATRICA E REKOMANDIMEVE

	Të përgjithshme	SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia	SHSF-UT	Romët
Kuadri ligjor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të ratifikohen ose të bëhet anëtarësimi në konventat përkatëse, protokollet dhe instrumentet rajonale dhe të zbatohen detyrimet që dalin nga dokumentet ndërkombëtare dhe konventat. 2. Të njihet SHSTF-ja në mënyrë të qartë, duke përfshirë SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia, në dokumentet strategjike. 3. Të harmonizohet legjislacioni kombëtar me legjislacionin ndërkombëtar dhe rajonal, konventat dhe protokollet e nënshkruara dhe të harmonizohen përkufizimet në ligje dhe dokumente strategjike të ndryshme. 4. Të miratohet legjislacioni kombëtar me të cilin ndalohet, parandalohet dhe reagohej ndaj SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe SHSTF-së në të gjitha manifestimet e saj, dhe të hartohen akte nënligjore, rregullore dhe procedura. 5. Të harmonizohet legjislacioni që ka të bëjë me veprat penale të SHSTF-së dhe SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe me sjelljen e qëllim të: krijimin, ofrimin ose vënien në dispozicion, shpërndarjen ose transmetimin, blerjen e MASF-së për veten ose për një person tjetër, posedimin e MASF-së, qasjen e vetëdijshme në MASF përmes TIK-ut. 6. Udhërrëfyesit terminologjikë për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual duhet të përdoren si parime udhëzuese. 7. Të përfshihet dhe përkufizohet SHSTF-ja, duke përfshirë SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia, si krime të veçuara brenda kodit penal. 8. Të rishikohet përkufizimi i "fëmijës" në kuadrin e kodit penal dhe të harmonizohet me kushtetutën, ligjin për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve dhe ligjin për familjen, si dhe me KDF-në. 9. Të rritet mosha e dhënies së pëlqimit për marrëdhënie seksuale të ligjshme. 10. Të shqyrtohen përsëri përjashtimet që i referohen martesës së mundshme përpara moshës së pjekurisë, nga mosha 16 vjeçare. 11. Të nxitet një qasje miqësore ndaj fëmijëve në kuadrin legjislativ dhe në praktikë. 12. Të miratohet një ligj për kompensimin monetar për viktimat e veprave penale në kuadër të legjislacionit dhe të gjenden burime për zbatimin e tij. 13. Të përfshihet pjesëmarrja e qëllimshme në abuzimin seksual ku janë të përfshirë fëmijët si vepër penale në kodin penal. 14. Kodi penal duhet të parashikojë si rrethanë rënduese faktin që autori, qoftë me vetëdije ose nga pakujdesia, ka vënë në rrezik jetën e fëmijës ose që krimi ka përfshirë dhunë të rëndë ose i ka shkakuar fëmijës rrezik kritik. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të miratohet një përkufizim formal i "materialit të abuzimit seksual të fëmijës" dhe të kriminalizohen format e tjera të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet, siç janë krijimi i kontaktit or joshja ("grooming") dhe zhvatja seksuale ("sextortion"). 2. Termi "pornografi me fëmijë" duhet të zëvendësohet me termin "material abuzimi seksual i fëmijës". 3. Termi "pornografi me fëmijë" në kodin penal duhet të përkufizohet për të siguruar dekriminalizimin e imazheve seksuale të krijuara vetë nga fëmija, që posedohen nga ky i fundit, me pëlqimin e tij dhe vetëm për përdorimin privat të tij. 4. Legjislacioni duhet të shqyrtohet herë pas here për shkak të natyrës evoluese të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia. 		<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përcaktohen masa të veçanta për mbrojtjen e grupeve të cënueshme, ku përfshihen fëmijët romë dhe ata emigrantë.

	Të përgjithshme	SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia	SHSF-UT	Romët
Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përmirësohet mekanizmi i koordinimit midis agjencive, për të përfshirë të gjitha subjektet përkatëse, duke theksuar rolin e agjencive të ndryshme për më shumë informacione, financime dhe ndërhyrje në lidhje me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve. 2. Të sigurohet pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe OJQ-ve në procesin e hartimit të politikave dhe të vendimmarrjes. 3. Të zhvillohen mekanizma për të lidhur strategjitë përkatëse kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, trafikimin e qenieve njerëzore, edukimin, përfshirjen sociale, etj. 4. Të hartohet një strategji kombëtare për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të krijohet me ligj një organ që do të ngarkohet me mbikëqyrjen e zbatimit të KDF-së, i koordinuar në nivel lokal dhe qendror dhe të ofrohen në mënyrë të mjaftueshme dhe si duhet shërbime të kujdesit social në nivelin lokal. 5. Bashkëpunimi midis qeverive dhe OJQ-ve/organizatave (vendase, rajonale dhe ndërkombëtare) duhet të përmirësohet në fushën e parandalimit, duke përkufizuar qartë përgjegjësitë dhe duke nënshkruar marrëveshje (memorandume) bashkëpunimi. 6. Të nisë nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis vendeve në rajon në lidhje me SHSTF-në dhe sidomos në lidhje me SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia. 7. Të hapen dhe të financohen qendra dhe institute kërkimore që mbledhin të dhëna dhe të mbështeten metodat e mbledhjes së të dhënave, duke mundësuar në këtë mënyrë ndjekjen e qasjeve më të shënjestruara lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen. 8. Të gjitha palët e interesuara duhet të përfshihen në përditësimin e të dhënave në një bazë të unifikuar të dhënash me një grup të zhvilluar treguesish që mundësojnë monitorimin dhe bërjen e analizave dhe të bashkëndajnë informacione të rëndësishme, ku të përfshihet edhe ofrimi i të dhënave publike. 9. Të identifikohet një subjekt si "kujdestar/pronar" i bazës së unifikuar të të dhënave dhe si pikë e parë kontakti për qasjen në të dhëna (metadata). Për kërkesat ndërkombëtare, INTERPOL-i duhet të jetë pika e parë e kontaktit. 10. Të zhvillohet një sistem numrash unik çështjesh për të gjitha organet e përfshira, me qëllim shmangien e regjistrimeve të dyfishta. 11. Të kryhen kërkime të mëtejshme për të ofruar raporte statistikore kombëtare lidhur me këtë dukuri. 12. Të hartohen plane kombëtare të veprimit (PKV) dhe strategji për SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia dhe SHSTF-në, të cilat duhet të jenë veprime të përcaktuara që kanë për qëllim parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre në terma afatshkurtër dhe afatgjatë. 13. Të krijohet mekanizma formale të mbrojtjes dhe monitorimit, duke përfshirë skemat e regjistrimit për ndihmën dhe identifikimin dhe monitorimin, dhe sisteme monitorimi për zbulimin e fëmijëve viktime të mundshme të SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe SHSTF-së, sidomos të fëmijëve të pashoqëruar, me qëllim uljen e rrezikut ndaj shfrytëzimit. 14. Të zhvillohen mekanizma për identifikimin e viktimave dhe për njohjen dhe trajtimin e viktimave të shfrytëzimit seksual tregtar si të tilla. 15. Mekanizmat e linjave të ndihmës dhe të linjave telefonike të drejtpërdrejta për raportimin e përmbajtjes së pahijshme dhe për përkrahjen e viktimave duket të fuqizohen dhe mbështeten financiarisht nga qeveria, duke siguruar anonimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të viktimave. 16. Të garantohet që asistencë ndaj viktimave, p.sh. akomodimi, ndihma psikosociale, ligjore dhe mjekoligjore, dhe çdo ndihmë e mëtejshme, t'u përshtatet nevojave të fëmijëve për t'u mundësuar atyre të rikuperohen plotësisht dhe të riintegrohen në komunitetet e tyre. 17. Të kryhet një analizë e rregullores për licencimin e shërbimeve, në lidhje me licencimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët. 18. Të caktohen burime financiare për ofrimin e shërbimeve nga OSHC-të për të gjithë përfituesit në sistemin e mbështetjes së fëmijëve. 19. Të krijohet një fond për ofrimin e kompensimit për fëmijët viktime të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual, në rastet kur ky kompensim nuk mund t'i merret autorit të krimit. 20. Të shtohen përpjekjet për konfiskimin e aseteve që janë siguruar përmes veprimeve të ndërlidhura me trafikimin e qenieve njerëzore. 21. Të krijohet mundësia për qasje në mekanizmat e pavarur të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, p.sh. Avokati i Popullit. 22. Të përdoren rezultatet e hulumtimit për të përcaktuar dhe hartuar masat për parandalimin e mostolerancës sociale ndaj rasteve të raportuara ose të stigmatizimit të viktimave. 23. Të mbështeten programet e arsimit formal dhe joformal në shkolla dhe komunitete, duke u përqendruar te zhvillimi i programeve parandaluese në drejtim të njohjes së shkaqeve dhe faktorëve të rrezikut. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në planet kombëtare të veprimit duhet të merren masa të posaçme për SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia. 2. Të përmirësohet bashkëpunimi me OSHI-të në drejtim të monitorimit dhe rregullimit të ekspozimit të pavullnetshëm të fëmijëve ndaj MASF-së dhe të ofrohen të dhëna të nevojshme për hetim dhe vlerësim. 3. Të zhvillohen fushata informimi me qëllim informimin e prindërve rreth sigurisë në internet për fëmijët për kanale të caktuara komunikimi. 4. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Akademisë së Policisë, duhet të hartojë dhe ofrojë trajnime të përshtatshme dhe të specializuara me qëllim ngritjen e kapacitetit për të gjithë oficerët përkatës. 5. Të krijohet një organ i specializuar për krimet e mundësuar nga teknologjia, me përqendrim të veçantë te SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia. 6. Të zhvillohen mekanizmat për monitorimin e veprimtarive në qendrat e internetit (internet kafe) dhe të përmbajtjes që shohin përdoruesit e shumtë qendrave interneti në Kosovë. 7. Të merren parasysh për zbatim udhëzimet e vitit 2020 për politikëbërësit "Për mbrojtjen e fëmijëve në internet" nga ITU-ja.¹⁹⁸ 8. Të hartohen standarde objektive të kujdesit të shtuar, të miratuara nëpërmjet konsultimeve me shumë palë të interesuara. 9. Të punohet me partnerët për të angazhuar sektorin financiar. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të zhvillohen, sidomos në nivelin lokal, planet e veprimit dhe të merren masa për mbrojtjen e fëmijëve nga rënia pre e SHSTF-së. 2. SHSTF-së. 3. Ministrinë e turizmit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera përgjegjëse për mirëqenien e fëmijëve si Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme, duhet të punojnë për zbatimin e një strategjie të përbashkët me shumë palë të interesuara (për rritjen e vetëdijesimit të operatorëve të sektorit të udhëtimeve dhe turizmit, për politikën për fushatën informuese, etj.) në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit. 4. Të përfshihen përfaqësuesit e industrisë së udhëtimeve dhe turizmit në mekanizmat kombëtarë të referimit (MKR) dhe në zbatimin e procedurave ekzistuese standarde të veprimit. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përcaktohen masa të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve romë dhe fëmijëve migrantë. 2. Të organizohen ekipe speciale ku të përfshihen OSHC-të e drejtuara nga romët, në zbulimin dhe parandalimin e lypjes së detyruar dhe të martesave të hershme ose të detyruara. 3. Të nxiten veprimtaritë e identifikimit dhe parandalimit, me qëllim ofrimin e mbështetjes për fëmijët migrantë dhe të miturit e pashoqëruar në lidhje me SHSTF-në. 4. Të hartohen programe riintegrimi për viktimat vendase dhe të huaja të trafikimit, pas qëndrimit të tyre në qendrën e pritjes, me qëllim që t'u mundësohet të integrohen me sukses në shoqëri. 5. Të përfshihen përfaqësuesit e komuniteteve romë në organet ekzistuese kuadër.
Zbatimi i ligjit dhe drejtësia penale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të rritet numri i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të oficerëve të policisë, prokurorëve, gjyqtarëve dhe të gjithë aktorëve të ndërlidhur, të cilët kanë kontakt të rregullt me fëmijët, në lidhje me këtë dukuri, për sa i takon zbatimin të duhur të drejtësisë penale për fëmijët dhe termave teknike (p.sh. për SHSTF-në e mundësuar nga teknologjia). 2. Të zhvillohen kurrikula trajnimesh të specializuara në akademitë e policisë dhe në qendrat e edukimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. 3. Të kryhet vlerësimi i nevojave për trajnim dhe të krijohet plane vjetore të veçanta për zhvillimin profesional të të gjitha palëve përkatëse të interesuara, të cilat përfshihen në sistemin e parandalimit dhe mbrojtjes. 4. Të përditësohen periodikisht pajisjet dhe softuerët. 5. Të përmirësohet bashkëpunimi midis subjekteve të sektorit gjyqësor dhe sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve në hetimin e rasteve, duke përfshirë linjat e drejtpërdrejta të komunikimit midis oficerëve të policisë, prokurorëve dhe laboratorëve të njësive për hetimin e krimeve kompjuterike. 6. Të organizohen takime të përbashkëta të rregullta për përfaqësuesit e organeve të zbatimit të ligjit dhe ata të prokurorisë në nivelin kombëtar dhe rajonal. 7. Të monitorohet numri i padive për trafikim të qenieve njerëzore, duke përfshirë këtu trafikimin e fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe në punë, dhe të bashkëndahen të dhëna me aktorët përkatës nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve dhe subjektet e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të riinvestohet në strukturën e laboratorit kombëtar të kibernetikës për mjete më të mira teknologjike dhe mënyra më të mira të hetimit të rasteve. 2. Të hartohen protokolle për mënyrën se si duhet nxjerrë materiali i abuzimit, duke qenë se pjesa më e madhe e inteligjencës në rajon vjen nga burime dhe ekspertiza të jashtme (Europol-i etj.). 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Agjencitë ligjzbatuese dhe operatorët turistikë duhet të informohen për SHSTF-në dhe për mënyrën se si t'i mbrojnë fëmijët nga shfrytëzimi. 2. Të fuqizohet bashkëpunimi me inspektoratin e punës. 	

	Të përgjithshme	SHSTF-ja e mundësuar nga teknologjia	SHSF-UT	Romët
OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të mundësohet pjesëmarrja e fëmijëve dhe e rinisë në fushatat e rritjes së vetëdijesimit dhe shpërndarja e informacioneve lidhur me këtë dukuri, sepse një praktikë e tillë do të çojë në rritjen e efektivitetit të përpjekjeve të shënjestruara për parandalimin e SHSTF-së së mundësuar nga teknologjia dhe SHSTF-së dhe për reagimin mbrojtës ndaj këtyre veprave. 2. Të rriten njohuritë e komuniteteve rreth sigurisë digjitale dhe rreziqeve të mundshme që u kanosen fëmijëve në hapësirën virtuale. 3. Të ngrihen kapacitetet dhe të përmirësohet qëndrueshmëria e fëmijëve nëpërmjet sistemeve të mbështetjes nga bashkëmoshatarët dhe programeve të arsimit. 4. Të avokohet për përmirësimin dhe zgjerimin e kurrikulave shkollore me qëllim që të shtohet edukimi për sigurinë digjitale dhe sigurinë në internet, identifikimi i rreziqeve dhe sjelljet parandaluese të fëmijët dhe të rinjtë. 5. Të angazhohen fëmijët, duke përfshirë edhe fëmijët viktimë të mbijetuar, në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve të ndryshme kombëtare të veprimit. 6. Të rritet vetëdijesimi te palët përkatëse të interesuara dhe të moderohen ose realizohen trajnime të detyrueshme për shfrytëzimin seksual dhe abuzimin në hapësirat virtuale për të gjithë personelin, oficerët e policisë, mësuesit, prindërit, civilët dhe vullnetarët. 7. Të mbështeten shtetet që kontribuojnë me staf në operacionet paqeruajtëse në krijimin e masave mbrojtëse kundër SHSTF-së dhe në hartimin e protokolleve të raportimit, si dhe në hetimin me saktësi dhe pa vonesë të pretendimeve për SHSTF. 8. Të sigurohet që hetuesit kombëtarë të jenë të pajisur si duhet për të menaxhuar rastet që kanë të bëjnë me SHSTF-në, p.sh. me përvojë pune të mëparshme me fëmijët, trajnime të përshtatshme, përvojë pune me krimet ku janë të përfshirë fëmijët ose me krime me natyrë seksuale, etj. 9. Të mobilizohen burimet financiare dhe njerëzore për të vazhduar më tej shembullin dhe mekanizmin e suksesshëm të ekipeve lëvizëse në identifikimin e viktimave të mundshme. 10. Shërbimet duhet t'u vihen në dispozicion dhe të jenë të përdorshme nga të gjithë fëmijët, sidomos nga ata në zona rurale dhe në mjedise që janë sfiduese në aspektin ekonomik dhe shoqëror. 11. Të avokohet për rregullimin e masave mbrojtëse digjitale dhe përgjegjësitë midis palëve të interesuara në sektorët e tyre përkatës, duke përfshirë OSHI-të, prindërit, institucionet arsimore (si shkollat) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. 12. Të bashkëpunohet me aktorët e tjerë të shoqërisë civile, OJQ-të dhe kompanitë e TIK-ut (në mënyrë specifike me OSHI-të), sidomos në lidhje me njohuritë, informimin dhe bashkëndarjen e praktikave të mira. 13. T'i kushtohet vëmendje dhe të hartohet një qasje strategjike afatgjatë për adresimin e kësaj problematike, duke përfshirë realizimin e monitorimit dhe vlerësimit të projekteve dhe programeve të përfunduara. 			
Sektori privat	<ol style="list-style-type: none"> 1. Media dhe gazetarët, sidomos media në internet dhe profesionistët, duhet të edukohen dhe trajnohen për të ofruar informacione të përshtatshme në lidhje me të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit të fëmijëve, duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë së viktimave. 2. Sektori privat nuk duhet të jetë bashkëfajtor dhe duhet të ndalojë në mënyrë proaktive përdorimin e imazheve dhe mesazheve të seksualizuara në të cilat përfshihen fëmijë, në produktet dhe shërbimet e tyre. Këtu përfshihet vënia në dispozicion dhe promovimi i produkteve që kanë për qëllim seksualizimin e vajzave në moshë të hershme në revista, filma, lojëra kompjuterike, veshmbathje, lodra, makiazh dhe produkte të tjera që tregtohen edhe për të rritur, edhe për fëmijë. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kompanitë e TIK-ut duhet të përmirësojnë regjimin e tyre të përgjegjësisë së kufizuar si ofruer të ndërmjetëm shërbimesh si dhe fushën e parregulluar të procedurave të njoftimit dhe heqjes së materialeve. Kompanitë e TIK-ut duhet të krijojnë protokolle dhe procedura dhe politika të qarta në lidhje me heqjen e materialeve të paligjshme ose të pahijshme nga platformat dhe shërbimet që ato ofrojnë. 2. Kompanitë e TIK-ut duhet të caktojnë një urdhër për monitorimin dhe raportimin e përmbajtjes së paligjshme që transmetohet përmes rrjeteve të tyre, platformave dhe/ose pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik. 3. Kompanitë e TIK-ut duhet të bashkëpunojnë në mënyrë më proaktive me OJQ-të lokale, sidomos në lidhje me bashkëndarjen e njohurive, përvojave dhe informacioneve, rritjen e vetëdijesimit të punonjësve të TIK-ut dhe në lidhje me zhvillimin e masave parandaluese dhe të mekanizmave të mbrojtjes së viktimave. 4. Industria e informacionit dhe teknologjisë duhet të sigurojë që platformat në internet të kenë masa të përmirësuar sigurie dhe mbrojtjeje dhe të nxisin dhe ndihmojnë shërbimet e referimit për sigurinë e fëmijëve dhe linjat e drejtpërdrejta telefonike të ndihmës. 5. Kompanitë teknologjike duhet të investojnë burime për të siguruar një numër të mjaftueshëm moderatorësh njerëz për të monitoruar disa prej kategorive më të ndjeshme të përmbajtjeve, ku përfshihen materialet e abuzimit seksual të fëmijëve dhe shfrytëzimi i tyre. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të ngrihen kapacitetet dhe të ofrohen trajnime lidhur me SHSF-UT-në dhe SHSTF-në për operatorët turistikë. 2. Të rritet angazhimi i operatorëve turistikë ndaj Kodit. 3. Të hartohen protokolle operative për ruajtjen dhe identifikimin e viktimave dhe për raportimin e rasteve në industrinë e udhëtimit dhe turizmit—këto protokolle të bëhen të detyrueshme. 4. Të organizohen fushata mediatike, të krijojnë video, spote televizive, fletëpalosje, tabela të mëdha reklamash, etj. për t'i bërë të dukshme në ambientet turistike. 5. Të përmirësohet bashkëpunimi me organet ligjzbatuese dhe me OJQ-të lokale, për shembull, duke krijuar një protokoll raportimi për të informuar policinë atëherë kur punonjësit hasin në sjellje jo të hijshme ose raste të dyshimta dhe duke u kërkuar OJQ-ve lokale që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit që të realizojnë trajnime për punonjësit. 6. Të nxiten kompanitë ndërkombëtare e rajonale dhe kompanitë e mëdha që të ofrojnë mbështetjen e tyre dhe të bashkëndajnë me kompanitë lokale e më të vogla brenda së njëjtës industri masat parandaluese, përvojat me raportimin dhe protokollat e tyre. 	

SHËNIME

- 1 Edhe pse termi "pornografi me fëmijë" vazhdon të përdoret gjerësisht si përkufizim ligjor në shumë vende, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, përdorimi i këtij termi është, në një masë të madhe, hutues dhe i pasaktë. Termi "pornografi" përdoret për t'iu referuar materialeve si imazhe, video, libra dhe medime të tjera që kanë për qëllim shkaktimin e eksitimit seksual. Duke qenë se fëmijët nuk janë ende të pjekur nga aspekti mendor dhe fizik, ata nuk mund të jenë plotësisht të vetëdijshëm për veprimtaritë të cilat të tjerët i kanë detyruar të bëjnë. Prandaj, përfshirja e fëmijëve në këto materiale nuk duhet të përkufizohet si "pornografi", por si "abuzim ose shfrytëzim seksual i fëmijës". Përdorimi i pasaktë i terminologjisë mund të shpërfillë peshën e natyrës shfrytëzuese të dukurisë dhe të lërë të nënkuptohet njëfarë shkalle legjitimiteti nga ana e autorit të veprës dhe njëfarë bindjeje me dëshirë nga ana e fëmijës viktimë.
- 2 Referencat për Kosovën në këtë raport janë bërë pa cenuar pozicionet lidhur me statusin e vendit dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë nga Kosova.
- 3 ILO, Global Estimates of Child Labour [Vlerësime globale për punën e fëmijëve], 2017, https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/documents/publication/wcms_575541.pdf.
- 4 Këshilli i Evropës, The Underwear Rule - Kiko and the Hand [Rregulla e mbathjeve: Kikoja dhe Dora], 2021, <https://www.coe.int/en/web/children/underwear-rule>.
- 5 Megjithatë, ligjet për prapenë e moshës varen nga legjislativi vendas dhe ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin.
- 6 ECPAT International, Forms of Commercial Sexual Exploitation of Children [Format e shfrytëzimit seksual tregtar të fëmijëve], 2016, https://www.ecpat.org/wp-content/uploads/2016/04/ECPAT_brochure_2005_ENG_2nd-Edition.pdf.
- 7 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, nëntor 1989, <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>.
- 8 ILO, Konventa nr. 182 "Për format më të këqija të punës së fëmijëve", 1999, <https://www.infocip.org/al/?p=3214>.
- 9 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Protokollin për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, nëntor 2000, <https://www.infocip.org/al/?p=6512>.
- 10 Megjithatë, jo i gjithë trafikimi i fëmijëve përbën shfrytëzim seksual tregtar, sepse fëmijët mund të trafikohen edhe për shfrytëzim në punë.
- 11 Chase and Statham, Commercial and sexual exploitation of children and young people in the UK—a review [Shfrytëzimi seksual dhe tregtar i fëmijëve dhe të rinjve në Mbretërinë e Bashkuar—shqyrtim], Child Abuse Review, 2005, <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1002/car.881>.
- 12 Ellen Wright Clayton, Richard D Krugman and Patti Simon (eds), *Confronting commercial sexual exploitation and sex trafficking of minors in the United States* [Përballja me shfrytëzimin seksual tregtar dhe trafikimin seksual të të miturve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës]. Institute of Medicine and National Research Council, Washington, DC: The National Academies Press, 2013, <https://ojdp.ojp.gov/sites/g/files/xyckuh176/files/pubs/243838.pdf>.
- 13 Commercial Sexual Exploitation of Children and Sex Trafficking [Shfrytëzimi seksual i fëmijëve për përfitim dhe trafikimi për qëllime seksuale], Development Services Group, Inc., Washington, D.C.: Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2014, <https://www.ojjdp.gov/mpg/litreviews/CSECSexTrafficking.pdf>.
- 14 Megan Annitto, Consent, Coercion, and Compassion: Emerging Legal Responses to the Commercial Sexual Exploitation of Minors [Dhënia e pëlqimit, detyrimi dhe dhembshuria: Reagimet ligjore në zhvillim e sipër ndaj shfrytëzimit seksual të të miturve për qëllime përfitimi], *Yale Law and Policy Review*, 30, 1, <https://digitalcommons.law.yale.edu/ylpr/vol30/iss1/2>.
- 15 Lucia Bird et al., Transformative technologies: How digital is changing the landscape of organized crime [Teknologjitë transformuese: Si po e ndryshon digjitalja peizazhin e krimin të organizuar], Nisma Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, qershor 2020, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/06/Transformative-Technologies-WEB.pdf>.
- 16 Instagram biggest for child grooming online - NSPCC finds [NSPCC-ja zbulon se Instagram-i është platforma më e madhe në internet për ndjelljen e fëmijëve], BBC News, 1 mars 2019, <https://www.bbc.com/news/uk-47410520>.
- 17 How People Use the Internet to Sexually Exploit Children and Teens [Si e përdorin njerëzit internetin për të shfrytëzuar seksualisht fëmijët dhe adoleshentët], Stop It Now, <https://www.stopitnow.org/ohc-content/how-people-use-the-internet-to-sexually-exploit-children-and-teens>.
- 18 Livia Wagner dhe Thi Hoang, Aggravating circumstances: How coronavirus impacts human trafficking [Si ndikon koronavirusi te trafikimi i qenieve njerëzore], Nisma Globale kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, maj 2020, <https://globalinitiative.net/analysis/human-trafficking-covid-impact/>.
- 19 Nikita Malik, When it comes to Child Sexual Exploitation, we cannot ignore the Darknet [Kur është fjala për shfrytëzim seksual të fëmijëve, nuk mund ta shpërfillim rrjetin e

- errët], Forbes, 4 shtator 2018, <https://www.forbes.com/sites/nikitamalik/2018/09/04/when-it-comes-to-child-sexual-exploitation-we-cannot-ignore-the-darknet/#62708606de6a>.
- 20 Komisioni Evropian, EU strategy for a more effective fight against child sexual abuse [Strategjia e BE-së për luftë më efikase ndaj abuzimit seksual të fëmijëve], COM(2020) 607 varianti përfundimtar, 24 korrik 2020, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-security/20200724_com-2020-607-commission-communication_en.pdf.
